

E DREJTA PARLAMENTARE DHE POLITIKAT LIGJORE

1/2004

Në këtë numër:

E Drejta Parlamentare

- Parlamentarizmi suedez

Reforma ligjore

- Konflikti i interesit.
- Deklarimi dhe kontrolli i pasurive
- Vështrim mbi standartet etike dhe pushtetin ligjvënës.
- Udhëzimet e OECD për manaxhimin e konfliktit të interesit.

E Drejta Kushtetuese

- Përgjegjësia e kreut të shtetit

PËRMBAJTJA E REVISTËS:

Numri XVII, viti 2004

Faqe

E Drejta Parlamentare:

Parlamentarizmi suedez	Jemin GJANA	4
------------------------	-------------	---

Reforma ligjore:

Konflikti i interesit	Ardian DVORANI	27
-----------------------	----------------	----

Deklarimi dhe kontrolli i pasurive të funksionareve të zgjedhur dhe atyre të administratës publike, një praktikë e re në luftën kundër korrupsionit	Sokol LAMAJ	35
---	-------------	----

Vështrim mbi standardet etike dhe pushtetin ligjvënës		49
---	--	----

Udhëzimet e OECD-së për manaxhimin e konfliktit të interesit		69
--	--	----

E Drejta Kushtetuese:

Përgjegjësia e kreut të shtetit	Francis DELPÉRÉE	91
---------------------------------	------------------	----

Nga punimet e Kuvendit:

Nga punimet e Kuvendit për periudhën nëntor-dhjetor 2003	Alma KONDAKÇI	105
--	---------------	-----

Informacion mbi legjislationin e miratuar	Filip LAKO	120
---	------------	-----

Përmbledhje në anglisht:

Informacion mbi legjislationin e miratuar		137
---	--	-----

TABLE OF CONTENTS:

17th issue, year 2004

	Page
<hr/>	
Parliamentary Law:	
Swedish Parliamentarism	
	Jemin GJANA 4
<hr/>	
Legal reform:	
Conflict of interest	
	Ardian DVORANI 27
Disclosure and oversight of assets of elected officials and officials in public administration, a new practice in the fight against corruption	
	Sokol LAMAJ 35
Overview of ethical standards and the legislative power	49
OECD guidelines about the conflict of interest	69
<hr/>	
Parliamentary Law:	
The responsibility of the Head of the State	
	Francis DELPÉRIÉE 91
<hr/>	
From the proceedings of the Assembly:	
From the proceedings of the Assembly for the period November - December 2003	
	Alma KONDAKÇI 105
Information on the approved legislation	
	Filip LAKO 120
<hr/>	
Summary in English:	
Information on the approved legislation	137
<hr/>	

Rubrikat në vijim synojnë prezantimin e politikave ligjore dhe trajtimeve teorike për organizmin dhe funksionimin e institucioneve kushtetuese. Botuesi vlerëson si një kontribut në zhvillimin dhe përmirësimin e funksionimit të institucioneve kushtetuese, paraqitjen e opinioneve dhe mendimeve të studjuesve të ndryshëm, në mënyrë të paanëshme dhe objektive, duke nxitur një debat profesional.

Opinionet e paraqitura janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë qëndrimin e botuesit të kësaj reviste.

Parlamentarizmi suedez

Jemin GJANA
Deputet

Në Europë, Suedia është një prej shteteve më të mëdha, pas Rusisë, Ukrainës, Francës dhe Spanjës. Me një shtrirje veri – jug prej 1600 km, mbuluar në më shumë se gjysmën e sipërfaqes me pyje, një vend në të cilin numërohen rreth 100 mijë liqene. Më shumë se 85 për qind e popullsisë 9.9 milionëshe jeton në zonat e jugut të vendit. Rreth 25 për qind e saj janë të huaj në kuptimin që kanë jetuar jashtë Suedisë ose së paku njëri prej prindërve ka jetuar jashtë. Rreth 50 për qind e fëmijëve në shkolla nuk janë suedezë. Suedishtja bën pjesë në degëzimin verior të familjes gjermanike të gjuhëve. Shkëputur në shekullin e 16-të nga kisha katolike, suedezet iu bashkëngjitën kishës evangjeliko-luterane për rreth 400 vjet dhe më 1 janar 2000 kisha e Suedisë u bë e pavarur, duke iu dhënë të njëjtin status edhe bashkësive të tjera fetare.

Mbretëria e Suedisë zë fill në shekullin e 12-të. Deri në shekullin e 16-të kufijtë mes Suedisë, Norvegjisë dhe Danimarkës ishin tranzitorë, ndërsa për disa kohë në shekullin e 14-të ata ishin së bashku në një union. Themelimi i shtetit modern suedez nis në fillimet e shekullit të 16-të dhe në historinë e re shteti suedez ka qëndruar jashtë Luftës së Parë dhe të Dytë Botërore.

Në mesin e shekullit të 19-të Suedia ishte një prej vendeve më të varfëra të Europës me rreth 70 për qind të popullsisë që merrej me punimin e tokës, ndërkohë që sot vetëm 2 për qind e suedezëve punojnë në sektorin e bujqësisë.

Suedia ka filluar aplikimin për anëtarësimin në BE në vitin 1991 dhe pas një referendumi kombëtar është anëtarësuar në këtë union në janar 1995,

ndërkohë që edhe pas referendumit të vitit 2003 ajo ende nuk i është bashkëngjitur EMU-së (Union Monetar European) që ka hyrë në veprim më 1 janar 1999.

Edhe pse me një trashëgimi të hershme dhe të gjatë mbretërore, Suedia sot mund të konsiderohet një prej vendeve me demokracinë më të zhvilluar parlamentare. Roli i Mbretit tashmë është më honorifik se në çdo vend tjetër. Një demokraci reale parlamentare, si një shembull i çmueshëm për t'u imituar, parlamentarizmi suedez realisht mbizotëron në jetën e vendit si një shembull force, ndarjeje reale pushtetesh, transparent në veprimtari deri në detaje, i thjeshtë dhe i qartë në procedura, me shumë peshë në vendimmarrje dhe në kontrollin e jetës së vendit. E gjitha kjo është një përvojë për t'u marrë në konsideratë.

E vërteta është se në këto rreth 13 vjet të jetës së tij pluraliste Kuvendi i Shqipërisë është njohur me shumë përvoja. Por shumë përvoja natyrisht janë shumë shkolla, të cilat janë nisur, janë zbatuar, janë ndërprerë, ka mbaruar një projekt dhe ka filluar një tjetër, natyrisht disi ndryshe nga i mëparshmi. Kjo praktikë nuk të jep mundësi të krijosh një fizionomi të qëndrueshme dhe mbase në këtë pikëpamje studimi dhe praktikimi hap pas hapi i përvojës së parlamentarizmit suedez mund të jetë një rast për t'u përfillur.

ZGJEDHJET PËR PARLAMENTIN SUEDEZ (RIKSDAG)

Asambleja e Arboges e vitit 1435 referohet si Parlamenti i parë Suedez. Në hollët e Riksdag-ut në ditët e sotme fisnikët, kleri, qytetarët dhe fshatarët portretizohen si shtresat që u përfshinë si përfaqësues të Parlamentit me 1527, pas Asamblesë së Mbretit Gustav Vasa në Vesterës. Emërtimi i Parlamentit të Suedisë është Riksdag. Rregullat e qarta të Riksdag-ut janë përcaktuar në aktin parlamentar të vitit 1617, i cili përcakton dhe ndarjen e parë të pushteteve.

Në vitin 1866 u vendos sistemi parlamentar dydhomësh dhe më 1876 për herë të parë u themelua zyra e Kryeministrit. Që në fillim të viteve nëntëqind,

Qeveria ishte e varur dhe përgjegjëse para Riksdag-ut dhe duhet të kishte koefidencën e tij. Në vitin 1971 u kalua përsëri në sistemin me një dhomë të vetme.

Që nga viti 1994, zgjedhjet për 349 deputetë për në Riksdag mbahen në çdo katër vjet, në të dielën e tretë të shtatorit të vitit përkatës. Brenda kohës së zgjedhjeve të zakonshme mund të zhvillohen zgjedhje të jashtëzakonshme, të cilat nuk e prekin datën për zgjedhjet e tjera të zakonshme. Që nga 1975-a Suedia nuk ka njohur zgjedhje të jashtëzakonshme.

Zgjedhjet janë të hapura për të gjithë qytetarët suedezë që para ose në ditën e zgjedhjeve janë 18 vjeç. Për të votuar duhet të jesh i regjistruar në regjistrin zgjedhor, i cili para çdo zgjedhjeje përpilohet bazuar në regjistrin kombëtar, që e administron Autoriteti i Taksave. Për zgjedhjet e përgjithshme Suedia është e ndarë në 29 zona zgjedhore, në të cilat në mesatare zgjidhen 10-12 deputetë, por që ndryshojnë shumë mes tyre: nga 39 deputetë më e madhja, në 2 deputetë më e vogla. Votimi bëhet për partitë dhe kushdo që dëshiron të votohet për zgjedhje të përgjithshme duhet të propozohet domosdoshmërisht nga një parti politike. Duke votuar për partitë, zgjedhësit ndërkohë mund të votojnë për një kandidat të caktuar të listës, por gjithmonë vetëm për një emër. Ky votim për kandidatin është i lirë. Zgjedhësit mund të zgjedhin për të votuar në një qendër votimi, por mund të votojnë dhe përmes shërbimit postar. Me postë mund të votohet edhe prej një vendi tjetër ose që nga mjetet detare që ndodhen në ujëra të huaja. Personat që jetojnë jashtë Suedisë mund të votojnë në ambasadat ose konsullatat suedeze. Qendra votimi hapen në spitale, në shtëpitë e të moshuarve, në burgje etj. Në të gjitha rastet numërimi i votave është i hapur për publikun e gjerë. Vendet në Riksdag shpërndahen në përpjesëtim me numrin e votave sipas partive. Nga 349 vende në Riksdag, 310 janë të fiksuara për t'u ndarë për 29 zonat dhe u shpërndahen partive, bazuar në rezultatin e çdo zone përkatëse, ndërsa 39 vende përdoren për të realizuar shpërndarjen më të mirë të mundshme përpjesëtimore të vendeve midis partive në shkallë vendi. Për të shmangur

përçarjen e përfaqësimit në Riksdag nga partitë e vogla, çdo parti që të zerë vende dhe të përfaqësohet në Riksdag, duhet të marrë 4 për qind të votave në shkallë vendi ose në 12 për qind në një zonë të caktuar zgjedhore.

ZGJEDHJET E PËRGJITHSHME TË JASHTËZAKONSHME

Zgjedhjet e jashtëzakonshme në Suedi, sidomos pas demokratizimit të vendit në vitet e para të shekullit të 20-të, janë të rralla. Vetëm një herë janë zhvilluar zgjedhje parlamentare të jashtëzakonshme, më 1 qershor 1958, për Dhomën e Dytë (sistemi njëdhomësh ka filluar më 1971), duke pasur si çështje themelore pensionet suplementare kombëtare. Të drejtën ekskluzive për të marrë vendimin për zgjedhjet e jashtëzakonshme e ka Qeveria. Pasi Qeveria e merr vendimin, ai i njoftohet Riksdag-ut me gojë ose me një komunikatë të shkruar.

Vendimi i Qeverisë për zgjedhje të jashtëzakonshme duhet të përmbajë datën e zgjedhjeve e cila duhet të bjerë patjetër një ditë e diel dhe nuk mund të jetë më parë se 35 ditë dhe jo më vonë se 3 muaj nga koha e marrjes së vendimit. Qeverisë i janë përcaktuar disa kushtëzime, bazuar në të cilat ajo mund të vendosë për zgjedhje të jashtëzakonshme. Zgjedhjet e jashtëzakonshme nuk mund të zhvillohen në një kohë shumë të afërt pas një pale zgjedhjesh të tjera. Ato s' mund të lajmërohen më parë se 3 muaj nga përfundimi i zgjedhjeve të zakonshme. Edhe në rastin kur Qeveria kërkon dorëheqje, me kërkesë të Kryetarit të Riksdag-ut (Spikeri), ajo vazhdon të kryejë funksionet e zakonshme, deri në formimin e Qeverisë tjetër.

Në rastet kur Qeveria nuk mund të formohet edhe pas katër propozimeve radhazi të Spikerit para Riksdag-ut për kandidaturën e Kryeministrit, atëherë zhvillohen automatikisht zgjedhjet e jashtëzakonshme. Në këto raste nuk mundet më të vendosë Qeveria në detyrë, por Spikeri, në këshillime me Autoritetin Zgjedhor, përcakton datën e zgjedhjeve. Në këto raste Autoriteti Zgjedhor, Bordi Administrativ i Kontesë (Qarkut), Bordi Zgjedhor Vendor dhe partitë fillojnë menjëherë përgatitjet për zgjedhje.

Në rast zgjedhjesh të jashtëzakonshme puna e Riksdag-ut mund të mos ndërpritet deri në zgjedhjen e Riksdag-ut të ri. Megjithatë, Spikeri, me kërkesë të Qeverisë, mund të vendosë një ndërprerje të punës në Riksdag dhe në këto kushte ai s'mund të mblidhet në seance plenare dhe s'mund të marrë vendime. Ndërkohë, komisionet parlamentare mund të vazhdojnë të punojnë. Me fjalë të tjera, Riksdag-u nuk shpërndahet dhe ai mund të mblidhet në raste të domosdoshme, si bie fjala një çështje e lidhur me politikën e jashtme. Spikeri mund ta thyejë rregullin për ndërprerjen e punimeve bazuar në kërkesën e Qeverisë ose të 115 deputetëve. Pas zgjedhjeve të jashtëzakonshme, Riksdag-u zgjedh Spikerin dhe nënkryetarët. Nëse partitë që mbështesin Qeverinë në detyrë i fitojnë zgjedhjet, atëherë Qeveria vazhdon punën pa ndonjë veprim tjetër. Në rast të kundërt, Qeveria jep dorëheqjen dhe Spikeri fillon procedurat e zgjedhjes së Kryeministrit. Në rastin e një mbështetjeje të dobët të Kryeministrit, opozita ka të drejtë të kërkojë një mocion mosbesimi.

FORMIMI I QEVERISË

Në ligjin themeltar suedez, Instrumenti i Qeverisjes theksohet si një prej elementeve më të rëndësishme parimi, sipas të cilit “gjithë pushteti publik në Suedi buron nga populli” dhe, në këtë kuptim, “Riksdag-u (Parlamenti Suedez) është përfaqësuesi kryesor i popullit”. Demokracia suedeze bazohet në përfaqësimin parlamentar konstitucional dhe shprehja themelore e demokracisë mbetet e drejta e votës së barabartë dhe të përgjithshme.

Qeveria është përgjegjëse përpara Riksdag-ut. Parlamentarizmi nënkupton që Qeveria duhet doemos të ketë mbështetjen e shumicës parlamentare ose më së paku të tolerohet nga shumica. Në Kushtetutën Suedeze përcaktohet që Riksdag-u duhet të arrijë në një vendim për sa i takon propozimit për postin e Kryeministrit. Gjithashtu, është gjithmonë e mundur që Riksdag-u ta rrëzojë Qeverinë përmes deklarimit se ajo nuk e ka konfidencën e Riksdag-ut, dhe kjo i adresohet Kryeministrit. Qeveria mund të japë dorëheqjen për

arsye të ndryshme. Arsyet kryesore që mund të sjellin dorëheqjen janë disa prej atyre që po rendisim më poshtë:

Krijimi i Qeverisë ndryshon pas zgjedhjeve të përgjithshme. Kur një parti Qeverisëse ose një koalicion partish humb shumicën në Riksdag në zgjedhjet e përgjithshme, atëherë në këtë situatë Qeveria tërhiqet për t'i lënë vendin fituesve. Kështu p.sh., më 1976 pas zgjedhjeve, Olof Palme, Kryeministri socialdemokrat dha dorëheqje. Grupimi i partive josocialiste iku nga qeverisja në zgjedhjet 1982-it, ndërsa socialdemokratët pësuan disfatë në zgjedhjet e vitit 1991 etj.

Qeveria jep dorëheqje në rastin e një votimi konfidencë. Riksdag-u vendos për një mocion, i cili kërkohet nga së paku 35 deputetë, të cilët kërkojnë deklarin e mocionit të mosbesimit ndaj Kryeministrit. Qeveria tërhiqet nëse në këtë votim 175 deputetë janë në favor të deklarin të mosbesimit. Vota e konfidencës, gjithashtu, është informale në rast se një qeveri është e shtrënguar të japë dorëheqje kur humb votimin për një çështje të rëndësishme në Riksdag. Shpesh Qeveria mund të rrezikojë ekzistencën e saj duke e deklaruar paraprakisht se do të dorëhiqet po që se e humb votimin në Riksdag për një çështje të posaçme. Rast i tillë ka qenë dorëheqja e Qeverisë së Ingvar Carlsson-it me 15 shkurt 1990. Qeveria mund të tërhiqet edhe në rastet e ndarjes që mund të pësojnë partitë e koalicionit. Dorëheqjet e tetorit 1978 dhe majit 1981 janë shembujt e krizave qeveritare të kësaj natyre.

Rolin kryesor në krijimin e një qeverie të re e ka Spikeri i Riksdag-ut. Kjo e bën shumë të ndryshme nga demokracitë e tjera mënyrën e propozimit të Kryeministrit, ku zakonisht këtë kompetencë e ka kryetari i shtetit.

Është detyrë e Spikerit, që në kohën më të shpejtë të mundshme të propozojë Kryeministrin e ri që do të formojë Qeverinë. Propozimet dhe procedurat finalizohen me votim në Riksdag. Spikeri ndërkohë i kërkon Qeverisë ekzistuese të qëndrojë në detyrë, për të kryer detyrimet e një qeverisjeje përkujdesëse, e cila mbulon detyrat e zakonshme. Është e palejueshme për Qeverinë në detyrë që të mund të kërkojë zgjedhje të reja.

Spikeri këshillohet me drejtuesit e partive në Riksdag dhe me zëvendëskryetarët. Diskutimet gjithmonë ndërvaren nga komplikimi i situatave politike. Pas këtyre këshillimeve Spikeri është në gjendje të gjykojë se cili kandidat për kryeministër mund të paraqitet për t'u miratuar. Pas çdo zgjedhesh të reja, zgjidhet një spiker i ri, i cili duhet të paraqesë propozim për një kryeministër të ri.

Spikeri vendos se cilat janë partitë që duhet të përfshihen në Qeveri. Propozimet vihen në tryezë pa debat. Riksdag-u voton për propozimet pa u paraprirë nga ndonjë debat real. Nga një përfaqësues prej grupeve parlamentare deklaron qëndrimet përpara votimit. Votimi është si çdo votim i zakonshëm, i hapur dhe me elektronikë. Nuk kërkohet shumica e cilësuar për të votuar propozimin e Spikerit për Kryeministrin. Rregulli është që propozimi rrëzohet me më shumë se 175 deputetë pra 50 për qind plus një e numrit të anëtarëve në Riksdag, në të kundërt propozimi miratohet. Shembulli më i qartë se si funksionon rregulli i miratimit të propozimit të Spikerit për Kryeministrin është krijimi i Qeverisë Liberale të Ola Ullsten në tetor 1978. Në favor të propozimit të Spikerit votuan 39 deputetë të Partisë Liberale, ndërkohë që 66 deputetë të Partisë Moderatore dhe të Partisë së Majtë Komuniste votuan kundër. 215 deputetë të Partisë Socialdemokrate dhe të Partisë së Qendrës abstetuan nga votimi. Propozimi u miratua.

Nëse një propozim i Spikerit rrëzohet, atëherë ai ka të drejtë të përsërisë propozimin deri 4 herë. Nëse edhe pas propozimit të katërt nuk miratohet Kryeministri, atëherë mbahen brenda 3 muajve zgjedhjet e jashtëzakonshme. Deri tani në praktikë s'ka pasur raste që të mos jetë miratuar propozimi i parë i Spikerit. Pas miratimit nga Riksdag, Spikeri lëshon një letër për emërimin e Kryeministrit të ri. Kryeministri kompozon Qeverinë dhe emëron ministrat, duke njoftuar Riksdag-un për vendimin e tij. Ceremoniali i ndërrimit të Qeverisë bëhet në një takim të posaçëm nën drejtimin e Kryetarit të Shtetit, Mbretit të Suedisë. Spikeri merr pjesë në këtë takim (komunikon qartazi propozimet dhe vendimin e Riksdag-ut) dhe, pas kësaj, Mbreti konfirmon faktin e

zëvendësimit të Qeverisë. E gjithë procedura është publike. Pas kësaj, Qeveria paraqet në Riksdag një dokument të politikave të Qeverisë (program), i cili normalisht paraqitet në Riksdag edhe në fillimin e çdo viti, në çastin e hapjes zyrtare të sesioneve parlamentare të vitit. Në këtë rast njoftohet dhe kompletimi i Qeverisë. Pas paraqitjes së programit, Riksdag-u, një ose dy ditë më prapa, organizon një debat ndërmjet drejtuesve të partive rreth programit.

Kryeministri mund t'i zëvendësojë ministrat, mund t'i transferojë ata ose mund ta shtojë, ose të pakësojë numrin e ministrave, pa pasur nevojë për ndonjë ndërhyrje të Riksdag-ut. Kryeministri ka vetëm detyrim ta njoftojë Riksdag-un për këto ndryshime ose lëvizje.

Një qeveri mund të tërhiqet, nëse krijimi i saj dobësohet nga fakti i largimit prej saj të ndonjë partie të koalicionit.

Në rastet kur Qeveria vëren se nuk arrin të plotësojë programin e saj dhe të zhvillojë politikat e saj Qeverisë, mund t'i apelojë popullit për zgjedhje të jashtëzakonshme. Këto zgjedhje thirren brenda një jave nga koha kur Riksdag-u ka miratuar deklaratën e mosbesimit. Duhet theksuar se Qeveria është i vetmi institucion që mund të thërrasë zgjedhje të parakohshme. Zgjedhjet e jashtëzakonshme zhvillohen jo më herët se 35 ditë nga dita kur Qeveria ka marrë vendimin, por jo më larg se tre muaj. Zgjedhjet e jashtëzakonshme, siç kemi theksuar, nuk e prishin kalendarin e zgjedhjeve të zakonshme në shtator të çdo 4 vjetëve.

VEPRIMTARIA PARLAMENTARE

Riksdag-u merr vendime për shumë çështje që lidhen me legjislacionin, të ardhurat e Qeverisë qendrore, shpenzimet e Qeverisë qendrore dhe grantet për autoritetet vendore dhe veprimtaritë private, direktivat politike etj.

Vendimet bazohen në projektligjet e ardhura nga Qeveria dhe nga propozimet e deputetëve, mocione ose amendamente.

Më të rëndësishme dhe që konsumojnë më shumë kohë dhe punë në

Riksdag janë projektligjet e ardhura nga Qeveria. Rreth 200 projektligje i dërgohen Riksdag-ut mesatarisht në çdo sesion, përfshi këtu dhe projektligjin e buxhetit. Kopja e projektligjit depozitohet në Riksdag me nënshkrimin e Kryeministrit dhe të ministrit përkatës. Riksdag-u ua shpërndan këtë deputetëve, zyrtarëve të stafeve parlamentare dhe mediave. Të gjitha projektligjet dhe amendimet e ardhura futen në regjistrin kompjuterik të Riksdag-ut, i cili krijon akses për deputetët dhe ndërkohë ky regjistër shërben si një dokument për planifikimin e programit, si dhe për memoare historike. Projektligji i jepet vetëm njërit prej 16 komisioneve për diskutim. Deri 15 ditë para se të miratohet në Riksdag projektligji i Qeverisë, deputetët janë të lejuar të paraqesin mocion (amendamente me kundërpropozime). Amendamentet e grupeve parlamentare duhet të kenë mbështetjen e partisë dhe nënshkruhen prej drejtuesit të saj. Edhe amendamentet e komisioneve kanë, gjithashtu, rëndësi të njëjtë. Amendamentet mund të paraqiten prej një deputeti ose një grupi deputetësh dhe mund të nënshkruhen edhe nga deputetë të partive të ndryshme. Vetëm gjatë vitit 2002 janë paraqitur 3234 amendamente nga deputetët. Komisioni parlamentar i caktuar për projektligjin e shpërndan projektin e përfunduar, duke pritur përmbushjen e kohës kur lejohen amendimet dhe bën të njohur se cilat prej tyre janë futur në projekt. Komisioni mbledh qëndrimet e komisioneve të tjera, të autoriteteve dhe organizmave të ndryshme, nga eksponent ligjor të trupit këshillimor të njohur si Këshilli i Legjislacionit. Komisioni organizon dhe seanca dëgjimi. Mbledhjet e komisioneve nuk janë të hapura për mediat dhe publikun. Kryetari i komisionit i mbledh të gjitha deklaratimet (formulimet) dhe numrat në favor të tyre. Anëtarët, që nuk janë në shumicë në komision paraqesin opinionin mospajtues me një formulim të ndarë. Komisioni bën të njohur me një raport të shkruar qëndrimet e tij, përfshi edhe opinionet mospajtuese me formulim të veçantë në fund të raportit. Raporti përfshin dhe propozimet për vendimin që duhet të marrë Riksdag-u. Raporti i komisionit i kalohet për diskutim seancës plenare që zakonisht mbahet të mërkurave, por në vendet e

deputetëve ai shpërndahet që të premtën paraardhëse. Çdo të premtë shpërndahet edhe kalendari i çështjeve që do të trajtohen në seancë plenare. Si rregull, raporti i komisionit jepet dy seanca përpara se sa të fillojë diskutimi. Deputeti që dëshiron të flasë në debat për çështjen në fjalë, njofton sekretariatit një ditë më parë, duke treguar se sa kohë dëshiron të flasë. Spikeri nuk mund ta ndërpresë edhe kur kalon kohën e caktuar. Sekretariati e shpërndan listën e folësve përpara se të fillojë debati. Folësit, që s'kanë paralajmëruar, kanë të drejtë flasin vetëm 4 minuta. Debati zakonisht hapet me përfaqësuesit e opozites. Ndonjëri, që mund të atakohet gjatë diskutimeve, ka të drejtën e përgjigjes për 3 minuta. Për të njëjtin rast Spikeri mund të lejojë deri dy përgjigje. Vendimi pas debatit mund të merret pa votim, siç thuhet, miratim me brohoritje. Kur vendoset miratim pa debat dhe pa votim, Spikeri thotë: “Pranohen propozimet e komisionit”. Nëse askush nuk ka objeksion, Spikeri thotë: “Përgjigjia është Po” dhe komunikohet vendimi, duke goditur me çekan. Po qe se qoftë edhe një anëtar kërkon votim, atëherë gjithë anëtarët thirren në votim përmes një sinjali akustik ose një fleshit dritash që jepet në gjithë mjediset e ndërtesës së Riksdag-ut. Brenda 6 minutash deputetët duhet të zenë vendet për votim.

Zakonisht çështjet e debatuar në mbrëmje nuk votohen deri sa të hapet seancë tjetër plenare.

Kur çështjet kalohen për votim dhe ka më shumë se një propozim, së pari votohet propozimi që ka më pak mbështetje. Shumica e çështjeve vendosen nga seanca plenare me mazhorancë të thjeshtë, por ka jo pak vendime që merren me shumicë të cilësuar, si p.sh. transferimi i vendimmarrjes te një organizëm ndërkombëtar i tillë si BE-ja etj. Seancat janë të hapura për publikun. Në lozhat e publikut shpërndahen edhe kufjet, për t'i dëgjuar punimet e Riksdag-ut edhe në gjuhë të tjera përmes përkthimit. Seancat e debatit regjistrohen ose jepen drejtpërdrejt nga radioja dhe televizioni suedez. Çdo gjë që është diskutuar dhe ka ngjarë gjatë seancave plenare regjistrohet me përpikëri dhe jepet edhe në website të Riksdag-ut

PYETJET DHE INTERPELANCAT

Në çdo parlament modern, anëtarët kanë të drejtën e pyetjeve për ministrat dhe kryeministrin. Në Riksdag kjo realizohet përmes pyetjeve me gojë e me shkrim, si dhe përmes interpelancave. Në debatin që zhvillohet për një interpelancë të kërkuar ka të drejtë të marrë pjesë jo vetëm interpeluesi, por edhe deputetë të tjerë.

Pyetjet me gojë dhe përgjigjet e tyre zhvillohen në një seancë të posaçme në çdo ditë të enjte, përveçse kur Riksdag-u i ka ndërprerë punimet e tij. Pyetjet dhe përgjigjet janë të shkurtëra, por pyetësi e ka mundësinë që pas përgjigjes të bëjë edhe një pyetje tjetër. Pyetjet me shkrim marrin përgjigje dhe nuk lexohen në seancë, por, siç do gjë tjetër, ato regjistrohen dhe publikohen në regjistrimet e Riksdag-ut.

Interpelanca mund të konsistojë në trajtimin e një ose edhe të disa çështjeve. Qëllimi i tyre është që Riksdag-u të ekzaminojë veprimtarinë e Qeverisë. Interpelanca, gjithashtu, ka për qëllim të tregojë kujdes të evidencuar për një çështje të caktuar dhe të sensibilizojë opinionin publik në lidhje me të. Vetëm gjatë njërit sesion parlamentar të vitit 2002 janë zhvilluar 497 interpelanca. Zakonisht një herë, por edhe dy e tri herë në javë një ministër përgjigjet për interpelanca në Riksdag.

Për zhvillimin e debatit në interpelanca ka rregulla shumë strikte. Në fillim të saj ministri ka të drejtë të flasë 6 minuta, me një përgjigje të shkruar, të cilën paraprakisht ia ka dorëzuar interpeluesit. Pastaj interpeluesi, por edhe deputetë të tjerë kanë të drejtë të flasin nga 4 minuta secili. Në raundin e dytë të debatit ministri dhe interpeluesi kanë të drejtë të flasin secili nga 4 minuta, ndërsa të gjithë folësit e tjerë nga 2 minuta. Në raundin e tretë të debatit ministri mund të flase edhe për 4 minuta dhe interpeluesi edhe për 2 minuta të tjerë.

Zakonisht një e treta e ministrave janë çdo të enjte në orën 14 në seancë plenare, për t'iu përgjigjur pyetjeve të drejtpërdrejta me gojë të deputetëve. Kryeministri përgjigjet për pyetje të një natyre më të përgjithshme, ndërsa

ministrat për pyetjet e fushave përkatëse. Duke pasur detyrimin për të qenë të shkurtëra, pyetjet dhe përgjigjet në parim zgjasin jo më shumë se 1 minutë dhe debatet nuk mund të jenë më pak se një orë. Deputeti që dëshiron të zhvillojë pyetje me gojë njofton paraprakisht te sekretariati, duke kërkuar edhe ministrin që do të pyesë. Gjatë kohës së pyetjeve të së enjtes, deputeti lejohet të pyesë edhe drejtpërdrejt pa bërë lajmërim më parë. Të gjitha pyetjet dhe interpelancat regjistrohen, dokumentohen, publikohen dhe gjenden në website të Riksdag-ut.

RIKSDAG-U DHE BUXHETI I QEVERISË QENDRORE

Në vitet '90 procesi i buxhetimit në Riksdag ka pësuar përmirësime të ndjeshme. Ndryshimet dhe përmirësimet i kanë dhënë mundësi Riksdag-ut të ndërmarrë trajtime më të përgjithshme dhe të bashkërenduara, duke u fokusuar më shumë në agregate dhe me pak në detaje të buxhetit. Niveli i shpenzimeve qeveritare përcaktohet që tre vjet më parë, duke vendosur kufijtë jo vetëm për vitin ushtrimor, por edhe për tre vite në vazhdim. Në vitet jozgjedhore buxheti bëhet i njohur nga fundi i shtatorit të çdo viti, zakonisht me 20 të këtij muaji, ndërkohë që në vitet zgjedhore buxheti silllet në Riksdag jo më vonë se data 15 nëntor. Ai diskutohet në Riksdag gjatë vjeshtës dhe përfundon së miratuari në ditët para Krishtlindjeve.

Realisht procesi i buxhetimit nis që kur Qeveria paraqet Dokumentin Financiar të Pranverës. Dokumenti paraqitet jo më vonë se 15 prilli dhe përmban një diskutim të situatës konkrete ekonomike, perspektivat e pak viteve pasuese dhe një orientim bazal të politikave buxhetore. Në të përfshihen edhe objektivat dhe propozimet për veprimtarinë e qeverisjes vendore, si dhe parametrat kryesorë të ndarjes buxhetore dhe të punës për buxhetin në autoritet vendore. Përcaktimi i kufirit të shpenzimeve buxhetore shihet si angazhimi më i fortë i Qeverisë, për të ruajtur nivelet e paravendosura.

Amendamentet e partive opozitare për buxhetin paraqesin propozime që kanë të bëjnë me kufirin e shpenzimeve qeveritare dhe alokimin e shpenzimeve

në fusha të veçanta. Gjithashtu, partitë opozitare paraqesin parashikime për ndryshime në sistemin e taksave dhe të tatimeve.

Secili prej komisioneve parlamentare diskuton buxhetin e sektorit që mbulon me të ardhurat dhe shpenzimet e tij. Të gjitha qëndrimet e komisioneve i jepen Komisionit të Financës. Raporti i tij përmbledhës, së bashku me raportet përmbledhëse të komisioneve të tjera, i paraqiten për debat seancës plenare në fillim të muajit dhjetor. Debatu vazhdon për disa ditë dhe mbyllet në ditët para Krishtlindjeve.

PËRFAQËSIMI I FEMRAVE NË RIKSDAG

Krahasuar me parlamentet e vendeve të tjera të botës, Riksdag-u dallohet për përfaqësimin më të lartë të femrave. Me 45 për qind ky përfaqësim është më i larti në botë. Rritja drejt kësaj shifre kaq të lartë ka ardhur në vitet e fundit. Në vitin 1970 përfaqësimi i femrave në Riksdag ka qenë vetëm 13 për qind, për të arritur në 38 për qind në vitin 1988, dhe vetëm me 1994 kjo shifër e tejkaloi 43 përqindshin.

I pari mocion deputetësh për të drejtat e barabarta politike, për barazinë gjinore në tërësi, është paraqitur në Riksdag në vitin 1884, por nuk është pranuar. Nën presionin e valëve revolucionare që shokuan Europën në përfundim të Luftës së Parë Botërore, Riksdag-u miratoi më 24 maj të vitit 1919 të drejtën e votimit të përgjithshëm dhe të barabartë për femrat dhe meshkujt. Reforma u implementua bazuar në propozimet e paraqitura nga një qeveri koalicioni me përbërje të liberalëve dhe socialdemokratëve.

Pas zgjedhjeve të vitit 1921, 5 femra u futën për herë të parë në Riksdag. Deri në vitet '50 përfaqësimi nuk e kaloi 5 përqindëshin. Më 1971, për herë të parë një femër arriti të zgjidhej nënkryetare në Riksdag. Më 1989, për herë të dytë një femër bëhet nënkryetare dhe pas dy vjetësh, më 1991, ajo është e para femër që bëhet më së fundi Kryetare në Riksdag.

Depërtimi i femrave në jetën politike suedeze është një dukuri i 30 viteve të fundit. Arsyet kryesore të kësaj ecurie në tri dekadat e fundit lidhen së

pari me sistemin zgjedhor përpjesëtimal që zbaton Suedia. Një faktor shumë i rëndësishëm ka qenë angazhimi politik i vetë femrave, si dhe presioni në rritje i organizatave të grave, si të atyre partiake dhe të organizatave të pavarura. Ndofta faktori më determinant është zhvillimi ekonomik i shoqërisë suedeze dhe mirëqenia e lartë e shtetasve.

Edhe partitë politike u angazhuan në objektiva seriozë për të balancuar përfaqësimin gjinor dhe në zgjedhjet e vitit 2002 ato që të gjitha patën kuota të larta dhe afërsisht të barabarta. Socialdemokratët kanë në Riksdag 47 për qind femra, moderatët 40 për qind, liberalët 48 për qind, kristiandemokratët 30 për qind, majtistët 47 për qind, Qendra 50 për qind dhe të Gjelbrit 59 për qind.

Në komisionet parlamentare fillimisht femrat kanë qenë të pranishme në ato komisione, të cilat më drejtpërdrejt ishin të lidhura me problemet e familjes dhe me fusha të tjera të jetës sociale. Vetëm pas viteve '70 femrat ishin të pranishme edhe në komisionet që kishin lidhje me përcaktimin e politikave fiskale, me financat e shtetit, me transportin, mbrojtjen etj. Ndarja mes çështjeve që konsideroheshin ekskluzivisht për veprimtarinë e femrave dhe të meshkujve nuk ishte më si më parë. Sot çështjet janë krejt ndryshe dhe 4 nga 16 komisionet e përhershme në Riksdag drejtohen prej femrave.

Për herë të parë në Suedi një grua është bërë ministre në vitet 1947-49. Numri i femrave anëtare të Qeverisë ka filluar të rritet pas vitit 1973, duke arritur që më 1994, gjysma e anëtarëve të kabinetit të Ingvar Carlsson-it të ishin femra. Në Qeverinë e sotme suedeze 10 nga 22 ministra janë femra.

TRAJTIMI I ANËTARËVE TË RIKSDAG-UT

Paga mujore për një anëtar në Riksdag është 43200 korona suedeze (rreth 6000 US dollarë) dhe është subjekt taksimi. Paga e Kryetarit në Riksdag është rreth 2.5 herë më e lartë se ajo e një deputeti, ndërsa e nënkryetarëve është 30 për qind më e lartë. Kryetarët dhe nënkryetarët e komisioneve parlamentare marrin përkatësisht një shtesë page prej 20 dhe 15 për qind.

Deputeti në Riksdag zgjedh si vendbanim Stockholm-in ose vendin prej nga vjen dhe për këtë i mbulohen shpenzimet për transport dhe banesë. Deputetët marrin bileta vjetore për udhëtimet e tyre me mjetet e transportit publik, por ata mund të përdorin edhe automjetet vetjake dhe të marrin për këtë 16 korona (rreth 2 dollarë) për çdo km udhëtim. Për zonat ku nuk ka mjete të transportit publik, kjo pagesë është 29 korona për km.

Për secilin deputet ka një kufi financimi, për gjithë periudhën e mandatit, për udhëtimet jashtë shtetit. Për qëndrimin në Stockholm, si dhe për udhëtimet jashtë tij, në zona të ndryshme më shumë se 50 km larg, merren pagesa që mbulojnë koston e shpenzimeve. Riksdag-u mbulon, gjithashtu, shpenzimet për telefon. Brenda ndërtesës së Riksdag-ut afrohen shërbime falas për telefon, faks, kompjuter, printer etj., dhe ndërkohë Riksdag-u ofron kompjuterë edhe në shtëpi për anëtarët e tij. Jepen shpenzime suplementare për shtypin, revistat, librat etj., kur ato nuk gjenden në bibliotekën e Riksdag-ut.

Për raste sëmundjesh dhe trajtimesh mjekësore deri në 14 ditë, Riksdag –u mbulon një ulje të ndjeshme të shpenzimeve dhe, pas kësaj, zyrat e sigurimit shëndetësor paguajnë për rastet e sëmundjeve.

Trajtimi me pensione bëhet bazuar në sistemin e pensioneve suplementare. Për ta përfutur këtë pension kërkohen së paku 6 vjet si deputet, ndërsa pension i plotë kërkohet kur ke 12 vjet deputet në Riksdag dhe ke arritur moshën 50 vjet. Pensioni llogaritet në pagën e 5 viteve të fundit dhe shkon 66 për qind për deputetët që kanë 12 vjet e lart në Riksdag, përveç vitit të parë që është 80 për qind.

MBËSHTETJA FINANCIARE PËR PARTITË POLITIKE

Partitë, shtypi i lirë dhe formatimi i opinionëve konsiderohen në Suedi si elementet thelbësore të demokracisë. Partitë janë modeluesit kryesorë dhe më me peshë të opinionit publik dhe kanë një rol shumë të rëndësishëm në shoqëri. Veçanërisht i madh dhe efektiv është roli i tyre në zgjedhje.

Në Suedi mbështetja financiare për partitë politike konsiderohet e

justifikuar dhe me një rëndësi të madhe për demokracinë. Partive, që në zgjedhje marrin një numër të caktuar votash, u jepet mbështetje financiare për ta zhvilluar veprimtarinë e tyre në terma afatgjata, pa qenë të lidhura dhe të varura prej kontribuesve të tjerë. Që nga viti 1960 burimi kryesor i të ardhurave për partitë politike është mbështetja financiare publike. Qeveria, Riksdag-u dhe autoritetet vendore japin mbështetje financiare për partitë që kanë fituar vende në zgjedhje

Ka edhe rregulla të posaçme për ta reduktuar financimin për partitë që kanë humbur vende nëpër asamblatë gjatë zgjedhjeve.

Masa e financimit varet nga rezultati i zgjedhjeve për në Riksdag. Partitë, që nuk kanë vende në Riksdag, përfitojnë financim vetëm nëse në dy zgjedhjet e fundit radhazi kanë mundur të marrin në secilën palë zgjedhësh nga 2.5 për qind të votave. Për përdorimin e këtyre fondeve nga partitë nuk ka ndonjë kontroll të veçantë.

Mbështetja shtetërore financiare ndahet në dy pjesë. Asistenca për partinë, e cila jepet bazuar në numrin e vendeve në Riksdag, duke marrë në konsideratë llogaritjen e numrit të vendeve në dy zgjedhjet e fundit. Financimi për një vit, për çdo vend në Riksdag është 282450 korona suedeze (rreth 40 mijë dollarë). Pjesa e dytë është mbështetja financiare për zyrat, e cila ndahet në kontributin bazik që u jepet partive, të cilat kanë marrë 4 për qind të vendeve në Riksdag në zgjedhjet e fundit dhe kjo shkon rreth 4.9 milion korona, si dhe një shtesë prej 13850 korona për çdo vend për partitë në Qeveri dhe 20650 korona për çdo vend të partive në opozitë, duke bërë kështu një diferencim në rritje për të mbështetur opozitën parlamentare.

Grupet parlamentare marrin një financim bazik prej 1.7 milionë korona në vit, si dhe një financim suplementar prej 57 000 korona në vit për secilin anëtar të grupit. Grupet parlamentare marrin financime edhe për të përballuar nevojat për ekspertë dhe këshilltarë. Llogaritet një këshilltar për çdo dy deputetë të grupit. Gjithashtu, grupeve u jepet mbështetje financiare për të ndjekur konferencat dhe veprimtaritë ndërkombëtare jashtë vendit. Për këtë

jepen për 20 vendet e para 5000 korona për çdo vend dhe 2500 korona shtesë për çdo vend mbi 20.

Çdo njësi pushteti vendor jep mbështetje financiare për partitë që përfaqësohen në këshillat e zgjedhura në bashki dhe në rajone.

GRUPET PARLAMENTARE NË RIKSDAG

Anëtarët e Riksdag-ut, që i përkasin një partie, ngrenë një grup parlamentar. Shtatë partitë që përfaqësohen sot në Riksdag kanë krijuar 7 grupe parlamentare. Grupet Parlamentare luajnë rol të rëndësishëm në punën e Riksdag-ut dhe në jetën politike në Suedi. Grupi ka një sekretariat që punon ngushtësisht me strukturat e organizmit partiak. Të gjitha çështjet e rëndësishme diskutohen nëpër grupe parlamentare, përpara se të arrihet në vendimet finale të komisioneve dhe të seancës plenare. Puna në grupe parlamentare ndërtohet bazuar në praktikën dhe rregullat e funksionimit të secilës parti, por ka dhe disa çështje organizative e procedurale që janë të njëjta për të gjitha grupet.

Dy grupet e para parlamentare në parlamentin suedez që dallohen që në fillim të viteve 1700, ishin Kasketat dhe Kësulat. Në fillim të shekullit të 19-të filluan të shfaqen dukshëm ideologjitë konservatore dhe liberale, por ende nuk kemi të formatuar ndonjë formacion politik partiak të përhershëm. E para parti politike e krijuar më 1867 është Partia Agrare, e cila për 20 vjet rresht luajti rolin më të rëndësishëm në jetën politike. Ndërmjet viteve 1887-1909, kur po ndjeheshin më shumë prirjet e tregut dhe të zhvillimit industrial, dy ishin grupet më të rëndësishme parlamentare, proteksionistët dhe mbështetësit e tregut të lirë. Konservatorët, liberalët dhe socialdemokratët janë tri grupet kryesore që u shfaqen në fillimet e shekullit të 20-të. Pas Luftës së Parë Botërore edhe dy parti të tjera i shtohen spektrit politik suedez, komunistët dhe Unioni Agrar. Ky sistem me 5 parti politike funksionoi për një kohë relativisht të gjatë, rreth 70 vjet, derisa në Riksdag hynë në vitin 1988 edhe të Gjelbërit.

Të gjitha grupet parlamentare udhëhiqen nga një bord. Grupi dhe anëtarët e tij asistohen në mënyrë të përhershme nga një sekretariat i udhëhequr nga një drejtor administrativ. Sekretariati ka në përbërjen e tij ekspertë, këshilltarë politikë dhe asistentë, të cilët punësohen nga partia, ndërsa madhësia e tij është në varësi të madhësisë së partisë, të peshës së saj zgjedhore. Socialdemokratët, bie fjala, kanë një sekretariat me 80 të punësuar, ndërkohë që të Gjelbërit kanë vetëm 15.

Grupet parlamentare mblidhen zakonisht të martave pasdite. Mbledhjet e grupeve parlamentare nuk janë të hapura për mediat dhe publikun. Agjenda përgatitet paraprakisht prej bordit. Edhe në grupet parlamentare puna ndërtohet me komisione, me një ndarje sipas fushave dhe specializimit të secilit anëtarë. Gjithë çështjet kryesore vendosen në grup para se të shkohet në komisione, vetëm disa çështje të thjeshta mund të vendosen nga anëtarët nëpër komisionet përkatëse. Në qëndrimet e deputetëve mbizotëron luajaliteti partiak dhe kjo konsiderohet e domosdoshme për mirëfunktionimin e sistemit parlamentar. Debatet brenda grupeve parlamentare janë shumë të gjalla, por ndonjë rebelim kundër linjës partiake bëhet historik në rast se ngjan. Sot në Riksdag funksionojnë 7 grupe parlamentare. Grupi Socialdemokrat me 144 deputetë, i krijuar që në vitin 1906, Grupi i Moderatorëve me 55 deputetë, i krijuar më 1904 dhe me emër disa herë të ndryshuar, Grupi i Liberalëve me 48 deputetë, i krijuar më 1902, Grupi i Kristiandemokratëve me 33 deputetë, i krijuar më 1964, Grupi i të Majtëve me 30 deputetë, i krijuar më 1917 dhe me emër disa herë të ndryshuar, Grupi i Qendrës me 22 deputetë, i themeluar më 1915 me origjinë nga Unioni Agrar, edhe ky me emër disa herë të ndryshuar dhe Grupi i të Gjelbërve me 17 deputetë, i krijuar në vitin 1981 me shtysë lëvizjet antibërthamore dhe lëvizjet feministe.

KONTROLLI PARLAMENTAR

Riksdag-u ka një fuqi veçantë për kontrollin e Qeverisë dhe të administratës publike. Kontrolli parlamentar çmohet si njëri prej obligimeve

më parimore të Riksdag-ut. Instrumentet përmes të cilave realizohet ky kontroll janë disa:

Komisioni Kushtetues

Mocioni i mosbesimit

Ombusmani i Riksdag-ut

Auditimi parlamentar

Pyetjet dhe interpelancat

Komisioni i Kushtetutës ka për detyrë të ekzaminojë të gjithë veprimtarinë e ministrave dhe detyrimet e Qeverisë në veprimtarinë e saj. Kontrolli nuk ka të bëjë vetëm me vëzhgimin, por kryesisht me masat që merren në veprimtarinë qeveritare. Nuk është më objektiv për të kontrolli *postfacto* i korrektësisë së vendimeve të Qeverisë ose të ministrave të veçantë, kontrolle që u përkasin të tjera mekanizmave. Kontrolli kryhet me nismë të Komisionit ose të deputetëve të veçantë, por nuk mund të kërkohet nga persona jashtë Riksdag-ut. Komisioni ka akses të ketë gjithë dokumentacionin që i përket çështjes. Raportet e posaçme paraqiten një deri dy herë në vit në Riksdag. Komisioni shpreh qëndrimet dhe pikëpamjet e tij lidhur me çështjet e kontrolluara, por seanca plenare nuk mund të marrë në këto raste ndonjë vendim kundër Qeverisë. Nëse ka debate të gjata, raporti plotësohet dhe i dërgohet Qeverisë. Kur nga kontrolli kanë rezultuar shkelje të rënda Komisioni dërgon për procedim penal çështjen ndaj ministrit përkatës në Gjykatën e Lartë. Gjithashtu, ky raport mund t'i paraprijë edhe një deklaratë mosbesimi dhe në këtë rast ministri është i detyruar të japë dorëheqjen, pasi nuk e ka më kofidencën e Riksdag-ut. E njëjta gjë mund të ndodhë edhe me Kryeministrin, vetëm se në këtë rast, kërkesa duhet mbështetur nga 35 deputetë. Në të gjitha rastet, pikëpamjet e komisionit e obligojnë Qeverinë të rikonsiderojë veprimtarinë e saj.

Ombusmani i Riksdag-ut është themeluar si institucion dhe ka filluar veprimtarinë e tij që nga viti 1809. Objektivi i Ombusmanit është të sigurojë që gjykatat, ashtu si edhe autoritetet e qeverisjes qendrore dhe vendore, i

kryejnë me korrektësi ligjore detyrat dhe detyrimet që janë subjekt i tyre. Ombusmani është një trup në të cilën çdo person mund të paraqesë një ankesë individuale për moskorrektësi të gjykatave dhe të autoriteteve. Për rastet serioze Ombusmani kërkon masa administrative ndaj zyrtarëve përgjegjës, por mund të pasohet kërkesa edhe me një akt penal. Ombusmani ka të drejtë të paraqesë propozime në Riksdag për ndryshime dhe përmirësime në legjislacion. Suedia ka sot në Riksdag 4 Ombusmanë, të cilët mbulojnë fusha të veçanta dhe zgjidhen nga Riksdag një herë në 4 vjet. Për të zhvilluar një veprimtari efektive, ata mbështeten nga një staf prej 50 ekspertësh.

Auditimi i Riksdag-ut ka sot 12 anëtarë të tij, të cilët zgjidhen për të kontrolluar veprimtarinë kombëtare të Qeverisë, por edhe të kompanive dhe fondacioneve të zotëruara nga shteti. Zyra e Auditimit ka një staf prej 25 ekspertësh. Institucioni udhëhiqet nga 3 Auditorë të Përgjithshëm, të cilët zgjidhen nga Riksdag.

REFERENDUMET

Suedia njih disa lloje referendumesh të cilat mund të organizohen në nivel qendror dhe vendor. Referendumi mund të jetë këshillimor dhe në këtë rast vendimi kryesor merret nga të tjera institucione dhe konkretisht Riksdagu në shkallë vendi ose këshillat vendore për rastet e referendumeve për çështje vendore. Referendumet mund të jenë edhe detyrues dhe në këtë rast veprohet pa asnjë vonesë në respektimin e vendimit për të cilin u votua.

Veçori ka edhe ndërmjet referendumeve që konsiderohen statutor (i njohur me ligj) dhe atyre që konsiderohen fakultativ. Referendumi është fakultativ, opsional, në rastet kur çështja mund të vendoset me referendum, por ka mundësi të vendoset edhe me rrugë të tjera. Ndërsa statutor janë referendumet për ato çështje të cilat përcaktohen për t'u vendosur vetëm me referendum. Vendimin për të mbajtur një referendum statutor e merr gjithmonë një asamble e zgjedhur si Riksdag-u ose këshillat vendore. Mund

të ndodhë që referendumi të mbahet edhe në përgjigje të kërkesës së një numri të caktuar qytetarësh, të cilët janë të interesuar për zgjidhjen e një çështjeje.

Realisht vendimet e rëndësishme në Suedi merren në Riksdag, që konsiderohet si trup përfaqësues i zgjedhur, ndërsa referendumet vështrohen si raste përjashtimore, madje vendimi i Riksdag-ut është e vetmja rrugë për të thirrur një referendum në shkallë vendi.

Praktika e referendumeve këshillimore ka filluar më 1922, kur është mbajtur referendumi për ndalimin me ligj. Që atëherë janë mbajtur edhe 4 të tjerë: më 1955 për ngjarjen e makinave djathtas, më 1957 për sistemin e pensioneve suplementare, më 1980 për energjinë bërthamore, më 1994 për anëtarësimin në BE.

Njerëzit, që nuk duan të votojnë për asnjërën prej alternativave në referendum, mund të hedhin një votë të bardhë, e cila ndryshe nga zgjedhjet parlamentare, në këto raste konsiderohet e vlefshme. Duke qenë këshillimore, këto referendume e lejojnë Riksdag-un të marrë një vendim ndryshe nga rezultati i referendumit, por përgjithësisht konsiderohet e vështirë të shkohet në drejtim të kundërt me këtë rezultat.

Kur në referendum ka disa alternativa, siç ishte rasti i referendumit të vitit 1957 për pensionet suplementare, është e vështirë që të interpretohet rezultati dhe, në këto raste, Riksdag-u ka të drejtën e interpretimit dhe të shpalljes së konkluzioneve. Që nga viti 1980 është bërë e mundur të mbahen edhe referendume që sjellin ndryshime në Kushtetutë, si dhe në marrëveshje ndërkombëtare të miratuara, të cilat prekin të drejta dhe detyrime që mbrohen me Kushtetutë. Ndryshimet në këto raste nuk marrin forcë vepruese, sepse pas vendimit të legjislaturës ekzistuese, është e domosdoshme që Riksdag-u i zgjedhur rishtas ta ratifikojë vendimin, ndryshe vendimi anulohet. Kërkesën për referendume të tilla kanë të drejtë ta paraqesin 35 deputetë, por kërkesa pranohet po që se votojnë pro 117 deputetë.

RIKSDAG-U DHE BASHKIMI EUROPIAN

Suedia është bërë anëtare në BE më 1 janar 1995. Duke marrë pjesë në vendimet që merr BE-ja, ajo ndërkohë është e detyruar t'u përshtatet vendimeve që merren nga BE-ja. Tri janë shtyllat kryesore të bashkëveprimit me BE-në:

- Bashkëveprimi mbikombëtar,
- çështjet që kanë të bëjnë me politikën e jashtme dhe me politikat e sigurimit,
- çështjet e drejtësisë dhe çështjet e brendshme.

Forma e vendimmarrjes është e ndryshme dhe lidhet me veçantitë e secilës prej këtyre tri shtyllave.

Anëtarësimi në BE do të thotë se Riksdag-u nuk është tashmë i vetmi autoritet legjislativ në Suedi. Fuqia legjislative është tani, gjithashtu, në varësi nga institucionet e BE-së, që të luajë rolin e tij si përfaqësuesi popullit suedez, Riksdag i duhet tashmë të jetë shumë aktiv në konsideratat kombëtare në çështjet e BE-së.

Në parim Riksdag-u e ushtron ndikimin e tij në BE përmes Qeverisë Suedeze dhe Qeveria është përgjegjëse para Riksdag-ut për rrugët që e lidhin Suedinë me çështjet e BE-së.

Qeveria për çdo rast është e detyruar të paraqesë raport me shkrim në Riksdag. Gjithashtu, në raport Qeveria paraqet edhe pikëpamjet e veta lidhur me propozimet dhe projektet.

Raportet dhe propozimet i kalohen komisioneve më të rëndësishme të Riksdag-ut. Komisionet janë në korent të të gjitha procedurave përgatitore në nivel specialistësh, në nivel të ministrave dhe të autoriteteve shtetërore – komisionet kanë të drejtë para se të përcjellin propozimet e tyre të marrin informacion shtesë. Komisioni mund të organizojë në këto raste edhe seancë dëgjimore me ekspertë dhe punonjës të shërbimit civil.

Qëndrimet e komisioneve parlamentare në këto raste ndjekin rrugë të ndryshme. Ato mund t'i përcillen me një raport seancës plenare dhe, në këtë rast, Riksdag-u merr një vendim.

Pikëpamjet e komisionit i adresohen ministrave përkatës dhe bëhen objekt debati në një mbledhje komisioni.

Por opinionet e një komisioni mund t'i shkojnë Komisionit Këshillimor për çështjet BE-së. Komisioni Këshillimor i merr parasysh këto opinione gjatë këshillimeve me përfaqësuesit e Qeverisë. Komisioni Këshillimor për çështjet e BE-së është një trup zyrtar i Riksdag-ut për këshillime me qeverinë. Ky Komision merr të dhëna paraprake dhe këshillohet për çështjet që do të vendosen në Këshillin e Ministrave, para se të merret vendimi. Kryeministri këshillohet, gjithashtu, në këtë Komision para se të shkojnë në takime në Këshillin e Europës. Komisioni përbëhet nga 17 anëtarë që janë nga parti të ndryshme dhe anëtarë në komisionet e tjera parlamentare.

Çdo të premtë Komisioni ka mbledhje me një ose disa anëtarë të Qeverisë, të cilët përgatiten të marrin pjesë në mbledhjen e javës në vazhdim të Këshillit të Ministrave. Këshillimet në Komision konkludohen edhe me vendim nga shumica e anëtarëve që shfaqen pro ose kundër qëndrimit paraprak të Qeverisë. Qeveria nuk është thjesht, formalisht e obliguar të ndjekë rekomandimet e Komisionit Këshillimor. Në rast se ajo nuk i konsideron këto rekomandime, atëherë rrezikon kritikizmin dhe ndërkohë një votë mosbesimi në Riksdag.

Seanca plenare është një formë e rëndësishme për transparencën maksimale të debateve që zhvillohen lidhur me çështjet e BE-së. Riksdag-u ka, gjithashtu, një qendër informacioni të BE-së që ka për detyrë të përcjellë informacion lidhur me BE-në dhe raportet e Suedisë me të.

Konflikti i interesave

Disa opinione të përgjithshme mbi gjendjen aktuale dhe hapat e ardhshëm në trajtimin e konfliktit të interesit

*Ardian Dvorani
Drejtor i Përgjithshëm i Departamentit të
Kodifikimit, Ministria e Drejtësisë*

Çfarë është konflikti i interesave?

Ka përkufizime të ndryshme lidhur me këtë çështje në varësi të shkollave juridike e administrative, të traditave, shkallës së zhvillimit të çdo vendi etj. Megjithatë, në parim, në nivel ndërkombëtar mund të gjejmë një konceptim dhe përkufizime të njësuara ose krejt të ngjashme.

Konflikti i interesave përbën një gjendje, një rrethanë, në të cilën një nëpunës publik ka ose mund të ketë potencialisht një interes privat, i cili ndikon ose mund të ndikojë në përmbushjen e rregullt, të paanshme dhe objektive të detyrës publike që i është ngarkuar sipas ligjit.

Po kështu, pavarësisht nga variacionet e konceptimit dhe të zbatimit në përvoja të ndryshme, me interes privat, në përgjithësi kuptohet çfarëdo lloj përfitimi dhe përparësie, për veten, familjarët, të afërmit dhe persona të tjerë të lidhur me nëpunësin që realizohet ose mund të realizohet, në sajë të përfitimit nga qenia në detyrë dhe funksioni publik përkatës. Në këtë koncept përfshihet edhe rasti kur nëpunësi publik, në përmbushjen e detyrës së tij, ndikohet ose mund të ndikohet sipas rrethanave nga detyrime financiare ose të një natyre tjetër, për të krijuar ose lejuar përparësi të çdo natyre kundrejt personave të tretë.

Lidhja e konfliktit të interesave me dukurinë e korrupsionit

Parandalimi dhe shmangia e konfliktit të interesave parandalon dukurinë e korrupsionit, forcon kulturën e administratës publike.

Ekzistenca dhe prania e konfliktit të interesave, parregullsitë në ushtrimin e detyrës dhe korrupsioni që mund të shoqërojë, rrjedhë ose favorizohet prej tyre përbëjnë një kërcënim serioz për forcimin e shtetit të së drejtës, të demokracisë dhe parimeve demokratike, për ushtrimin dhe respektimin e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, për barazinë dhe drejtësinë sociale, për stabilitetin dhe zhvillimin e institucioneve demokratike, për zhvillimin ekonomik dhe social, për parimet dhe themelet morale mbi të cilat ndërtohet një shoqëri moderne.

Zyrtarët publikë janë elementë kryesorë në suksesin dhe performancën e administratës publike dhe të shërbimit publik. Ata kanë të drejta dhe detyrime ligjore. Për t'i respektuar ato, ata duhet të kenë kualifikimet e nevojshme morale dhe profesionale.

Vendosja, konsolidimi dhe respektimi i misionit dhe i detyrës së zyrtarëve publikë bën të domosdoshme ngritjen dhe funksionimin efektiv të një sistemi ligjor dhe institucional kompleks dhe të standardizuar, lidhur me rregullat dhe normat që duhet të mbajnë parasysh, të njohin, të respektojnë dhe të garantojnë nëpunësit dhe funksionarët publikë.

Ligj i posaçëm ose strategji për rregullime normative dhe të brendshme të standardizuara dhe njësuara në fusha të veçanta të legjislacionit dhe, domosdoshmërisht, në ato elemente të tij që përbëjnë themelet mbi të cilat ngrihet nga pikëpamja ligjore dhe institucionale koncepti, misioni, përgjegjësitë, kompetencat e institucioneve dhe të veprimtarive tona publike, të drejtat dhe detyrat e zyrtarëve publikë dhe të atyre që me ligj u janë ngarkuar ose kanë pranuar të ushtrojnë veprimtari edhe private, por që përmbajnë interesin dhe arsyen e rëndësishme publike ose që u është deleguar, ose janë kontraktuar për kryerjen e një fushe të veprimtarisë së domain-it publik.

Analizë dhe vështrim në legjislacionin shqiptar

Ky legjislacion është krejtësisht i ri, duke filluar që nga Kushtetuta. Legjislacioni aktual është hartuar dhe implementohet vetëm në një hark kohor tepër të shkurtër (1991-2003), me detyrimin dhe përpjekjet për konceptimin dhe hartimin e legjislacionit të ri njëkohësisht dhe pa ndërprerje në të gjitha fushat, me burime njerëzore dhe financiare tepër të kufizuara, me një mendësi, përvojë demokratike, institucionale, administrative dhe legjislative tepër të mangëta, me asistencën vendimtare të institucioneve ndërkombëtare, por të shoqëruar, njëkohësisht, jo rrallë edhe me ndikime, edhe subjektive e vetjake, si dhe standarde, madje edhe shkolla e tradita të së drejtës që ndryshojnë nga njëra – tjetra. Kjo e fundit është dukuri që po pakësohet nga viti në vit, por që ende mbetet një faktor që kërkon vëmendje.

Nuk është rasti të trajtohen anët pozitive të këtij revolucioni legjislativ dhe konceptues në shërbimin publik dhe në të drejtën tonë publike. Te ne, si kudo, sistemi, institucionet dhe legjislacioni janë dhe mbeten në një proces të vazhdueshëm zhvillimi. Nëse kësaj dukurie të natyrshme i shtojmë edhe mangësitë që reflektohen si rezultat e atij revolucioni të lartpërmendur, bëhet më se e qartë nevoja për të konceptuar dhe ndërtuar një strategji kombëtare me masa legjislative, institucionale dhe edukative për forcimin e shërbimit tonë publik, për ngritjen dhe konsolidimin e mekanizmave të evidentimit dhe të kontrollit të veprimtarisë publike, për rritjen e transparencës, shkallës së hapjes, llogaridhënies dhe ndërgjegjësimit të zyrtarëve publikë dhe shtetasve të tjerë, përsa i përket garantimit të shërbimit publik për qytetarët, minimizimit të papërgjegjshmërisë, njëanshmërisë, paaftësisë, mosrespektimit të rregullave dhe detyrave të ngarkuara, sigurimit për vete ose të tretë të përfitimeve të padrejta, abuzimit me detyrën publike dhe besimin publik, deri në veprimtari kriminale të shpërdorimit të detyrës, korrupsionit, krijimit të hapësirave dhe hallkave të dobëta institucionale që nxisin, mbajnë dhe ushqejnë pafuqishmërinë dhe ineficencën e forcës goditëse e parandaluese të shtetit, lidhjen ose bashkëpunimin e zyrtarëve publikë me krimin, përfshirë krimin e organizuar dhe terrorizmin në të gjitha format e tyre.

Sikurse në fusha të tjera të së drejtës, edhe lidhur me çështjet e papajtueshmërive dhe të konfliktit të interesave, legjislacioni dhe praktikrat tona institucionale e më gjerë, karakterizohen, në një shkallë të pajustificueshme, nga konceptime dhe implementime të standardeve të ndryshme, paqartësi në përmbajtje dhe në formën e zbatuar, si dhe nga përsëritje ose edhe mbivendosje e kundërshti, duke filluar nga përkufizimi dhe konceptimi i konfliktit të interesave dhe papajtueshmërisë dhe deri te procedurat dhe mekanizmat e identifikimit, parandalimit dhe goditjes së tyre. Përveç kësaj, në pjesë të caktuara të legjislacionit, përfshirë edhe atë kryesor, ka raste kur për këto çështje nuk parashikohet asgjë shprehimisht, madje as edhe nuk bëhen referime ose delegime për rregullim të mëtejshëm nënligjor.

Nisur nga një këndvështrim i përgjithshëm, në përvojën dhe praktikën ndërkombëtare ka dy përjasje legjislative për parashikimin dhe implementimin e rregullave, lidhur me papajtueshmëritë dhe konfliktin e interesave. Në disa shtete janë hartuar dhe zbatohet legjislacioni i posaçëm për konfliktin e interesave, ndërsa në disa shtete të tjera janë marrë dhe merren masa legjislative të vazhdueshme për reflektimin në fushat e ndryshme të së drejtës publike të normave të nevojshme për trajtimin e këtyre çështjeve dhe dukurive.

Mënyra e decentralizuar e zgjidhjeve ligjore, lidhur me konfliktin e interesave, mendoj se është mënyra më e përshtatshme dhe efektive për t'u zbatuar në legjislacionin shqiptar, me kusht që sikurse është arritur dhe punohet në disa vende të zhvilluara, këto zgjidhje t'i përmbahen një fryme, parimeve, mekanizmave dhe procedurave të standardizuara.

Në këtë mënyrë është bërë trajtimi i konfliktit të interesave në shtete të zhvilluara dhe me tradita juridike dhe demokratike, si Franca, Gjermania, Italia etj.

Parësisht se nuk ka ekzistuar ndonjë politikë ose strategji e posaçme, si dhe mangësive të shumta që vërehen, për aq sa është parashikuar, edhe legjislacioni ynë aktual ka ecur në rrugën e rregullimeve të decentralizuara të çështjes së konfliktit të interesave, duke pasur në këtë legjislacion edhe

disa akte të rëndësishme që përmbajnë rregullime të detyrueshme për zbatim në të gjithë shërbimin publik ose të mundshme për t'u reflektuar në fusha dhe dispozita ligjore të veçanta.

Në fakt edhe shkolla jonë e së drejtës, pavarësisht nga problemet e së kaluarës dhe ndikimet që ka pasur nga shkolla të ndryshme, ka arritur të konfirmojë traditën e saj dhe përkatësinë ndaj shkollës të së drejtës franko-romane. Në fund të fundit, edhe pse janë në evolucion, ku përfshihen përpjekjet për të asimiluar praktika të mira të shkollave të tjera, kjo shkollë është mjaft e konsoliduar dhe mbizotëruese në të drejtën europiane, përfshirë edhe atë komunitare.

Në kushtet kur pika e orientimit të shtetit shqiptar është integrimi evropian dhe përafrimi i legjislacionit me atë të Bashkimit Evropian, nisur edhe nga arsyet e mësipërme, edhe e drejta publike shqiptare duhet të reformohet dhe të zhvillohet, duke ndjekur arritjet e shkollës franko-romane. Në të njëjtën mënyrë, mendoj se duhet të kërkohen zgjidhjet edhe për zhvillimin e decentralizuar të së drejtës sonë publike, por edhe asaj private, përsa i përket konfliktit të interesave dhe integritetit të shërbimit publik dhe veprimtarisë private, në respektim të parimeve demokratike dhe të drejtave të njeriut dhe lirive themelore.

Për të realizuar reformën legjislative dhe marrjen e masave institucionale në drejtim të ndërgjegjësimit, identifikimit, parandalimit dhe goditjes së dukurisë të konfliktit të interesave, nevojitet të punohet, mbështetur në standardizimin e këtij procesi dhe të zgjidhjeve që ofrohen, si dhe të njësimimit dhe të kodifikimit të terminologjisë, përkufizimeve, rasteve, procedurave dhe mekanizmave që kanë të bëjnë me çështjet e konfliktit të interesave.

Respektimi i standardeve që duhen mishëruar në politika, norma dhe rregulla të veçanta duhet të realizohet në planin e brendshëm dhe të jashtëm.

Në planin e jashtëm nevojitet të njihen dhe zbërthehen standardet ndërkombëtare, zgjidhjet dhe praktikat më të mira dhe të konsoliduara europiane.

Në planin e brendshëm, nevojitet që, në përputhje me veçantitë që lidhen me historinë, traditat dhe shkallën tonë të zhvillimit, të implementohen në mënyrë standarde parimet, normat dhe praktikat më të mira dhe të konsoliduara të së drejtës ndërkombëtare.

Për këtë qëllim nevojitet diskutimi institucional dhe publik i çështjeve dhe problemeve me të cilat përballet shteti dhe shoqëria shqiptare përsa i përket konfliktit të interesave, efekteve negative që ato sjellin për zhvillimin e vendit, për ndikimin e drejtpërdrejtë të tyre në performancën dhe përmbushjen e misionit të shërbimit publik, në lidhjet që ekzistenca e tyre ka me krijimin e premisave dhe të rrethanave për korrupsion, të pengesave që u bën përpjekjeve për të parandaluar dhe goditur dukuritë korruptive, si dhe të ngadalësimit të përpjekjeve për edukimin dhe ndërgjegjësimin e zyrtarëve publikë dhe të qytetarëve, për të perceptuar dhe marrë pjesë aktive dhe efektive në parandalimin dhe goditjen e këtyre dukurive.

Ky diskutim shumëpalësh mund dhe duhet të prodhojë një strategji dhe plan masash e veprimesh konkrete e gjithëpërfshirëse për të identifikuar, miratuar dhe zbatuar hapat përkatës ligjorë dhe institucionalë për minimizimin e shfaqjes ose të mundësisë së shfaqjes të dukurisë dhe rasteve të konfliktit të interesave.

Ndërmjet të tjerave, nevojitet të diskutohen problemet dhe të propozohen zgjidhjet, lidhur me zhvillimin e legjislacionit dhe të praktikave institucionale për identifikimin dhe zbatimin e parimeve të përgjithshme dhe të çështjeve të veçanta që kanë të bëjnë me funksionet, kompetencat, të drejtat dhe detyrimet e institucioneve dhe të zyrtarëve publikë, përkufizimi i përgjithshëm dhe detajet sipas fushave të veçanta të dukurisë së konfliktit të interesave, procedurat, strukturat dhe mekanizmat e identifikimit, të parandalimit dhe goditjes së kësaj dukurie, lidhja dhe dallimi i tij me dukurinë e korrupsionit.

Nisur nga fryma dhe parimet e përgjithshme të Kushtetutës sonë, lidhur me shërbimin publik dhe zyrtarët publikë, standardet ndërkombëtare dhe përvojat më të mira të shteteve të zhvilluara, me masat që duhet të merren

për konfliktin e interesave, kërkohet të përfshihen të gjitha kategoritë e funksionarëve dhe nëpunësve publikë: të zgjedhurit në pushtetin qendror dhe vendor, funksionarët kushtetues, gjyqtarët dhe prokurorët, funksionarët e tjerë politikë, funksionarët dhe nëpunësit e pushtetit vendor, nëpunësit civilë, nëpunësit publikë të pushtetit qendror që aktualisht nuk përfshihen në grupin e nëpunësve civilë, funksionarët e organeve drejtuese dhe punonjësit e subjekteve të së drejtës private që ushtrojnë funksione publike ose që ushtrojnë veprimtari me interes publik. Këto standarde mund të shërbejnë si orientim edhe për subjektet e tjera private që nuk përfshihen në grupin e mësipërm, duke i ftuar dhe nxitur për zbatimin e tyre, për aq sa janë kompatibël dhe mund t'i shërbejnë pastërtisë dhe konsolidimit të nismës së lirë dhe ekonomisë së tregut.

Paraprakisht, masat që duhet të ndërmerren mund të synojnë në gjetjen dhe zbatimin e rregullave standarde, lidhur me përkufizimin dhe rastet e konfliktit të interesave, me procedurat dhe mekanizmat e vetëdeklarimit dhe të identifikimit të këtyre konflikteve, rast pas rasti ose në mënyrë sistematike, me procedurat për mënjanimin ose parandalimin e konfliktit të interesave mbi bazën e vullnetit të të interesuarit ose në mënyrë të detyrueshme nga mekanizmat monitoruese dhe kontrolluese, me procedurat e ndëshkimit në rast të dështimit të procedurave të mësipërme, me çështjet e transparencës e hapjes ndaj publikut dhe monitorimit prej tij të performancës së institucioneve dhe zyrtarëve publikë përsa i përket konfliktit të interesave, papajtueshmërive dhe korrupsionit.

Përsa i përket mjeteve ligjore bazë ku mund të mbështetet ky aksion vlen të përmenden Kushtetuta, Kodi i Procedurave Administrative, Kodi i Procedurës Civile, Kodi i Procedurës Penale, ligji për etikën në shërbimin civil, ligjet për organizimin dhe funksionimin e organeve të parashikuara në Kushtetutë, ligjet “konstitucionale” të nxjerra në bazë dhe për zbatim të parashikimeve konkrete të Kushtetutës.

Zgjidhjet klasike ligjore, ku mund të mbështetet ky proces, janë hartimi dhe zbatimi i dispozitave shtesë ose ndryshuese në aktet ligjore ekzistuese

me synim rregullimin e drejtpërdrejtë në këto akte ligjore të çështjeve që kanë të bëjnë me konfliktin e interesave, parashikimi i parimeve dhe i çështjeve kryesore, duke e deleguar rregullimin e hollësishëm në akte nënligjore normative ose rregullore me karakter të brendshëm, ose referimi për zbatim të dispozitave të parashikuara në ligje të tjera.

Në çdo rast, pavarësisht nga zgjidhja që ofrohet, është i domosdoshëm orientimi i tyre sipas standardeve të paracaktuara, si dhe parashikimi, pa përjashtim, i detyrueshmërisë së organeve përgjegjëse për rregullimin e hollësishëm nënligjor dhe të brendshëm të problemeve të lidhura me konfliktin e interesave.

Deklarimi dhe kontrolli i pasurive të funksionarëve të zgjedhur dhe atyre të administratës publike, një praktikë e re në luftën kundër korrupsionit

Sokol LAMAJ
Jurist

Në jetën e përditshme përballemi me dukuri, të cilat për kulturën dhe shoqërinë në të cilën jetojmë nuk janë ende të njohura mirë dhe reagimi ndaj tyre është i ngadalshëm dhe i vështirë për t'u kuptuar. Shqipëria është një prej vendeve të Europës Lindore, të cilët pas viteve '90 gradualisht filluan të përshtateshin dhe të zbatonin politikat dhe sistemin e ekonomisë së tregut në vendin e tyre, si dhe të synonin ndërtimin e kapitalizmit në mënyrë graduale. Një gjë e tillë solli edhe nevojën e njohjes së traditave, të problemeve dhe të dukurive jopozitive që shoqëronin këtë kalim. Për këtë lindi nevoja e familjarizimit të proceseve dhe dukurive të panjohura më parë, por që në vendet e Europës Perëndimore ishin zbatuar me sukses. Në këtë kuadër edhe Shqipëria filloi të zbatonte procedurat dhe ligjet e nevojshme që do ta çonin atë drejt vendeve të ekonomisë së tregut dhe kapitalizmit të zhvilluar. Por si të gjitha vendet e tjera europiane lindore e juglindore, krimi i organizuar dhe korrupsioni filluan të merrnin përmasa të konsiderueshme, pasi kuptohej që shteti dhe strukturat e tij ishin ende të dobëta; nuk i njihnin këto dukuri të reja. Në këto kushte, sidomos në rajonin e Ballkanit, u vërejt se lufta kundër korrupsionit galopant duhej të luftohej nëpërmjet një administrate dhe kuadri

ligjor të fortë dhe të përshtatshëm për vendin dhe psikologjinë e shtetasve.

Ky element bëri të nevojshëm edhe hartimin e ligjit për deklarimin e pasurive për zyrtarët e zgjedhur dhe për ata të administratës së lartë publike. Nëse do të ndalemi paksa në historikun e kësaj praktike për kontrollin e pasurive të zyrtarëve të lartë, do të thoshim se për herë të parë një praktikë e tillë u krijua me ligjin nr.7903, datë 8.3.1995 “Për deklarimin e pasurisë të të zgjedhurve dhe të disa drejtuesve e punonjësve të shërbimit publik”. Zbatimi i këtij ligji shumë shpejt u vërejt se nuk mund të zbatohet për mënyrën, formën dhe strukturën e funksionimit të tij, si dhe për vetë kompetencat që i ishin dhënë. Megjithatë, kryesorja ishte se në mendësinë e njerëzve, të zyrtarëve dhe administratës së të gjitha niveleve ishte krijuar një formë dhe praktikë e re e kontrollit dhe e luftës kundër korrupsionit që ishte kontrolli dhe verifikimi i pasurisë.

Në kuadrin e zgjerimit të frytshmërisë së luftës kundër korrupsionit, Kuvendi miratoi ligjin nr.9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”.

Ligjvënësi ka pasur për qëllim me këtë ligj rregullimin e disa marrëdhënieve juridike dhe krijimin e disa rregullave të reja, siç janë:

- përcaktimi i subjekteve që i nënshtrohen procesit të deklarimit të pasurisë;
- përcaktimi i rregullave për deklarimin dhe kontrollin e pasurisë;
- përcaktimi i legjitimitetit të burimeve të krijimit të këtyre pasurive; dhe
- përcaktimi i detyrimeve financiare për të gjithë subjektet që, sipas ligjit,

kanë detyrimin për të deklaruar.

Po të marrim elementin e parë, atë të përcaktimit të subjekteve, vërejmë se ligji ka përcaktuar tri karakteristika në mënyrën e caktimit të subjekteve që kanë detyrim të deklarojnë pasurinë dhe detyrimet financiare. Karakteristika e parë është që për institucionin e Inspektoratit të Lartë, ligji ka përcaktuar me saktësi se cilat do të jenë subjektet që do të deklarojnë pasurinë. Ligji në nenin 3 pika 1 ka dhënë një kategorizim të qartë të funksioneve dhe strukturave që

do të deklarojnë pasurinë, pavarësisht nëse këta janë të zgjedhur ose nëpunës të nivelit të lartë a të mesëm drejtues të administratës publike.

Karakteristika e dytë në përcaktimin e funksioneve, që do të deklarojnë pasurinë, është e drejta e titullarit të ministrisë ose e institucionit qendror të përcaktojë se kur një punonjës i administratës publike përmbush qoftë edhe një prej tri kushteve të vëna nga ligji ai do të jetë i detyruar të deklarojë pasurinë. Kështu, në nenin 3 pika 2 të ligjit është përcaktuar se “Mbartin detyrimin për deklarim të pasurisë në inspektoratin e ulët:

Subjektet që përcaktohen nga titullarët e ministrive dhe të institucioneve qendrore, sipas paragrafit të parë të nenit 18 të këtij ligji, duke përfshirë detyrimisht:

a) autoritetet që urdhërojnë dhe autorizojnë përdorimin e fondeve publike dhe që i prokurojnë ato;

b) personat që ngarkohen me mbledhjen dhe vjeljen e të ardhurave të buxhetit, qendror e vendor;

c) nëpunësit publikë që mbikëqyrin përdorimin e fondeve publike dhe ata që, sipas ligjit, shqyrtojnë dhe japin licenca.

Karakteristika e tretë është se kategoria e subjekteve që detyrohen të deklarojnë pasurinë nuk është statike, por ajo mund të ndryshojë. Kështu, ligji ka përcaktuar se Kuvendi, me propozim të Inspektorit të Përgjithshëm, vendos detyrimin për deklarim të pasurisë për funksione të tjera të paparashikuara në këtë ligj. Të gjithë jemi dëshmitarë që strukturat e ministrive dhe të institucioneve të administratës nuk janë statike, por ato ndryshojnë në funksion të punës dhe të veprimtarisë së tyre, duke iu përshtatur sa më mirë ushtrimit të funksioneve. Në këtë kuadër do të ishte shumë e vështirë që pas çdo ndryshimi strukturor të institucioneve ose të krijimit të institucioneve të reja të bëhej përshtatja e tyre në ligjin përkatës. Pra, ndryshimi i ligjit do të ishte i shpeshtë dhe i vështirë për t’u realizuar. Në këtë mënyrë kjo dispozitë garanton një koherencë të strukturave të deklarimit rast pas rasti, si dhe një qëndrueshmëri të ligjit.

Në strukturën e tij ky ligj ka krijuar dy nivele të organizimit të deklarimit të pasurisë dhe të kontrollit e të verifikimit të saj. Niveli i parë është institucioni i Inspektoratit të Lartë dhe niveli i dytë është ai i inspektorateve të ulta.

Në ligj Inspektorati i Lartë është përcaktuar si një institucion i pavarur, i cili ka për qëllim organizimin e punës. Krijimi i një institucioni të tillë garanton sipas ligjit një paanshmëri politike, institucionale dhe profesionale të kontrollit të pasurive, një realizim të procedurave të kontrollit nga struktura joqeveritare dhe të garantimit të një procesi të rregullt ligjor në verifikimin e pasurive. Ligji i ka dhënë një pavarësi organizative dhe funksionale këtij institucioni. Po t' i referohemi nenit 16 të ligjit, vërejmë se ligjvënësi e ka përcaktuar këtë institucion si person juridik publik, i cili nën përgjegjësinë e Inspektorit të Përgjithshëm administron deklarin e pasurisë, të detyrimeve financiare dhe kontrollin e këtij deklarimi. Struktura organizative e Inspektoratit të Lartë caktohet nga Inspektori i Përgjithshëm. Ligjvënësi ka parashikuar edhe një mbrojtje të veçantë për inspektorët e lartë që do të kryejnë kontrollin dhe verifikimin e pasurisë për të gjitha subjektet e përcaktuara sipas ligjit. Kjo mbrojtje realizohet sipas ligjit për statusin e nëpunësit publik. Kjo dispozitë garanton, gjithashtu, që përzgjedhja e këtyre inspektorëve të bëhet nëpërmjet konkurrimit dhe përzgjedhjes së kandidatave më të mira në procesin e rekrutimit, sipas procedurave që ka parashikuar ligji për statusin e nëpunësit publik, si dhe sipas akteve nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij. Në mënyrë të veçantë do të theksonim se ligjvënësi realisht ka dashur t' i japë një pavarësi organizative dhe funksionale këtij institucioni, kur ai ka përcaktuar se Inspektorati i Lartë ka buxhetin e vet të pavarur, të caktuar nga Kuvendi, i cili vendos numrin dhe pagat e punonjësve të këtij institucioni.

Inspektorati i Lartë drejtohet nga Inspektori i Përgjithshëm. Ky inspektor, sipas ligjit është organi përgjegjës për kontrollin e deklarimit të pasurive. Është një element shumë i rëndësishëm evidentimi i mënyrës së zgjedhjes dhe caktimit të Inspektorit të Përgjithshëm, si dhe të kriterëve për zgjedhjen e tij. Ligji ka përcaktuar rregulla të sakta për kriteret dhe kushtet që duhet të

përmbushë kandidati, i cili do të zgjidhet në këtë detyrë. Në nenin 11 pika 2 dhe në nenet 12, 13 e 14 të ligjit janë përcaktuar kushtet për t'u zgjedhur, papajtueshmëritë dhe mbarimi i mandatit të Inspektorit të Përgjithshëm. Një përcaktim i tillë i kushteve bën që drejtimi i institucionit të sigurojë një mbështetje të gjerë politike, një profesionalizëm dhe një qëndrueshmëri në veprimtarinë e tij.

Ligji i ka dhënë Inspektorit të Përgjithshëm dy kompetenca:

a) drejton Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, për të kontrolluar deklarinimin dhe legjitimitetin e burimeve të pasurive të deklaruara nga subjektet e parashikuara nga ky ligj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë;

b) njofton, rast pas rasti, Presidentin, Kuvendin, Këshillin e Lartë të Drejtësisë, Këshillin e Ministrave, Kryeministrin, ministrat dhe drejtuesit e institucioneve qendrore për parregullsitë e vërtetuara në deklarinimin e pasurisë nga punonjësit në juridiksionin e tyre.

Inspektorati i ulët krijohet dhe funksionon pranë institucioneve të administratës publike në nivel qendror ose vendor, në institucionet e pavarura, pranë organeve të pushtetit vendor, në prefektura, në institucionet financiare dhe shoqëri aksionere ku shteti zotëron paketën e aksioneve prej mbi 50 për qind. Përfshirja nga ky rregull bëjnë bashkitë dhe komunat, pasi sipas përcaktimit që bën Inspektori i Përgjithshëm, deklarimi i pasurisë së punonjësve të tyre do të bëhet pranë inspektorateve të ulta të qarkut. Inspektorati i ulët krijohet me urdhër të titullarit të institucionit dhe përbëhet nga 3 deri në 5 vetë. Ky përcaktim i ka lënë hapësirë dhe mundësi titullarëve të institucioneve që në varësi të numrit të subjekteve të mund të përcaktojnë edhe numrin e inspektorateve të ulta, por në të njëjtën kohë ligji ka rregulluar dhe përcaktuar konkretisht subjektet e deklarinimit, duke shmangur amullinë që mund të shkaktonte një dispozitë e përgjithshme, sic ka qënë rasti i ligjit të mëparshëm, i cili thoshte se të gjithë punonjësit duhet të deklaroheshin pasurinë. Kryetari i këtij inspektorati është drejtori i personelit, kurse anëtarë janë një

specialist i zhvillimit të burimeve njerëzore dhe nëpunës të tjerë më profesion ekonomistë dhe juristë. Është interesante të vërejmë se ligjvënësi nuk i ka krijuar këto struktura si njësi më vete të pavarura dhe jashtë institucioneve, por i ka parashikuar brenda tyre, me punonjës të vetë asaj administrate dhe me detyra të përcaktuara. Ky është një element që e bën këtë ligj më tepër të zbatueshëm, si dhe siguron një veprimtari dhe transparencë shumë korrekte brendapërbrenda një institucioni. Është e qartë që këto struktura sigurojnë një administratë të pastër, transparente kundrejt publikut në çdo kohë dhe për çdo problem që lidhet me pastërtinë e figurës, në kuadrin e pasurisë së ligjshme që ka vendosur çdo nëpunës i asaj administrate. Korrupsioni dhe mundësia e zvogëlimit të saj në mënyra dhe metoda sa më të frytshme e bën këtë strukturë shumë të rëndësishme për titullarin e institucionit, me qëllim drejtimin dhe administrimin me punonjës sa më të mirë, profesional dhe të pacenuar nga pikëpamja e korrupsionit. Sigurimi i një administrate me nëpunës të pakorruptuar dhe të pastër do të bëjë që titullari i atij institucioni të jetë sa më i hapur, transparent dhe i interesuar për një gjë të tillë.

Ky inspektorat luan një rol shumë të rëndësishëm në organizimin e punës për shpërndarjen e deklaratave të pasurisë të deklaruesi, asistimin e tyre në procesin e deklarimit, kur është e nevojshme dhe grumbullimin e deklaratave. Kjo gjë evidentohet në nenin 19 shkronja “a” e ligjit, ku është përcaktuar se “a) organizon dhe kryen kontrollin e deklarimit të pasurive të emërtesës së caktuar dhe i raporton titullarit të ministrisë ose institucionit qendror rezultatet e kontrollit, sipas afateve të caktuara prej tij, duke paraqitur edhe propozimet përkatëse për shkeljet dhe parregullsitë, në përputhje me ligjin nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil” dhe Kodin e Punës”. Një element shumë i rëndësishëm është kontrolli i deklarimit të pasurive që ka në kompetencën e tij ky inspektorat dhe më pas raportimi që ai bën te titullari i institucionit për rezultatet e këtij kontrolli.

Një kompetencë tjetër shumë e rëndësishme e inspektoratit të ulët është edhe grumbullimi dhe dërgimi në Inspektoratin e Lartë të të gjitha deklarimeve

që janë në emërtesë të këtij të fundit, si dhe e njofton atë periodikisht për mosdeklarimet, parregullsitë dhe kundravajtjet e zbuluara nga kontrollat e kryera. Është e qartë se sipas nenit 3 të ligjit, subjektet që i nënshtrohen kontrollit të Inspektoratit të Lartë janë të shumta dhe janë funksionare të zgjedhur në organet qendrore ose vendore, si dhe nëpunës të nivelit të lartë dhe të mesëm drejtues. Shpërndarja dhe grumbullimi i dekaratave të pasurisë, si dhe asistimi me këshillime i të gjitha subjekteve që kanë detyrim për deklarim pranë këtij institucioni, do të ishte i pamundur nga vetë Inspektorati i Lartë si një institucion qendror me një numër të kufizuar nëpunësish. Në këto kushte përcaktimi dhe dhënia e kompetencës së organizimit dhe të grumbullimit të deklarimeve nga inspektorati i ulët tek ai i Lartë, e bën inspektoratin e ulët një strukturë shumë të frytshme, kompetente dhe me kompetenca të gjera e të mjaftueshme, shumë e rëndësishme kjo për procesin e shpërndarjes dhe grumbullimit të informacionit. Një element tjetër i rëndësishëm është edhe asistimi i të gjitha subjekteve që mbartin detyrimin për deklarim nga inspektori i ulët. Është e qartë se çdo subjekt në procesin e deklarimit është i interesuar të njihet me procesin, me aktet ligjore e nënligjore që e detyrojnë atë të deklarojë pasurinë, mënyrën se si duhet ta kryejë ai këtë deklarim etj. Transparenca e veprimtarisë së inspektoratit të ulët dhe procesi i grumbullimit të informacionit të saktë, korrekt dhe të vërtetë ka qënë një qëllim i përcaktuar i ligjvënësist në dispozitat ku ai ka parashikuar kompetencat e inspektoratit të ulët.

Po nëse deri tani kemi folur për strukturat që ka parashikuar ligji për deklarimin dhe kontrollin e pasurisë, më poshtë do të ndalemi në mënyrën se si ligjvënësi e ka parashikuar procesin e deklarimit dhe të kontrollit të pasurisë për të gjithë subjektet që e kanë për detyrim një gjë të tillë.

Deklarimi i pasurisë rregullohet nga kreu i tretë i ligjit. Ai bëhet nëpërmjet një forme dhe modeli të *përcaktuar* nga Inspektori i Përgjithshëm. Ky deklarim duhet të përfshijë pasurinë e subjektit që deklaron, të familjes së tij, burimet e krijimit dhe detyrimet financiare të subjektit. Me deklarim të

pasurisë së familjes së tij ligjvënësi ka përcaktuar bashkëshortin ose bashkëshorten dhe fëmijët në moshë madhore. Gjithashtu, është e detyrueshme për t'u deklaruar edhe fakti nëse deklaruesi ka ose jo persona të tjerë të lidhur. Kjo për arsye se gjatë veprimtarisë së punës shtetërore çdo nëpunës i zgjedhur ose publik, i cili mbart detyrimin për deklarim, mund të ketë kapitale, aksione, pasuri të luajtshme a të paluajtshme ose lidhje pasurore me një ose disa persona të tjerë. Të gjithë këta persona fizikë a juridikë, të cilët nga kërkimet administrative rezultojnë të kenë lidhje me subjektin që ka për detyrim deklarimin e pasurisë, duhet të paraqiten në deklaratë.

Deklarimi sipas ligjit është katër llojesh:

- deklarimi i parë;
- deklarimi me kërkesë;
- deklarimi pas largimit nga funksioni; dhe
- deklarimi para fillimit të punës.

Deklarimi i parë është sipas ligjit deklarimi që bën çdo nëpunës publik, i zgjedhur ose jo në çastin e hyrjes në fuqi të këtij ligji, për të gjitha pasuritë e grumbulluara ose të akumuluar, për detyrimet financiare që ata kanë dhe burimet e origjinën e tyre.

Më sipër folëm për detyrimin që kanë subjektet që në deklaratën e pasurisë të pasqyrojnë edhe personat e lidhur me ta. Nëse gjatë procesit të kërimit administrativ është e nevojshme që personat fizikë ose juridikë, të lidhur me subjektin, duhet të deklarojnë pasurinë, atëherë Inspektori i Përgjithshëm ka të drejtë të kërkojë deklarimin e pasurive për këto subjekte dhe burimet e krijimit të tyre. Në këtë rast, ky lloj deklarimi sipas ligjit do të quhet deklarim me kërkesë. Në këtë rast Inspektorati i Lartë ka të drejtën e kontrollit dhe të verifikimit të pasurisë edhe për këto subjekte.

Ligjvënësi ka parashikuar detyrimin për deklarim të subjekteve, të cilët, edhe pse janë larguar nga funksioni që kanë pasur, përsëri kanë detyrimin për deklarim të pasurisë dhe të detyrimeve financiare edhe për një periudhë kohe. Ligji njih dy afate: atë katërvjeçar dhe atë dyvjeçar. Në afatin

katërvjeçar, nga mbarimi i funksionit, janë përcaktuar: funksioni i Presidentit të Republikës, Kryeministri, ministrat, deputetët, zëvendësministrat, sekretarët e përgjithshëm, gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe të të gjitha niveleve të gjyqësorit, prokurorët, drejtorët e përgjithshëm të institucioneve qendrore, kurse në afatin dyvjeçar janë kategorizuar të gjitha subjektet që sipas nenit 3 të ligjit mbartin detyrimin për deklarim.

Deklarimi përpara fillimit të punës bëhet në ato raste kur një nëpunës fillon punë për herë të parë në një nga funksionet e parashikuara nga ligji si subjekt për deklarim. Në këtë rast deklarimi mund të kryhet në çdo kohë, pavarësisht afateve kohore të përcaktuara nga ligji për deklarimin.

Por për çfarë do të deklarojë një subjekt në deklaratën e tij? Kuptohet që objekti i deklarimit të pasurisë nuk mund të jetë i pakufishëm. Ligjvënësi ka pasur parasysh kufizimin e objektit të deklarimit në pasuritë dhe kategoritë e saj më të rëndësishme, të cilat janë të verifikueshme. Në nenin 4 të ligjit është përcaktuar se subjektet, të cilat mbartin detyrimin për deklarim, do ta kryejnë atë për këto objekte:

“Subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji detyrohen të deklarojnë në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe në inspektoratet e ulëta, brenda datës 31 mars të çdo viti, gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të pasurive, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare si më poshtë:

- a) pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to;
- b) pasuritë e luajtshme, të regjistrueshme në regjistrat publikë;
- c) sendet me vlerë të veçantë mbi 5 000 dollarë amerikanë;
- ç) vlerën e aksioneve, të letrave me vlerë dhe pjesët e kapitalit në zotërim;
- d) vlerën e likuiditeteve, gjendje në *cash*, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj;
- dh) detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë, të shprehura në lekë ose në valutë të huaj;
- e) të ardhurat personale për vitin, nga paga ose pjesëmarrja në borde, komisione ose çdo veprimtari tjetër që sjell të ardhura personale;

ë) licencat dhe patentat që sjellin të ardhura.

Natyrshëm të lind pyetja nëse fusha dhe objekti që ka përcaktuar ligji është i mjaftueshëm ose ai duhet të ngushtohet ose të zgjerohet? Po ta krahasojmë këtë objekt me atë të ligjit të mëparshëm, vërejmë se objekti i deklarimit është zgjeruar. Por në praktikën e vendeve me demokraci të zhvilluar vërejmë se ka edhe disa elemente të tjera të cilat mund të përfshiheshin në objektin e deklarimit. Kështu p.sh., në ligjin italian për deklarimin përfshihet edhe detyrimi që kanë për deklarim të gjithë kandidatët që kandidojnë për t'u zgjedhur, në lidhje me burimet dhe fondet që ata shpenzojnë për fushtat zgjedhore. Një element të tillë nuk e gjejmë as në Kodin tonë Zgjedhor. Një gjë e tillë do të realizonte një transparencë në procesin e konkurrimit, si dhe implikimin e personave fizikë e juridikë që kanë financuar nga përfitimet që mund të realizojnë në të ardhmen nga zgjedhja e kandidatit në detyrë. Kuptohet që në mënyrë të tërthortë ky ligj duhet të harmonizohet edhe me ligjin për konfliktin e interesave.

Në çdo rast deklarata e pasurisë shoqërohet edhe nga autorizimi që vetë subjekti lëshon në favor të Inspektoratit të Lartë ose të ulët, sipas përkatësisë në të cilin vetë subjekti autorizon institucionet përkatëse për verifikimin pranë të gjitha subjekteve private ose publike brenda dhe jashtë vendit për të dhënat e deklaratës. Ligjvënësi e ka pasur si përparësi të padiskutueshme shoqërimin e deklaratës me këtë autorizim dhe ka vendosur edhe sanksione për mosdhënien e kësaj deklarate, si ndërprerjen e marrdhënieve të punës, sipas legjislacionit në fuqi.

Ky element është një e drejtë e përdorur kryesisht në legjislacionin dhe praktikën e vendeve anglo-saksone, nga të cilat mund të jetë huazuar edhe kjo praktikë. Një autorizim i tillë i jep të drejtë institucioneve përkatëse të mund të ushtrojnë lehtësisht kontroll pranë institucioneve me qëllim verifikimin e deklaratës. Një gjë e tillë krijon lehtësi dhe frytshmëri në procesin e verifikimit, pasi zbatimi i procedurave të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale, pa autorizimin e lëshuar nga vetë subjekti, do të kërkonte një kohë të gjatë për verifikimin e deklaratës dhe do ta vështirësonte procesin.

Të gjitha deklaratat e pasurisë duhet të plotësohen nga subjektet brenda një afati të caktuar. Deklarata e pasurisë duhet të plotësohet brenda tremujorit të parë të çdo viti. Deklarimi i pasurisë bëhet gjithmonë për pasuritë dhe detyrimet financiare të vitit paraardhës. Për respektimin e këtij afati, ligjvënësi ka parashikuar edhe penalitete ose gjoba, të cilat zbatohen nga inspektorati i ulët ose i lartë, sipas përcaktimeve dhe kategorizimeve që ka bërë ligji. Nëse përsëri do t' i referohemi praktikës italiane, vërejmë se ligji ynë është më i ashpër dhe më represiv. Sipas ligjit italian, deklarimi nuk kategorizohet në subjekte, por ai kryhet në mënyrë vullnetare nga çdo qytetar. Kuptohet që ligjvënësi ka kërkuar ta përqendrojë dhe t' i detyrojë të gjithë ato kategori funksionarësh, të cilat, në ushtrimin e funksioneve të tyre, mund të përfitojnë të mira materiale, të deklarojnë pasurinë me detyrim dhe të kontrollohen prej shtetit për pasuritë e tyre. Kjo vjen edhe për atë që thamë më lart, se niveli i korrupsionit në vendet në tranzicion dhe ekonomi joreale mund të krijojë më shumë hapësira për rritjen e nivelit të korrupsionit, çka nuk ndodh në vendet europiano-perëndimore.

Deklarata e pasurisë pas grumbullimit, sipas ligjit, kalon në një proces të përpunimit dhe verifikimit të saj nga Inspektorati i Lartë ose i ulët.

Mendoj se do të ishte më e lehtë ndarja e procesit në tri faza:

- faza e parë është ajo e përpunimit paraprak;
- faza e dytë është kontrolli e verifikimi; dhe
- faza e tretë është hetimi e kërkimi administrativ.

“Inspektorati i Lartë dhe ai i ulët bëjnë përpunimin paraprak të deklarimeve, i cili përfshin juridiksionin, rregullsinë e plotësimin të deklaratës dhe të anekseve, dokumentet justifikuese dhe ligjshmërinë e tyre.

Kur nga përpunimi paraprak vërtetohen gabime materiale ose plotësimet të gabuara, Inspektorati njofton subjektin që ka paraqitur këto deklarime, i cili, brenda 15 ditëve nga marrja e njoftimit, është i detyruar t' i ndreqë ato.”

Një element i rëndësishëm i procesit të verifikimit të saktësisë dhe vërtetësisë së deklaratës është edhe bashkëpunimi me institucionet e tjera

të administratës shtetërore dhe asaj publike. Ligjvënësi ka parashikuar një detyrim në nenin 26 se të gjitha të dhënat “Për kryerjen e kontrollit dhe verifikimin e të dhënave të deklaratës, Inspektorati i Lartë dhe ai i ulët kanë të drejtë të shfrytëzojnë të dhënat e nevojshme në të gjithë aparatin shtetëror e publik dhe në personat juridikë publikë e privatë.” Gjithashtu, ligji ka parashikuar edhe detyrimin për t’iu përgjigjur këtyre inspektorateve brenda 15 ditëve nga paraqitja e kërkesës me shkrim. Një element që bie në sy është se kërkimet për informacion pranë bankave të nivelit të dytë dhe institucioneve të tjera që ushtrojnë veprimtari bankare duhet të bëhen vetëm nga Inspektori i Përgjithshëm. Një element i tillë bën që të garantohet një fshehtësi për subjektet që kontrollohen dhe një përqendrim i informacionit që lidhet me bankat ose institucionet financiare, të cilat për jetën publike dhe private të njeriut janë tepër delikate.

“Kur gjatë kontrollit zbulohet se deklaratimet nuk janë të sakta ose burimet e deklaruara nuk identifikohen dhe nuk mbulojnë pasuritë e deklaruara, Inspektorati i Lartë ose ai i ulët thërret subjektin për të dhënë shpjegime të hollësishme dhe argumentet përkatëse, të cilat paraqiten kurdoherë me shkrim.” Ky është një element tjetër procedural që garanton mbrojtjen e subjektit që i nënshtrohet deklaratimit dhe kontrollit të deklaratës së pasurisë dhe detyrimeve financiare. Në veprimet e tij procedurale Inspektori i Përgjithshëm ose kryetari i inspektoratit të ulët kanë të drejtë të thërrasin ekspertë të pavarur, të licencuar të fushave të ndryshme, për të dhënë mendim ose për të bërë rivlerësim të pasurisë ose për çështje të cilat gjykohen si të nevojshme: “Ekspertët janë të detyruar të ruajnë konfidencialitetin e të dhënave që sigurojnë gjatë ekspertimit dhe mbajnë përgjegjësi, sipas dispozitave të Kodit Penal, për ekspertim të rremë. Shpenzimet e ekspertëve përballohen nga buxheti i Inspektoratit të Lartë ose nga ministria apo institucioni, në varësi të të cilit është inspektorati i ulët që ka kërkuar ekspertimin.”

Siç vërehet, i gjithë procesi i kontrollit dhe i verifikimit të pasurisë dhe i

detyrimeve financiare është i përcaktuar në mënyrë të detajuar në ligj, çka garanton dhe siguron parimet e përgjithshme procedurale, si dhe të drejtat dhe liritë themelore të subjektit që i nënshtrohet deklarimit.

Një element shumë i rëndësishëm që ka të bëjë me transparencën e veprimtarisë së punës dhe të administratës publike është edhe publikimi. Ligji ka përcaktuar se të gjitha të dhënat që vijnë prej deklarimit janë të detyrueshme për deklarim në përputhje me ligjin nr.8503, datë 30.6.1999 “Për të drejtën e informimit”. Mendoj se një transparencë e tillë e të dhënave të deklaratës së pasurisë përbën një ndryshim të mendësisë, të traditës së ruajtjes së të dhënave të tilla, por edhe si një stimul për grumbullimin e informacionit nga publiku i gjerë. Reformimi i jetës shoqërore është i shumanshëm dhe ky publikim është një prej atyre traditave dhe botëkuptimeve që dalëngadalë duhet të ndryshojnë në favor të transparencës kundrejt publikut. Çdo nëpunës i administratës publike, i cili përfiton nga taksat që paguajnë të gjithë shtetasit, ka detyrimin të jetë transparent në drejtim të shtimit të pasurisë që akumulon, si dhe të detyrimeve financiare që krijon.

Por natyrshëm lind pyetja: A është *ky ligj* më i miri?

Siç e thashë edhe në disa paragrafe në lart, në vende të ndryshme vetë ligji ka njohur praktika të ndryshme. Në disa vende ai paraqitet si një deklarim për pasurinë, në disa të tjera në deklarimin e pasurive të vendosura si pasojë e konfliktit të interesit. Nëse për një çast do të mendonim se nëse një subjekt deklaronte se atij i ishte falur një automjet me vlerë të madhe (10 mijë \$ US), atëherë, sipas këtij ligji, ai nuk kishte ndonjë pengesë për dhuratën e marrë. Por nëse ligji do të kishte parashikuar në objektin e tij edhe kategorinë e dhuratave dhe nivelin se deri ku duhej të pranoheshin ose prej kujt mund të pranoheshin këto dhurata, atëherë zbatimi i ligjit do të ishte më i frytshëm dhe rezultatet e tij mund të ishin më të efektshme. Vendi ynë ka kaluar procese tranzicioni dhe dukuri nga më të ndryshmet. Kështu, do të përmendja tregun ireal që ka pas ekzistuar dhe, megjithëse ka një prirje uljeje, vazhdon

të jetë ende i pakontrolluar, blerja e sendeve dhe e pronave të paluajjtshme me *cash* lekë në dorë, përhapja në masë të gjerë e skemave piramidale dhe fshehja e detyrimeve financiare nga shumë subjekte, e bën zbatimin e këtij ligji shumë të vështirë. Në këto kushte, mendoj se kjo nismë e Kuvendit duhet të shoqërohet edhe me ligjin për konfliktin e interesave, si dhe me rishikimin e ligjit për etikën. Në këtë mënyrë përmirësimi i kuadrit ligjor do të sillte edhe një rezultat më të madh në luftën kundër korrupsionit, si dhe në sigurimin e një administrate publike të pastër.

Vështrim mbi standardet etike dhe pushtetin ligjvënës*

Përktheu: Elira ZAKA
Qendra e Studimeve Parlamentare

1.1 Nevoja për një Kod Etik

A. Anëtarët e Parlamentit

Nevoja për një paketë të qëndrueshme rregullash etike në formën e një kodi në shtete të ndryshme perceptohet në mënyra të ndryshme. Disa vende, si p.sh. Anglia, kanë zgjedhur një Akt ku formulohen qartë detyrimet dhe standardet e sjelljes për parlamentarët, të tjerët (p.sh. Franca dhe pjesa më e madhe e vendeve me të cilat Bashkimi Europjan ka një marrëveshje asociimi), vlerësojnë dhe monitorojnë sjelljen e parlamentarëve të tyre kryesisht në bazë të rregullave kushtetuese, legjislacionit të përgjithshëm të punësimit ose dispozitave me natyrë administrative, civile dhe penale.

Vende të tjera mbështesin argumentin se është më mirë të mbajnë sa më të thjeshtë sistemin legjislativ dhe të çliruar nga kodet e reja dhe aktet. Sidoqoftë, vështrimi i kundërt që fton për një identifikim të qartë të atyre që *duhet* dhe *nuk duhet* të jetës publike, të mbledhura së bashku në një paketë të plotë rregullash, me sanksione në raste shkeljesh, duket që po fiton terren, kryesisht, sepse shihet si një mënyrë për rritjen e integritetit të sektorit publik dhe në këtë mënyrë edhe si rritje e besimit të publikut në legjislativ.

* Materiali është marrë nga *Parliamentary codes of conduct in Europe*, botim i European Centre for Parliamentary Research and Documentation.

Në terma të përgjithshme, efekti i kodifikimit ndjehet në katër fusha të ndryshme:

- a. në përfitimin e shoqërisë në përgjithësi, duke forcuar shtetin ligjor
- b. në marrëdhëniet midis parlamentarëve dhe elektoratit të tyre
- c. në marrëdhëniet midis parlamentarëve
- d. shërben si kut për vetë parlamentarët.

a. Forcon rolin e shtetit ligjor

Kodifikimi i parimeve etike në rregulla të forta ligjore lehtëson **të pranuarit e “lojës sipas rregullave”** në respekt të ligjit dhe të mirëqënies së publikut, ndërsa mos-kodifikimi, në mënyrë të rrezikshme, mund të lejojë fushë të lirë për të bërë zgjedhje personale nëse do të respektohet apo jo një rregull dhe për interpretim subjektiv të përmbajtjes së një norme të veçantë.

Një kod i fortë etik, i detyrueshëm me ligj, gjithashtu ofron mënyra vlerësimi, kontrollë dhe sanksione nëpërmjet gjykatave ose mekanizmave të tjerë demokratikë. Nuk duhet t’i lërë vend interpretimeve të rastit apo taktikave të papërshtatshme nën pretekstin se ‘të gjitha mënyrat janë të pranueshme’, me qëllim që të arkivohen përfundimet e dëshiruara politike. Ndërsa argumentet në favor të pragmatizmit politik mund të jenë intelektualisht të qëndrueshme, ato ndonjëherë këqyren si të paprincipia dhe mundet që të çojnë në zhgënjim në lidhje me legjislativin dhe ekzekutivin. Një paketë e përshtatshme rregullash të kodifikuara duhet të ndihmojë për të sjellë në një linjë pragmatizmin politik dhe ekonomik me parimet e përfaqësimit demokratik dhe përgjegjshmërisë publike.

b. Përfitimet e publikut

Rregullat etike të parlamentarëve, para së gjithash, i shërbejnë qytetarit, duke i dhënë atij siguri dhe masën me anën e së cilës të vlerësojnë performancën legjislative.

Në një mjedis të tillë, mbajtësit e posteve politike do ta gjejnë më të lehtë dhe shpërbluese të mbështesin gjithmonë vlerat kryesore të cilat ishin faktorë

të rëndësishëm në fitoren e zgjedhjeve, të tilla si integriteti, shpirti i komunitetit, transparencja, etj. Publiku, në përgjithësi, pret që parlamentarët të bëjnë më të mirën në lidhje me legjislacionin gjatë kohës që janë në këtë detyrë, ndërsa vendosin një shembull qytetarie dhe sjelljeje etike.

c. Kolegjialiteti

Ekzistenca dhe veprimi i një pakete rregullash etike është, gjithashtu, përfituese për marrëdhëniet midis palëve midis parlamentarëve të zgjedhur, pavarësisht nga përkatësia partiake. Pavarësisht nga ndryshimet politike, një sens kolegjaliteti dhe tolerance i pozicioneve të ndryshme politike duhet të zotërojë midis palëve. Standardet etike formojnë dominuesin e përbashkët për të gjithë parlamentarët, cilatdo qofshin përmasat e grupit, platformës së tyre politike ose interesave të tyre legjislativë. Një parlament i balancuar dhe që respekton diversitetin bën që të përfitojë shoqëria të cilën ai reflekton dhe përfaqëson.

d. Zhvillimet personale

Krijimi i paketave të sakta me rregulla etike është gjithashtu shumë ndihmues për vetë parlamentarët, ndërsa ata sigurojnë **një kornizë të qartë veprimi** në të cilën mund të kryejnë detyrat e tyre, **duke forcuar kredibilitetin e tyre politik** dhe në këtë mënyrë edhe shanset e tyre për t'u rizgjedhur.

Sidoqoftë, nga një këndvështrim i pastër racional, rritja e besimit të publikut nuk mund të arrihet vetëm duke pasur një paketë rregullash dhe sanksionesh, ato duhet të aplikohen dhe të respektohen në mënyrë të dukshme. Kredibiliteti nuk arrihet vetëm duke iu bindur rregullave, por edhe duke u parë të pajtohesh me to. Si role model në shoqëri, parlamentarët duhet të sigurohen që jo vetëm rregullat ekzistojnë, por të shihet qartë që i mbështesin ato.

B. Zyrtarët e parlamentit

Marrëdhënia midis zyrtarëve të parlamentit dhe një asambleje përfaqësuese është e veçantë dhe shpesh kërkon standarde të ngjashme të sjelljes publike dhe asaj etike private.

Ashtu si në rastin e parlamentarëve të zgjedhur, kodifikimi ose jokodifikimi i rregullave deontologjike mbetet një pikë divergjence midis sistemeve të ndryshme kombëtare. Ndërsa të gjitha vendet i mbështesin rregullat e aplikueshme tek zyrtarët e parlamentit, këto rregulla janë vendosur në tipe të ndryshme formash ligjore. Një dallim parësor mund të skicohet ndërmjet:

- Rregullave tradicionale administrative (p.sh. rregullave të stafit) për të gjitha kategoritë e punonjësve të shërbimit civil, të mbështetura nga dispozitat e së drejtës civile, administrative dhe penale;
- Kode etike të vetëqëndrueshme për zyrtarët e parlamentit, duke u fokusuar në veçantitë dhe ndjeshmërinë e punës që kryhet nga një grup njerëzish të cilët shpesh konsiderohen si një shtrirje e pushtetit legjislativ.

Ekzistenca e kodeve etike të mirëpërcaktuara dhe diskrete duhet:

- Të forcojë besimin e publikut në **paanësinë, integritetin dhe pavarësinë e stafit**.
- Të sigurohen parlamentarët, që stafi që punon me ta dhe për ta (përfshirë edhe sekretariatet e grupeve politike, asistentët dhe kategoritë e tjera të personelit) përmbushin të njëjtat standarde etike në jetët e tyre profesionale dhe private dhe që si pasojë rrezatojnë një imazh të ngjashëm besimi dhe kredibiliteti.
- Të shërbejnë për vendosjen e praktikave personale dhe në këtë mënyrë të përbëjnë një shembull për pjesën tjetër të shërbimit civil

Ashtu si në rastin e parlamentarëve, një paketë rregullash e vendos theksin nga procedura të brendshme të pastra e të paqarta drejt sistemeve më të thjeshta dhe më transparente me: (i) rregulla të qarta (ii) mënyra ndreqjeje në raste të keqmanaxhimit ose mashtrimit; (iii) sanksione të detyrueshme në

raste shkeljesh; (iv) organizma rregullatore.

1.2 Vlerat e mbrojtura dhe parimet etike

Në vende të veçanta duket se disa parime janë universale, si liria e fjalës dhe shprehja politike, transparenca në të gjitha aktivitetet, mospërputhja me disa pozicione në publik dhe sektorin privat, veprimi i përbashkët kundër korrupsionit, etj.

Përsa i përket zyrtarëve të parlamentit, ka, gjithashtu, ngjashmëri në lidhje me çështje të tilla, si: pavarësia, mos-diskriminimi, paanësia, ndalimi për pranimin e përfitimeve të paligjshme financiare, etj.

Në anën tjetër, ka disa ndryshime midis shteteve, si p.sh., në lidhje me përmbajtjen e standardeve etike dhe interpretimit të tyre.

Një shembull i mirë i nuancave të interpretimeve është çështja e **transparencës**. Ndërkohë që është pranuar në mënyrë unanime si një parim thelbësor i parlamentarizmit demokratik dhe çelësi për një qeveri të përgjegjshme dhe moderne, ka mospërputhje në përcaktimin e tipit të informacionit që duhet të jepet, zbulohet, kujt dhe nën ç' kushte.

Në mënyrë të drejtpërdrejtë i lidhur me parimin e transparencës është edhe koncepti i konfliktit të interesit, përcaktimi i të cilit ndryshon nga një vend në tjetrin. Ndërsa në disa vende konflikti i interesit i referohet ekskluzivisht interesave financiare që mundet të prekin në mënyrë të pafavorshme performancën e detyrave të një parlamentar, tek të tjerë konceptit i është dhënë një interpretim më i gjerë dhe parlamentarët duhet të deklarojnë se nuk kanë interesa të tjera personale, gjithashtu.

Informacioni i dhënë këtu nxjerr në pah parimet kryesore të përgjithshme, ndërsa identifikon në çdo rast pikat e ndryshimit që ngrihen nga situata të ndryshimeve kombëtare.

A. Parlamentarët

i. Pazgjedhshmëria dhe papajtueshmëria

Edhe përpara se të bëheshin parlamentarë, kandidatët duhej të

përmbushnin një sërë standardesh profesionale dhe sjelljeje. Mospërputhja me këto standarde mund të rrezikojë shanset e tyre elektorale, deri në atë pikë sa mund t'i bëjë ata të papërshtatshëm për t'u zgjedhur.

Ndryshimet në statusin profesional dhe financiar të një parlamentarit mund të ndodhin pas zgjedhjes së tij si anëtar i parlamentit. Ato madje mundet që ta bëjnë të papërshtatshëm për të ushtruar funksionin e përfaqësuesit. Në raste të tilla, situata duhet të zgjidhet duke përmbushur kërkesat e detyrës ose duke dhënë dorëheqjen.

Nga reagimet e parlamenteve kombëtare, duket se kriteret e pazgjedhshmërisë dhe papajtueshmërisë janë shumë të ngjashme në shumicën e vendeve.

Pazgjedhshmëria – është përcaktuar si një situatë që mund të pengojë një person që të hedhë kandidaturën për t'u zgjedhur dhe nga mundësia për t'u zgjedhur (p.sh. duke mbajtur një post dhe që mund të kufizonte qartazi pavarësinë e deputetit, etj., ndëshkime prej një dënimi penal, etj.)

Kur e hasim pazgjedhshmërinë në terrenin e vendimeve penale, pezullimi është një rregull i përgjithshëm në të gjitha shtetet. Ndryshime të lehta vihen re në lidhje me tipin e dënimit që çon në të qenit i pazgjedhshëm (p.sh. vjedhje bankash), kohën e gjykimit (p.sh., gjatë hetimit, sapo gjykatësi të jetë prononcuar) dhe tipin e gjykimit.

Papajtueshmëritë – janë situata që nuk përputhen me detyrat në funksion. Një nga *papajtueshmëritë* më të zakonshme ngrihet nga të mbajturit njëkohësisht të funksioneve, si në jetën private ose në punësimin privat, për shkak të shqetësimit për të ruajtur pavarësinë e parlamentarit nga ekzekutivi ose interesat private.

Përsa i përket funksioneve jo-zgjedhëse, ka vende të cilat, p.sh., nuk e lejojnë një parlamentar që të mbajë njëherësh edhe një post qeveritar apo të jetë gjyqtar. Veç kësaj, *papajtueshmëria* shpesh vjen nga anëtarësia e dyfishtë:

- në dy dhoma të senatit (në një sistem parlamentar me dy dhoma)

- në pozicionet e zgjedhura në nivel federal dhe rajonal (në shtetin federal)
- nga një mandat i dyfishtë në nivele kombëtare dhe Europiane.

Situata është edhe më komplekse dhe e ndryshme kur ndeshim kombinimin e pozicionit të parlamentarit të zgjedhur me interesa ekonomike. Interesat ekonomike dhe financiare të parlamentarit duhet të jenë subjekt i shqyrtimit të kujdesshëm me qëllim që të shmangen situata që mund të pengojnë pavarësinë dhe paanësinë e tij.

Sidoqoftë, për sa kohë demokracitë e reja në Europën Qendrore dhe Lindore janë të interesuara, ka nga ata që deklarojnë se rregullat në mbajtjen e njëkohëshme të posteve zyrtare duhet të aplikohen në mënyrë fleksibël kur është fjala për veprimtari tregtare. Ata mendojnë se është jorealiste të kërkosh nga një parlamentar në këto vende të mos përfshihet në aktivitete përfituese, për shkak se këto aktivitete të dyshimta ekonomike janë në pah në këto vende.¹ Ky opinion do ta bënte të pranueshme, si pasojë, mbajtjen e njëkohshme të posteve publike dhe private.

Në pjesën më të madhe të vendeve, rastet e *pazgjedhshmërisë* dhe *papajtueshmërisë* janë përcaktuar si në kushtetutat kombëtare ose edhe në ligjet elektorale dhe lidhen me entitete të ndryshme, si psh, parlamentet kombëtare që veprojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë (Belgjika dhe Gjermania), gjykatat e veçanta (p.sh., Greqia, Anglia) ose organizma të tjera (si p.sh., Franca- Këshilli i Shtetit)

ii. Imunitetet

Në të gjitha vendet e mbuluara nga ky studim, anëtarët e parlamenteve

¹ Parlamenti European – Rezoluta në luftën kundër korrupsionit në Europë – 1996. ‘Ndërsa mund të bëjë sens në një vend në zhvillim të parandalojë një zyrtar publik nga angazhimi në aktivitet në sektorin privat, në disa vende në zhvillim kjo është tërësisht jorealiste. Aktiviteti i sektorit privat në disa lloje mund të jetë i nevojshëm kur paga në sektorin publik është tepër e ulët’

kombëtare gëzojnë imunitet, i cili i jep atyre një status të shquar brenda sistemit ligjor gjyqësor, me qëllim që të sigurojë pavarësi dhe liri fjale të nevojshme për të përmbushur mandatin e tyre politik dhe ligjor. Dy dimensionet kryesore të imunitetit që u akordohet parlamentarëve janë, së pari, liria e fjalës dhe shprehjes e lidhur me detyrën e tyre politike, dhe, së dyti, përjashtimi nga hetimet dhe akuzat e zakonshme ose edhe nga çështje penale a civile, që nuk lidhen me mandatin e tyre.

Liria e fjalës për parlamentarët është një parim suprem në të gjitha vendet demokratike. Ajo mund të garantohet si një liri thelbësore në kushtetutë (si në pjesën më të madhe të vendeve europiane) ose në instrumente të tjera ligjore (p.sh. Rusia- Ligji Federal mbi Statusin e Zëvendësit të Këshillit të Federatës dhe Statusi i Zëvendësit të Shtetit të Dumës në Asamblenë Federale të Federatës Ruse).

iii. Detyrimet pozitive dhe negative

Mbas zgjedhjeve, deputeti duhet të pranojë paketën e detyrimeve profesionale dhe etike, të cilat mund të klasifikohen si pozitive dhe negative.

Detyrimet negative i referohen detyrimit të deputetit të abstenojë nga kryerja e një veprimi që mund të ketë rezultat negativ, të tilla që nuk mund të veprojnë në kundërshtim me ligjin, nuk veprojnë në mënyrë diskriminuese apo të njëanshme, jo për të përfituar dhe përdorur informacion në mënyrë mashtruese, etj., jo për të kërkuar ose pranuar përfitime financiare (rryshfete, dhurata etj.).

Detyrimet positive, në anën tjetër, krijojnë një pritshmëri për veprim në anën e deputetit të zgjedhur. Këtu mund të përmendim: detyrën për të vepruar në mënyrë të arsyeshme dhe të drejtë, për të ndërmarrë hapa që do të bënin të mundur që informacioni i siguruar dhe mbi të cilin vendimet merren është korrekt, të inkurajohet komuniteti nga udhëheqja dhe modeli, t' i jepet prioritet mirëqënies së përbashkët përpara konsideratave personale apo të palëve, të përdoren në mënyrë të përshtatshme dhe të arsyeshme burimet e caktuara

për të kryer detyrat e kërkuara, etj.

iv. Parimet udhëheqëse

Disa nga parimet kryesore të sjelljes etike parlamentare që janë të përbashkëta për shumicën e vendeve përshkruhen më poshtë. Detajet për çdo vend janë vendosur në tabelat në pjesën nr.2 të këtij studimi.

Ndërvarësia e tyre dhe universaliteti mund të shpjegohen me faktin që ata janë të pandarë në punën e deputetit për shkak se drejtojnë marrëdhënien me elektoratin ose janë të lidhur së brendshmi me deputetin si një model për shoqërinë.

1. Pavarësia

Dinjiteti mbi të gjitha çënimet që implikon funksionin e deputetit, dhe kapaciteti për të folur në emër të publikut në lidhje me bjektiva të rëndësishëm ligjorë dhe politikë kërkon një shkallë të lartë pavarësie nga të gjitha presionet administrative dhe ekonomike. Përtej detyrimit moral të mbrojtjes në mënyrë të pavarur të interesit të përgjithshëm, deputetët gjithashtu kanë detyrë të respektojnë dhe përdorin në mënyrë të përshtatshme ‘privilegjet’ që ligji u jep atyre.

Eshtë konsideruar gjithashtu vitale nga shumica e vendeve që deputetët nuk duhet të hyjnë në marrëveshje kontraktore ose veprime të tjera kufizuese që mund të kontrollojnë apo të kufizojnë pavarësinë dhe lirinë e veprimit dhe të fjalës, dhe do t'i detyronte ata të veprojnë si përfaqësues të atij interesi dhe jo të elektoratit dhe mirëqënies së përbashkët.

2. Jo - diskriminimi

Parimi i jo-diskriminimit nuk duhet të ngatërrohet me paanësinë. Ndërsa është në natyrën e punës së deputetit të mbrojë një pozicion të pjesshëm (p.sh. linjën partiake, një interes të pozicionit të grupit, një ideologji), parimi i jo-diskriminimit i referohet shpirtit të tolerancës, hapjes dhe transparencës për t'u aplikuar nga politikanët kundrejt të gjitha pozicioneve ideologjike dhe

politike. Aplikimi i dyshes ‘paanshmëri-njëanëshmëri’ në punën e deputetit është plotësisht i pranueshëm. Sidoqoftë, në frymën e transparencës së plotë, ai/ajo pritet të njohë këtë pozicion hapur, së bashku me hapat që të çojnë në të, si p.sh., kontakte të rregullta me një degë të veçantë të industrisë.

Me fjalë të tjera, njëanshmëria nuk përbën një faj si e tillë, por vetëm në rastin e një aplikimi të mbrapshtë ose jo-transparent (p.sh. lënia jashtë me qëllim e informacionit, duke marrë informacion përmes metodave jo të ndershme ose duke marrë përfitime personale nga mbrojtja e një këndvështrimi të caktuar etj.).

Përveç kësaj njëanshmërie ideologjike të pranueshme, jo-diskriminimi që duhet të drejtojë të gjitha veprimet e deputetit, rrjedh parimi i përgjithshëm i të drejtave të njeriut i trajtimit të barabartë dhe një trajtim i paparagjykuar ndaj të gjithë njerëzve me gjithë ndryshueshmërinë e tyre fizike, ideologjike dhe të sjelljes.

Neni 21 i Kartës Themelore të të Drejtave të Njeriut të Bashkimit Europian e shpreh kështu këtë: ‘Diskriminimi i bazuar në seks, racë, ngjyrë etni apo origjinë sociale, të dhëna gjenetike, gjuhë, besim fetar apo bindje politike etj., anëtarësi në minoritete, pronë, lindje, paaftësi, moshë apo orientim seksual duhet të ndalohej.’

Transparenca

Transparenca në punën e publikut është një çështje e rëndësishme dhe në rritje që shfaqet rregullisht axhendave të parlamenteve kombëtare dhe ndërkombëtare, ombudsmanëve dhe forumeve të shoqërisë civile. Transparenca shpesh konsiderohet si një ‘ilaç për të gjitha të këqijat’ si dhe mjeti më i lirë dhe më i lehtë për të luftuar keqadministrimin, mashtrimin, korrupsionin dhe ‘daljen e informacionit’.

Në sajë të atyre teoricienëve që kane deklaruar se po të jetë ‘shumë e hapur’, një administratë do t’i mungonte efijenca, është provuar gjerësisht se, në të kundërt, një administratë më e hapur jo vetëm që do të rriste efijencën

e administratës, si rezultat i **rritjes së përgjegjshmërisë kundrejt publikut**, por edhe do të promovonte cilësi në debatin **profesional**, koherencë të qëndrimit politik, dhe në gjetjen e dokumentacionit. Për më tej, duke u ndjerë pjesë e proceseve legjislativë dhe qeverisëse, mbështetjes qytetare dhe respekti i administratës kombëtare (dhe atë europiane) plotësisht.

Çështja e transparencës është bërë më e rreptë vitet e fundit, ndërsa raste serioze të keqmenaxhimit dhe korrupsionit janë shfaqur në mënyrë publike. Për më tej, konsolidimi dhe aktivizmi i organizatave joqeveritare dhe grupeve të interesit kundër ‘politikave të largimit’ ka rritur nevojën për hapjen e një sferë politike dhe axhendën e parlamentit për këqyrjen e kontributin publik.

Duket nga informacioni i siguruar nga vende të ndryshme që masat që janë të përbashkëta për promovimin e transparencës në jetën e publikut përfshijnë:

- detyrën e deputetit për të shfaqur transparencë kundrejt publikut (elektoratit, grupeve të lobimit) duke lehtësuar aksesin në informacion në sensin më të gjerë (deklarata shpjeguese, dokumentacion i detajuar, etj.) dhe përmes pastësisë në lidhje interesa personale financiare dhe jo-financiare;
- detyrën e parlamentarit për të shfaqur transparencë kundrejt institucionit (p.sh., nëpërmjet deklarimit të interesave financiare dhe jofinanciare) kundrejt partisë së tyre.

3. Rregullat kundër korrupsionit

Skandalet e fundit të korrupsionit kanë nxjerrë në pah të meta në funksionimin e institucioneve publike dhe dobësinë në sistemin monitorues. Si rezultat, vendet kanë vendosur luftën kundër korrupsionit në të gjithë sektorët e jetës publike (shih më poshtë) në krye të axhendës së tyre politike.

Korrupsioni (në ekzekutiv, legjislativ, gjyqësor dhe mjediset e biznesit) është e vështirë të kapet në mënyrë efektive, për shkak të **shumëllojshmërisë** dhe **gjithanshmërisë** të lehtësuar nga përdorimi i

teknologjisë moderne. Për më tej, zgjerimi i ndërvlerësive ndërmjet biznesit dhe qarqeve politike dhe legjislativë (p.sh., procedurat e shpërblimeve për kontrata publike) është një shkak për shqetësim për parlamentet dhe qeveritë.

I synuar kryesisht në ekzekutiv, masat për të luftuar korrupsionin aplikohen tani gradualisht në sektorin e legjislativ, si për deputetët, ashtu edhe për zyrtarët e parlamentit. Për shkak të praktikës së keqe që ekziston gjithashtu në lidhje me financimin e partive politike, fushatave elektorale dhe interesave personale të parlamentarëve, parlamentet po rimendojnë sistemet e tyre të vlerës dhe makinerinë për vetë-rregullimin dhe po bëjnë dispozita për të monitoruar në mënyrë më strikte (p.sh. përmes njësive të specializuara antikorrupsion).

a. Përcaktimi dhe format e korrupsionit

Kundravajtjet më të zakonshme në ligjin kombëtar dhe atë ndërkombëtar përfshijnë rryshfetin, të kërkuarit e rryshfetit, frikësimi i zyrtarëve me qëllim që ata të veprojnë kundër rregullave të etikës, favoret, pagesa e deputetëve të vecantë për të ngritur çështje të vecanta në parlament, abuzimi me pushtetin dhe dhënia e kontratave publike ndërsa dështojnë të përmbushin me rregullat mbi prokurimin publik. Financimi i partive politike mund të jetë objekt i praktikës korruptive, si evazioni i taksave në lidhje me shpenzimet profesionale (p.sh., Belgjika).

Deputetët kanë detyrime positive dhe negative që i aftësojnë ata të eliminojnë burimet e mundshme të korrupsionit:

Detyrimet positive:

- Detyrime për të shmangur konfliktin e interesit
- Detyrimi për të abstenuar nga ndonjë transaksion i papërshtatshëm që mund të jetë jo kompatibël me detyrat e deputetit;
- Detyrimi për të deklaruar ndonjë interes financiar ose jofinanciar përpara se të marrë detyrën dhe në cdo kohë kur kjo do të kërkohet;

- Promovimi i rregullave transparente në lidhje me financimin e partive politike dhe fushatat elektorale;
- Shpallja e rregullave të qarta dhe transparente mbi lobimin.

Detyrimet negative:

- Dekret kundër pranimit të dhuratave ose favoreve të tjera, si nga ana e një personi, ose një grupi politik;
- Dekret për zbulimin e informacionit konfidencial ose informacion që ndahet me deputetët brenda kontekstit të detyrimeve të tij;
- Kufizimi mbi mbajtjen njëkohësisht të pozicioneve zyrtare dhe në sektorin privat që mund të cojnë në konflikt të interesave.

b. Masat që parandalojnë korrupsionin midis deputetëve:

Parlamentet luajnë rol kryesor në hartimin e masave që, në njërën anë, promovojnë sjellje etike dhe të përgjegjshme ndërmjet deputetëve, dhe në anën tjetër, penalizojnë deputetët që janë të fajshëm për praktika të tilla. Është një rregull i përgjithshëm që parlamentet në këtë çështje nevojitet të bashkëpunojnë ngushtë me ekzekutivin dhe gjyqësorin. Shembuj për masa të tilla janë:

- Masat parandaluese, p.sh., forcimi i transparencës në lidhje me interesat financiare dhe jofinanciare të deputetëve, promovimi i praktikave të mira, rritja e transparencës në aktivitetet lobuese, duke hartuar dhe zbatuar kodet e etikës aty ku nuk ekzistojnë ose përmirësimin e atyre ekzistuese (shih më poshtë), etj.
- Masat reaguese, p.sh., rritja e shqyrtimit të kujdesshëm nga policia dhe gjyqësori, duke krijuar një kornizë ligjore të përshtatshme (përfshirë ratifikimin e traktateve ndërkombëtare dhe konventave) duke zhvilluar instrumente parlamentare të specializuara antikorrupsion (borde disiplinore, monitorime të kujdesshme, ombudsmani, etj.) sanksione më të rrepta për të gjitha format e mashtrimit dhe të korrupsionit.

c. Sanksionet

Me gjithë parimet kryesore dhe masat e adoptuara në vende të ndryshme janë të ngjashme, ndryshimet janë të dukshme në lidhje me përcaktimin dhe klasifikimin e praktikave korruptive dhe autorëve të tij.

Në lidhje me sanksionet, mund të jetë praktikë të aplikohen sanksione të barabarta mbi ata të cilët ofrojnë rryshfete dhe ata që i marrin ato ose në mënyrë alternative të bëjnë një dallim midis korrupsionit ‘aktiv’ dhe ‘pasiv’ (p.sh., Austria dhe Gjermania).

Për më tej, në disa vende dënimet aplikohen vetëm për rryshfetet në sektorin publik dhe jo në sektorin privat. Gjithashtu, ndryshimet që ekzistojnë ndërmjet sanksioneve të detyruara mbi deputetët e zgjedhur dhe ato që janë të detyrueshme për zyrtarët. Ato shkojnë nga gjobat deri tek dënimi me burg, dhe përfshijnë papërshtatshmërinë e atyre që dënohen për korrupsion, heqja e kontratave shpërblyese, etj.

4. Konflikti i interesit & deklarimi i interesave financiare

Duke filluar me parimin që deputeti duhet të jetë shembull i integritetit në komunitet, është e rëndësishme që deputeti të evitohet ndonjë situatë konflikti midis sjelljes së publikut dhe interesave të tyre private. Sigurisht, konflikte të tilla nuk janë gjithmonë të evitueshme dhe mund të ndjehet nevoja për të pyetur sa kontradiktore duhet të jenë interesat kur ngrihen.

Ka dy shkolla mendimi në këtë çështje.

Pozicioni më strikt është kur deputeti përballon një konflikt midis detyrës së tij publike dhe interesave të tij private, në këtë rast ai duhet të tërhiqet, ose të zgjidhë konfliktin në favor të pritshmërisë së publikut.

Një pozicion më i butë është të pranosh që pozicioni midis interesit privat dhe interesit publik jo në mënyrë të domosdoshme çon në konflikt, nëse trajtohet në një mënyrë transparente dhe të përgjegjshme. Deputetët duhet të jenë të hapur në lidhje me interesat e tyre private dhe duhet të jenë të aftë në çdo moment të justifikojnë veprimet që marrin/ndërmarrin.

Çdo anëtar duhet të jetë i përgatitur të deklarojë në mënyrë të hapur interesat personale (financiare dhe jofinanciare) edhe nëse është një dyshim i dobët rreth situatës. Kështu parimi mund të pranohet në përgjithësi, aplikimi i tij në vendet anëtare është miks.

Ndryshimet kryesore kombëtare:

- *Detyrimi për të deklaruar interesat financiare dhe jofinanciare te deputetit.* Kjo është e detyrueshme në disa nga vendet anëtare (Angli, Francë) dhe jo e detyrueshme në të tjera (p.sh. Danimarkë, Hollandë, Finlandë, Belgjikë, etj.) ose është jo ekzistente (Luksemburg).

- *Tipet e interesit që duhen deklaruar.* Detyrimi për të deklaruar të gjitha të ardhurat shtesë dhe aktivitetet, si dhe pronat ose kuotat në kompanitë, aplikohet në disa vende (p.sh., Angli) ndërsa të tjerë nuk kërkojnë informacion mbi pronën, apo informacion në lidhje me punësimin specifik (p.sh) pozicione drejtuese, pozicione administrative, kontrata me kompani komerciale, etj.). Për shkak të mospërputhjes me detyrën e deputetit dhe disa pozicioneve të tjera profesionale apo të zgjedhura, në Francë, deputetit i kërkohet të dorëzojë një deklaratë të aktivitetit Brenda dy muajsh të zgjedhjeve.

- *Persona interesat e të cilëve duhet të deklarohen.* Në disa vende anëtare, prona që i përket familjes së deputetit (bashkëshortit dhe fëmijëve) duhet gjithashtu të deklarohet (p.sh., në Greqi) ndërsa në disa vende të tjera ka një detyrim të gjerë për të deklaruar përfitime të tjera dhe dhuratat e dhëna familjes së deputetit.

- *Format e deklarimit.* Kjo mund të ndryshojë nga struktura më formale (p.sh., llogaritë dhe raportet) në deklarime më të thjeshta të avantazheve financiare ose lidhjeve jofinanciare (p.sh. përfshirja e interesave personale paraprakisht të paqëllimshme në një çështje të veçantë në Bundestag).

- *Koha e deklarimit.* (p.sh. në fillim ose në fund të periudhës së mbajtjes së detyrës ose në çdo kohë që bëhet një ndryshim i rëndësishëm në situatën e një deputeti). Në Angli një deklaram oral i një interesi të veçantë duhet të bëhet me rastin e çdo debate parlamentar.

▪ *Regjistrimi.* Zakonisht deklaratat e deputetëve hyjnë në një regjistër të mbajtur nga një komision parlamentar (Angli) ose një strukturë e jashtme (Belgjikë).

▪ *Akresi në informacionin e regjistruar,* është një prej çështjeve më të diskutueshme. Disa vende favorizojnë akses të shtrënguar në regjistrin që përmban të dhëna personale mbi deputetin me synimin për të ruajtur një shkallë të caktuar të fshehtësisë. (p.sh, Franca, Spanja) Te tjerë besojnë se interesi i publikut nuk mund dhe nuk duhet të behet sekondar për interesa private (Angli, Itali, Hollandë) ndërsa një kategori e tretë zgjedh një zgjidhje mikes (p.sh., Gjermania).

▪ *Sanksionet.* Përsëri sanksionet ndryshojnë midis 15 shteteve anëtare, me sisteme që nuk sigurojnë sanksione specifike në rastin e moszbulimit të interesave personale të një deputeti (p.sh. Spanja) sisteme që formulojnë sanksione morale dhe politike (p.sh., Gjermania dhe Italia) dhe sisteme që aplikojnë sanksione ligjore më të rrepta, duke përfshirë pazgjedhshmërinë për një periudhë të caktuar (p.sh., Franca, Portugalia).

Qëllimi i kësaj transparence nuk është që të imponojë masa shtrënguese dhe vëzhgim jo të barabartë, por të përmirësojë standardet morale në jetën publike. Vendet që nuk kanë sisteme të rregulluara të shpalljes së interesave financiare po punojnë së fundmi në prezantimin e sistemeve të tilla, ndërsa vendet të cilat i kanë këto sisteme, po përpiqen t'i përmirësojnë ato.

i. Parime të tjera

Në vazhdim të parimeve që mund të gjenden në rregullat procedurale ose kodet etike të praktikisht të gjitha vendeve të analizuara, ka gjithashtu parime të tjera dhe vlera që përbëjnë kushe paraprake për anëtaësi në parlament.

Disa nga ato janë të përbashkëta për disa vende (p.sh. integriteti, ndershmëria, respecti për shtetin ligjor dhe administratën publike, etj.), ndërsa të tjerët janë specifike për vende të veçanta (p.sh., -Anglia).

B. Zyrtarët e parlamentit në parlamentet kombëtare

Parimet udhëheqëse

1. Pavarësia

Pavarësia është një vlerë e përsëritur e përbashkët në rregulloren që drejtojnë zyrtarët parlamentarë në shumicën e vendeve të Bashkimit Europian dhe jo. Nuk është e njëjtë me konceptin e ‘pavarësisë’ të aplikuar në rastin e deputetëve ose edhe të gjyqtarëve, por më tepër i referohen kryesisht një afrimi më të paanshëm kundrejt parlamentarit dhe publikut.

Në disa vende, neutraliteti politik është një kriter për rekrutimin e zyrtarëve të parlamentit, si një garanci e kesaj pavarësie dhe e angazhimit të zyrtarëve për t’i shërbyer interesit të publikut.

2. Jo-diskriminimi

Ndryshe nga afrimi sa më fleksibël i marrë nga njëanshmëria e deputetëve, zyrtarët e parlamentit nuk lejohen të demonstrojnë të njëjtën njëanshëmi partiake të papërmbajtshme. Ata janë caktuar të ushtrojnë një funksion ekzekutiv, duke asistuar punën e të gjithë deputetëve të zgjedhur dhe kështu që nuk mund të marrin anën e askujt. Prej tyre pritet që të performojnë dhe të trajtojnë të gjitha kërkesat në mënyrë të barabartë.

I vetmi përjashtim lidhet me sekretariatet e partive politike, ku besnikëria/luajalitetit kundrejt grupin që punëson stafin jo vetëm që është e pranueshme por e pritshme.

3. Praktikanti anti-korrupsion

Si në rastin e deputetëve, zyrtarët e parlamenteve kombëtare shpesh akuzohen për praktika korruptive dhe ka pasur skandale me implikime serioze të imazhit public të institucioneve.

Sidoqoftë menaxhimi i shërbimit civil po bëhet gjithmonë e më i ndërgjegjshëm për domosdoshmërinë për të vepruar kundër këtij fenomeni

duke adoptuar një paketë vlerash bërthamë (kodi etik) për zyrtarët e parlamentit. Integriteti dhe dominimi I interesit public duhet të jenë cilësitë në bazën e sistemit etik dhe meritave të deputetëve.

Iniciativat e reja

Parlamentet në shumicën e vendeve nën diskutim po vendosin plane të ngjashme veprimi për të forcuar manaxhimin etik në departamentet e tyre. Në rastin e demokracive të reja në Europën Qendrore dhe Lindore. Parlamentet po përballohen me detyra të dyfishta. Në njërin anë ata duhet të ngrihen mbi një periudhë të shkurtër kohore një trupë parimesh të sjelljes së mirë, ndërsa në anën tjetër ata duhet të vrapojnë me ritmin e zhvillimeve në një nivel më të gjerë European përderisa korrupsioni nuk respekton kufijtë kombëtarë.

Si në rastin e deputetëve, parlamentet ndërthurin masat parandaluese dhe reaguese në një strategji koherente për promovimin e cilësisë dhe etikës midis zyrtarëve të tyre.

Iniciativat më të zakonshme përfshijnë:

- Përpjekjet për të forcuar vlerat e shërbimit midis zyrtarëve, duke balancuar një afrim transparent dhe fleksibël të orientuar drejt interesave të të zgjedhurit me vlerat tradicionale të besnikërisë dhe konfidencialitetit.
- Përshtatja e kodeve etike ose nxjerrja e formulimeve të qarta të vlerave dhe përcaktimeve të kufijve të sjelljes së pranueshme në punë, për përdorim nga zyrtarët e parlamentit.
- Një rishikim i menaxhimit të burimeve njerëzore me qëllim integrimin e mëtejshëm të parimeve etike në menaxhimin e përditshëm.
- Zhvillimi në vend i procedurave për zyrtarët për raportimin e gabimeve në siguri të plotë,
- Vlerësimi i rrezikut të korrupsionit dhe kontrolli, zhvillimi i monitorimit të etikave në mënyrë më efektive.

- Inkurajimi i praktikës më të mirë, trajnimi i zyrtarëve në rregulla të reja të menaxhimit dhe deontologjisë.
- Rritja e transparencës së përgjithshme.
- Si në rastet kryesore të korrupsionit rritet nga ndërveprimi midis zyrtarëve dhe sektorit privat, udhëzime të pastra për këtë tip marrëdhënies duhet gjithashtu të formulohet qartë.

1.3 Mekanizmat rregullatore & sanksionet

A. Deputetët

Ndryshimet midis sistemeve kombëtare janë më evidentet lidhur me infrastrukturën e besuara me supervizionin e standardeve etike parlamentare dhe sanksionet në rastin e thyerjes së tyre. Modelet kombëtare ndryshojnë në përputhje me eksperiencat lokale dhe traditat, por gjithashtu me nivelin e korrupsionit në jetën publike.

Vëzhgimi i kujdesshëm mund të ushtrohet në mënyra të ndryshme:

- Vetërregullimi dhe kontrolli edhe përmes grupeve politike ose, në nivel të asamblesë parlamentare, përmes komisioneve deontologjike-Gjermania, Greqia, Anglia.
- Stuktura autonome të tilla si ombudsmani (vendet skandinave),
- Strukturat kriminale investigative për rastet serioze të mashtrimit, korrupsionit dhe rryshfetit (p.sh., gjykatat, policia, njësitë e hetimeve speciale për krimin etj.).

B. Zyrtarët e parlamentit

Zyrtarëve të parlamentit u kërkohet të vëzhgojnë rregullat e brendshme mbi etikën të formuluar nga parlamentet kombëtare. Supervizimi I mbikëqyrjes së stafit i rregullave të qëndrueshme mbi etikën dhe sjelljen bëhet në shumicën e rasteve përmes:

- Hierarkia parlamentare administrative (p.sh. Presidenti/Sekretari I Përgjithshëm-Austria, Gjermania, Komisionet e Kontrollit të Etikës – Belgjikë, Danimarkë, Portugali, Spanjë)
- Një strukturë autonome (p.sh. ombudsmani –Danimarkë, Hollandë, komisionet – Irlandë)
- Autoritetet kompetente hetuese dhe gjyqësore, vecanërisht për rastet e përfshirjes në korrupsion dhe mashtrimeve serioze (Gjermani, Greqi, Hollandë)

Në disa vende këto forma bashkëekzistojnë, me një dallim midis punës së një strukture rregullatore dhe makinerisë për supervizim dhe sanksione. Në vijim, zgjedhja e strukturës së përshtatshme mund të varet nga çështja që ngrihet (p.sh., korrupsioni, masat disiplinore, rregullat procedurale, etj.).

Udhëzimet e OECD-së për menaxhimin e konflikteve të interesit në shërbimin publik

PARATHËNIE

Një shqetësim në rritje i publikut

Shërbimi ndaj interesave të publikut është misioni themelor i qeverive dhe institucioneve publike. Qytetarët presin nga zyrtarët publikë që t' i kryejnë detyrat e tyre me integritet, në mënyrë të paanshme dhe të drejtë. Pritet që qeveritë të bëjnë të mundur që zyrtarët publikë të mos lejojnë që interesat dhe përkatësitë e tyre private të komprometojnë vendimmarrjen zyrtare dhe menaxhimin publik. Në një shoqëri me kërkesa në rritje, kur konfliktet e interesit nuk menaxhohen siç duhet nga ana e zyrtarëve publikë, ato ka mundësi të dobësojnë besimin e qytetarëve tek institucionet publike.

Konfliktet e interesit, si në sektorët publikë dhe në ata privatë, janë bërë një çështje madhore e shqetësimit publik në gjithë botën. Në qeveri dhe në sektorin publik, konflikti i interesit ka qenë për një kohë të gjatë fokusi i një politike specifike; legjislacioni dhe trajtimet e menaxhimit kishin si synim të ruanin integritetin dhe marrjen e vendimeve në mënyrë objektive në qeveri dhe në institucionet publike. Në sektorin publik, gjithashtu, ka pasur një histori të gjatë të shqetësimit për integritetin në biznes dhe, në veçanti, për mbrojtjen e interesave të aksionistëve dhe të publikut në përgjithësi. Skandalet e fundit kanë tërhequr vëmendjen për rëndësinë e shmangies së konflikteve të interesit që mund të bëhen një çështje kur, për shembull, një zyrtar publik largohet nga detyra publike për t' u punësuar në sektorin e biznesit ose në OJQ, ose kur një firmë kontabiliste i ofron të njëjtit klient si shërbimin e auditimit dhe

atë të këshillimit, ose një agjenci rregulluese lidhet shumë me entitetet e biznesit që presupozohet të mbikëqyrë.

Midis sektorit publik e sektorëve të biznesit dhe të atij jofitimprurës janë zhvilluar forma të reja të marrëdhënieve, duke çuar, për shembull, në forma të ngushta bashkëpunimi në rritje, të tilla si partneriteti privat/publik, vetërregullimi, ndërshkëmbimi i personelit dhe i sponsorizuesve. Kanë dalë forma të reja punësimi në sektorin publik, me mundësi për ndryshim të detyrimeve tradicionale të punësimit. Për pasojë, po shfaqet në mënyrë të qartë një potencial për forma të reja të konfliktit të interesit që përfshijnë interesat private të një zyrtari të veçantë dhe detyrat publike, dhe një shqetësimi publik në rritje, i cili, ky i fundit ka ushtruar presion mbi qeveritë, për të siguruar që të mos komprometohet integriteti i vendimmarrjes zyrtare.

Ndërsa konflikti i interesit nuk është *ipso facto* korrupsion, ka një njohje në rritje që konfliktet midis interesave private dhe detyrave publike të zyrtarëve publikë, në qoftë se nuk menaxhohen siç duhet, mund të çojnë në korrupsion. Objektivi i duhur i një politike efektive të konfliktit të interesit nuk është ndalimi i thjeshtë i të gjitha interesave të mundshme private nga ana e zyrtarëve publikë, edhe sikur ky trajtim të ishte i perceptueshëm. Objektivi i menjëhershëm do të ishte të ruhej integriteti i politikës zyrtare dhe i vendimeve administrative dhe menaxhimi publik në përgjithësi, duke njohur që një konflikt i pazgjidhur interesi mund të çojë në abuzim me detyrën publike.

Ky objektiv, në përgjithësi, mund të arrihet duke garantuar që organet publike të posedojnë dhe të implementojnë standardet e duhura të politikës për promovimin e integritetit, të proceseve efektive për identifikimin e riskut dhe duke u marrë me konfliktet e interesit që shfaqen, me mekanizmat e brendshme e të jashtme të përgjegjshmërisë dhe me trajtimet e menaxhimit - përfshi sanksionet - që synojnë të garantojnë që zyrtarët publikë të marrin përgjegjësi vetjake për t'iu përmbajtur si kuptimit, ashtu edhe frymës së këtyre standardeve.

Trajtimet e ndryshme të menaxhimit të konfliktit të interesit, që janë bërë

nga vendet anëtare, tradicionalisht, kanë pasqyruar traditat e tyre të ndryshme historike, ligjore dhe të shërbimit publik. Masat institucionale, si auditimi dhe verifikimi i jashtëm pozitiv ose trajtime të tjera të brendshme mbikëqyrëse, kanë domosdo vendin e tyre në menaxhimin e situatave të konfliktit. Masat e tjera, si publikimi i kufizuar ose i plotë i interesave të zbuluara dhe/ose zhvillimi i një kulture menaxhimi që mbështet integritetin, gjithashtu, mund të jenë efektive.

MENAXHIMI I KONFLIKTEVE TË INTERESIT

Në një mjedis të sektorit publik që ndryshon me shpejtësi, konfliktet e interesit do të jenë gjithnjë një çështje shqetësimi. Një trajtim tepër strikt në kontrollin e ushtrimit të interesave privatë mund të çojë në konflikt me të drejta të tjera ose mund të mos funksionojë, ose mund të jetë joproduktiv në praktikë, ose mund të pengojë ata që kërkojnë detyra publike. Prandaj një politikë moderne e konfliktit të interesit duhet të kërkojë të vendosë një drejtpeshim, duke identifikuar rreziqet për integritetin e organizatave publike dhe zyrtarët publikë, duke ndaluar format e papranueshme të konfliktit, duke menaxhuar situatat e konfliktit siç duhet, duke bërë organizatat publike dhe zyrtarët e veçantë të ndërgjegjshëm për ndodhjen e konflikteve të tillë, duke siguruar që të ndiqen procedura efektive për identifikimin e bërjen të njohur të menaxhimin dhe promovimin e zgjidhjeve të duhura për situatat e konfliktit të interesit.

Qëllimi i udhëzimeve

Qëllimi kryesor i udhëzimeve është të ndihmojë vendet anëtare, në nivelin qendror të qeverisjes, që të marrin parasysh politikën dhe praktikën ekzistuese të konfliktit të interesit që lidhet me zyrtarët publikë - përfshi zyrtarët publikë/civilë, të punësuarit, dhe mbajtësit e detyrave publike - që punojnë në administratën kombëtare publike. Udhëzimet, gjithashtu, mund të japin drejtim edhe për degët e tjera të qeverisë, për nivelin e pushtetit vendor dhe korporatat shtetërore.

Në veçanti, udhëzimet paqyrojnë politikat dhe praktikat që janë provuar se janë efektive në vendet e OECD-së dhe synojnë që:

- të ndihmojnë institucionet dhe agjencitë qeveritare, që të zhvillojnë një politikë efektive për konfliktin e interesit, që ushqen besimin në integritetin e tyre dhe integritetin e zyrtarëve publikë dhe vendimmarrjen publike;
- të krijojnë një kuadër praktik referimi për rishikimin e zgjidhjeve ekzistuese dhe modernizimin e mekanizmave në përputhje me praktikat e mira në vendet e OECD-së;
- të promovojnë një kulturë të shërbimit publik, ku konfliktet e interesit të identifikohen siç duhet dhe të zgjidhen ose menaxhohen në një mënyrë transparente siç duhet dhe në kohën e duhur, pa penguar në mënyrë të papërshtatshme efektivitetin dhe efikasitetin e organizatave publike të interesuara;
- të mbështetin partneritetin midis sektorit publik dhe sektorëve të biznesit dhe ata jofitimprurës, në përputhje me standardet e qarta publike që përkufizojnë përgjegjësitë e palëve për integritet.

Përkufizimi i një “konflikti interesi”

Përkufizimi i termit “konflikt i interesit” ka pasur historikisht shumë trajtime. Meqë të gjithë zyrtarët publikë kanë interesa legjitime që lindin nga të qenit e tyre qytetarë të thjeshtë, konfliktet e interesit nuk mundet, thjesht, të shmangen ose të ndalohen, ato duhet të përkufizohen, identifikohen dhe menaxhohen. Këto udhëzime adoptojnë një qasje përkufizimi që është qëllimisht e thjeshtë dhe praktike për të ndihmuar në identifikimin dhe menaxhimin efektiv të situatave të konfliktit, si më poshtë:

Një “konflikt interesi” përfshin një konflikt midis detyrës publike dhe interesave private të një zyrtari publik, në të cilën zyrtari publik ka interesa të natyrës private që mund të ndikonin në mënyrë të gabuar në kryerjen e detyrave dhe të përgjegjësisve të tyre zyrtare.

I përkufizuar në këtë mënyrë, “konflikti i interesit” ka kuptimin e “konfliktit faktik të interesit”. Një situatë me konflikt interesi mund të jetë e tanishme ose mund të vërehet se ka ekzistuar në një kohë të caktuar në të kaluarën.

Në të kundërt, mund të thuhet se ekziston një konflikt interesi *i dukshëm* kur interesat private të një zyrtari të veçantë mund të ndikojnë në mënyrë të gabuar në kryerjen e detyrave të tyre, *por në fakt nuk është kështu*. Një konflikt *i mundshëm* lind atje ku zyrtari publik ka interesa private, të cilët janë të tillë që mund të lindte një konflikt interesi, në qoftë se zyrtari do të përfshihej në përgjegjësi zyrtare përkatëse (konfliktuale) në të ardhmen.

Atje ku një interes privat ka komprometuar *në fakt* kryerjen siç duhet të detyrave publike, ajo situatë specifike më mirë shikohet si një rast sjelljeje të keqe ose “abuzim me detyrën”, ose madje rast korrupsioni, më tepër sesa një “konflikt interesi”.

Në këtë përkufizim, “interesat private” nuk kufizohen në interesat financiare a monetare, ose ato interesa që gjenerojnë një përfitim të drejtpërdrejtë vetjak për zyrtarin publik. Një konflikt interesi mund të përfshijë ndryshe veprimtarinë e ligjshme me cilësi private, përkatësitë dhe shoqatat vetjake dhe interesat e familjes, nëse ato interesa në mënyrë të arsyeshme mund të konsideroheshin se mund të ndikojnë në mënyrë të gabuar në kryerjen e detyrave nga ana e zyrtarëve. Një rast të veçantë përbën çështja e punësimit të zyrtarit publik pas detyrës zyrtare: negociatat e punësimit të ardhshëm të një zyrtari publik, para se të largohet nga detyra zyrtare, shikohet gjerësisht si një situatë me konflikt interesi.

Konfliktet e interesit, përkufizuar në këtë mënyrë, janë në fokus të këtyre udhëzimeve sepse, në se nuk menaxhohen ose zgjidhen siç duhet, ato ka mundësi të minojnë funksionimin e duhur të qeverive demokratike, duke:

- dobësuar përkushtimin e zyrtarëve publikë ndaj idealeve të legjitimitetit, të paanshmërisë dhe të drejtësisë në marrjen e vendimeve; dhe
- duke shtrembëruar zbatimin e ligjit, zhvillimin dhe zbatimin e politikës, funksionimin e tregjeve dhe shpërndarjen e burimeve publike.

Parime thelbësore të menaxhimit të konflikteve të interesit

Në interes të ruajtjes së besimit të publikut në institucionet publike, udhëzimet pasqyrojnë faktin se mund të pritët që zyrtarët publikë të kenë

parasysh në veçanti parimet e mëposhtme thelbësore në trajtimin e konflikteve të interesit për promovimin e integritetit në kryerjen e detyrave dhe të përgjegjësive zyrtare:

Shërbimi ndaj interesit publik

▪ Zyrtarët publikë duhet të marrin vendime dhe të japin këshilla mbi bazën e ligjit dhe politikës përkatëse, pa parë përfitimin vetjak (d.m.th. të jenë “objektivë”). Integriteti i vendimmarrjes zyrtare, në veçanti në zbatimin e politikës për raste të veçanta, nuk duhet të paragjykohet nga parapëlqimet ose përkatësitë fetare, profesionale, partiake, politike, etnike, familjare ose të tjera parapëlqime, ose angazhime vetjake të vendimmarrësit.

▪ Zyrtarët publikë duhet të heqin dorë nga interesat vetjakë ose t’i kufizojnë operacionet e interesit privat që mund të komprometonin vendimet zyrtare në të cilat ata marrin pjesë. Atje ku kjo nuk është e mundshme, zyrtari publik duhet të mos përfshihet në vendime zyrtare që mund të komprometoheshin nga interesat dhe përkatësitë e tyre private.

▪ Zyrtarët publikë duhet të shmangin veprimet në cilësinë private, nga të cilat mund të rrjedhin avantazhe të gabuara nga “informacione anësore” të fituara gjatë detyrave zyrtare, ku informacioni nuk është në përgjithësi i disponueshëm për publikun dhe atyre u kërkohet të mos keqpërdorin pozitën e tyre dhe burimet e qeverisë për përfitime vetjake.

▪ Zyrtarët publikë nuk duhet të kërkojnë ose të pranojnë çfarëdo forme të padrejtë përfitimi me qëllim që të ndikojnë në kryerjen ose moskryerjen e detyrave dhe të funksioneve zyrtare.

▪ Nga zyrtarët publikë pritet të mos përfitojnë në mënyrë të padrejtë nga një detyrë ose post zyrtar që ata e kanë pasur më parë, përfshi dhe informacione të marra në atë post, veçanërisht kur kërkon punësim ose emërim pas largimit nga detyra zyrtare.

Mbështetja e transparencës dhe e inspektimit

▪ Nga zyrtarët publikë dhe organizatat publike pritet të veprojnë në një mënyrë që të sigurojë inspektimin më të afërt të publikut. Ky detyrim nuk

kryhet plotësisht thjesht duke vepruar brenda kuptimit të ligjit; ajo nënkupton, gjithashtu, respektimin e vlerave të shërbimit publik më të gjerë, të tilla si objektiviteti, paanshmëria dhe integriteti.

- Interesat privatë të zyrtarëve publikë dhe përkatësitë që mund të komprometonin kryerjen objektive të detyrave publike duhen zbuluar siç duhet, në mënyrë që të mundësohet kontrolli dhe menaxhimi i saktë i një vendimi.

- Organizatat dhe zyrtarët publikë duhet të sigurojnë konsequencë dhe shkallë të përshtatshme hapjeje në procesin e zgjidhjes ose menaxhimit të një situatë me konflikt interesi.

- Zyrtarët dhe organizatat publikë duhet të promovojnë inspektimin e konflikteve të interesit nga ana e tyre, brenda kuadrit ligjor të zbatueshëm.

Promovimi i përgjegjësisë individuale dhe i shembullit vetjak

- Nga zyrtarët publikë pritet të veprojnë gjatë gjithë kohës, në mënyrë që integriteti i tyre të shërbejë si një shembull për zyrtarët publikë dhe publikun.

- Zyrtarët publikë duhet të pranojnë përgjegjësi për rregullimin e çështjeve të tyre private, aq sa është e mundur në mënyrë të arsyeshme, në mënyrë që të parandalohen konfliktet e interesit që lindin më emërimin në postin zyrtar dhe më pas.

- Zyrtarët publikë duhet të pranojnë përgjegjësi për identifikimin dhe zgjidhjen e konflikteve në favor të interesit të publikut kur lind një konflikt.

- Nga zyrtarët publikë dhe organizatat publike pritet të demonstrojnë angazhimin e tyre për integritetin dhe profesionalizmin nëpërmjet zbatimit efektiv të politikës dhe praktikës së konfliktit të interesit.

Lindja e një kulture që është jotolerante ndaj konflikteve të interesit

- Organizatat publike duhet të sigurojnë dhe të implementojnë politika, procese dhe praktika menaxhimi në mjedisin e punës për të nxitur kontrollin dhe menaxhimin efektiv të situatave të konfliktit të interesit.

- Praktikrat organizative duhet t'i nxisin zyrtarët publikë, që të zbulojnë dhe të diskutojnë çështjet e konflikteve të interesit dhe të sigurojnë masa të arsyeshme për të mbrojtur publikimet nga keqpërdorimi i të tjerëve.

- Organizatat publike duhet të krijojnë dhe të ruajnë një kulturë komunikimi dhe dialogu të hapur në lidhje me integritetin dhe promovimin e tij.
- Organizatat publike duhet të sigurojnë udhëzime dhe trajnim për promovimin e kuptimit dhe të evolucionit dinamik të rregullave dhe praktikave të vendosura dhe zbatimin e tyre në mjedisin e punës.

KRIJIMI I KUADRIT TË POLITIKËS

Përkufizimi i një qasjeje të politikës për të trajtuar konfliktet e interesit është një pjesë e qenësishme e kontekstit politik, administrative dhe kulturor të një administrate publike të një vendi. Këto udhëzime nuk përpiqen të mbulojnë çdo situatë të mundshme ku lind një konflikt interesi, por më tepër ato janë projektuar si një referencë politike dhe praktike që është me vend në një kontekst social që ndryshon me shpejtësi. Masat e propozuara synojnë të përforcojnë njëra-tjetrën, të sigurojnë një qasje koherente dhe konsekuente të menaxhimit të konflikteve të interesit. Funkcionet kyçe të kësaj qasjeje janë:

- *Përkufizimi* i tipareve të përgjithshme të situatave të konfliktit të interesit që kanë mundësinë të rrezikojnë integritetin organizativ dhe individual.
- *Udhëheqja* dhe *angazhimi* për implementimin e politikës së konfliktit të interesit.
- *Ndërgjegjësimi* që ndihmon përputhjen me rregullat dhe *parashikimi* i zonave në rrezik që duhen parandaluar.
- *Njoftimi i saktë* i informacionit adekuat dhe *menaxhimi efektiv* i konflikteve.
- *Partneriteti* me financuesit e tjerë, përfshi klientët, sponsorët dhe bashkësinë.
- *Gjykimi dhe vlerësimi* i një politike të konfliktit të interesit në dritën e përvojës.
- *Rizhvillimi* dhe *axhustimi* i politikës dhe i procedurave të nevojshme për t'iu përshtatur situatave në evoluim.

1.1. Identifikoni situatat përkatëse të konfliktit të interesit

1.1.1. Bëni një përshkrim të qartë dhe realist për rrethanat dhe marrëdhëniet që mund të çojnë në situatë të konfliktit të interesit.

- Përshkrimi i përgjithshëm i situatave me konflikt interesi duhet të jenë në përputhje me idenë themelore që ka situata, në të cilat interesat dhe përkatësitë private të një zyrtari publik krijojnë ose kanë mundësinë të krijojnë konflikt me kryerjen siç duhet të detyrave zyrtare nga ana e saj/tij. Përshkrimi duhet të theksojë qëllimin e përgjithshëm të politikës, duke nxitur besimin publik në institucionet qeverisëse.

- Përshkrimi, gjithashtu, duhet të njohë që, ndërsa disa konflikte interesi mund të jenë të pashmangshme në praktikë, organizatat publike kanë përgjegjësinë për të përkufizuar ato situata dhe veprimtari të veçanta që përputhen me rolin ose funksionin publik, sepse besimi publik në integritetin, paanshmërinë dhe objektivitetin vetjak të zyrtarëve publikë, që kryejnë funksione publike, mund të dëmtohen në qoftë se konflikti mbetet i pazgjidhur.

- Politika duhet të japë një gamë shembujsh të interesave private që mund të përbënin situata të konfliktit të interesit: interesa financiare dhe ekonomike, borxhe dhe asete, angazhim në organizata fitimprurëse dhe jofitimprurëse, sindikata ose organizata profesionale dhe interesa të tjerë të natyrës vetjake, sipërmarrje dhe marrëdhënie (të tilla si detyrimet për grupet profesionale, të bashkësisë etnike, familjare ose fetare në një cilësi vetjake a profesionale), ose marrëdhëniet me njerëzit që jetojnë në të njëjtën shtëpi.

- Shembuj të tjerë të sjelljes dhe të marrëdhënieve të papranueshme duhet të jepen për ato grupe që punojnë në zonat me rrezik, të tilla si ndërthurja e sektorëve publikë-privatë, prokurimet qeveritare, funksionet rregulluese e inspektuese dhe kontraktimi qeveritar. Vëmendje e veçantë duhet të ketë për funksionet që i nënshtrohen shqyrtimit publik ose vëmendjes së medias.

1.1.2. Sigurohuni që politika e konfliktit të interesit të mbështetet nga strategjitë dhe praktikat organizative, për të ndihmuar në identifikimin e llojeve të ndryshme të situatave të konfliktit të interesit.

- Ligjet dhe kodet, si burime parësore, duhet të parashtrijnë përkufizimet, parimet dhe kërkesat qenësore të politikës së konfliktit të interesit.

- Veç kësaj, udhëzimet dhe materialet trajnuese, si dhe këshillat dhe konsulencat duhet të sigurojnë shembuj praktikë të hapave konkretë që duhet të merren për zgjidhjen e konflikteve të interesit, veçanërisht në zona që ndryshojnë me shpejtësi ose “gri”, të tilla si sponsorizimet e sektorit privat, privatizimi dhe programet e revokimit, marrëdhëniet me OJQ-të, veprimtaria politike, partneriteti publik-privat dhe shkëmbimi i personelit midis sektorëve privatë.

1.2. Krijoni procedura për identifikimin, menaxhimin dhe zgjidhjen e situatave të konfliktit të interesit.

1.2.1. Sigurohuni që zyrtarët publikë të dinë se çfarë kërkohet prej tyre për identifikimin dhe deklarimin e situatës së konfliktit të interesit.

- *Njoftimi fillestar* – me emërimin ose marrjen e një posti të ri – zhvillonin procedura që mundësojnë identifikimin dhe bërjen të njohur të interesave privatë që mund të bien ndesh me detyrat zyrtare të zyrtarëve publikë, kur marrin një post. Ky njoftim zakonisht është formal (me anë të regjistrimit të informacionit që identifikon interesin) dhe kërkohet të jepet periodikisht (në përgjithësi me fillimin e detyrës dhe më pas me intervale të rregullta, zakonisht një herë në vit) dhe me shkrim. Njoftimi nuk kërkohet që me domosdo të jetë një proces publik: njoftimi i brendshëm ose me akses të kufizuar brenda organizatës publike, së bashku me zgjidhjen ose menaxhimin e duhur të çfarëdo konflikti, mund të jetë i mjaftueshëm për të arritur objektivin politik të procesit, duke nxitur besim publik në integritetin e zyrtarëve publikë dhe të organizatës së tyre. Në përgjithësi, sa më i lartë zyrtari publik, aq më shumë ka gjasë që njoftimi publik të bëhet i saktë; sa më i ri, aq më shumë ka gjasë që të jetë i mjaftueshëm njoftimi i brendshëm te drejtuesit e organizatës së zyrtarit.

- *Njoftimi gjatë punës në zyrë* - Ndërgjegjësoni zyrtarët që ata të bëjnë të ditur menjëherë gjithë informacionin për konfliktin, kur ndryshojnë

rrethanat pas bërjes së njoftimit fillestar ose kur lindin situata që çojnë në lindjen e një konflikti interesi. Në lidhje me vetë regjistrimin, ad hoc nuk kërkohet domosdo të jetë një proces publik: një deklarami i brendshëm mund të mjaftojë për nxitjen e besimit të publikut që integriteti po menaxhohet siç duhet.

- *Plotësimi i njoftimit* – Përcaktoni nëse njoftimi për interesat ka detaje të mjaftueshme për interesin konfliktual, që të bëjë të mundur që marrja e vendimit për zgjidhjen e duhur të bazohet në informacione të sakta. Përgjegjësia për saktësinë e njoftimit i mbetet zyrtarit të veçantë publik.

- *Procesi i njoftimit efektiv* – Sigurohuni që procesi administrativ i organizatës të ndihmojë në njoftimin e plotë dhe që informacioni i njoftuar të vlerësohet siç duhet dhe të jetë i përditshëm. Është gjë e saktë që përgjegjësia për dhënien e njoftimit të duhur për informacionin përkatës ta mbajnë zyrtarët e veçantë. Sigurohuni që mos ndjekja e kërkesave për dhënien e informacionit të saktë, të identifikohet dhe të adresohet përfundimisht, duke vendosur sanksione të sakta.

1.2.2. Vendosni rregulla të qarta për ato që priten nga zyrtarët publikë, kur trajtojnë konfliktet e interesit.

Trajtimi i interesave privatë konfliktues – Zyrtarëve publikë duhet t'u kërkohet që të pranojnë përgjegjësinë për identifikimin e interesave privatë. Një deklaratë politike e organizatës duhet të qartësojë që regjistrimi ose deklarimi i interesit privat në vetvete nuk e zgjidh një konflikt. Duhet konsideruar masat shtesë për zgjidhjen ose menaxhimin e konfliktit pozitivisht.

- *Opsionet për zgjidhje dhe menaxhim* - Opsionet për zgjidhje dhe menaxhim pozitiv të një konflikti të vazhdueshëm ose përshkues mund të përfshijnë një ose më tepër nga disa strategji të përshtatshme, për shembull:

- Zhveshja ose likuidimi i interesit nga ana e zyrtarit publik.
- Mosnjohja e zyrtarit publik për të marrë pjesë në procesin e vendimmarrjes së ndikuar.
- Kufizimi i aksesit ndaj informacioneve të veçanta për zyrtarët e ndikuar.

- Transferimi i zyrtarit publik në një detyrë që nuk ka funksion konfliktues.
- Rregullimi dhe njëherë i detyrave dhe përgjegjësive të zyrtarit publik.
- Caktimi i interesit të konfliktit në një rregullim “besimi të verbër”.
- Dorëheqja e zyrtarit publik nga funksioni konfliktues në kapacitetin privat, dhe/ose

- Dorëheqja e zyrtarit publik nga detyra e tij publike.

- *Mosnjohja dhe kufizimi* – Atje ku një konflikt i veçantë nuk ka gjasë të ndodhë shpesh, mund të ishte e përshtatshme për një zyrtar publik që është i interesuar të mbajë pozicionin aktual, por të mos marrë pjesë në vendimmarrje në çështjet që ndikohen, për shembull duke e marrë vendimin që mund të ndikohet nga një palë e tretë e pavarur, ose duke abstenuar nga votimi për vendimet, ose duke u tërhequr nga diskutimi për propozimet dhe planet e ndikuara, ose duke mos marrë dokumentet përkatëse dhe informacionet që lidhen me interesin e tyre privat. Duhet të jetë në dispozicion dhe opsioni për ricaktimin e funksioneve të caktuara për zyrtarin publik në fjalë, atje ku një konflikt i veçantë konsiderohet se ka gjase të vazhdojë, duke e bërë të papërshtatshme mosnjohjen ad hoc. Duhet ushtruar kujdes i veçantë, që të siguroheni se të gjitha palët në vendim i njohin masat e marra për të mbrojtur integritetin e procesit të vendimmarrjes ku adoptohet mosnjohja.

- *Dorëheqja* – Zyrtarëve publikë duhet t’u kërkohet të largojnë interesin e tyre privat konfliktues, në qoftë se dëshirojnë të mbajnë postin e tyre dhe konflikti i interesit nuk mund të zgjidhet në ndonjë mënyrë tjetër (për shembull me anë të një ose më shumë nga masat e sugjeruara më lart). Atje ku konflikti serioz dhe depërtues nuk mund të zgjidhet në ndonjë mënyrë tjetër, zyrtarit publik duhet t’i kërkohet të japë dorëheqjen nga posti zyrtar. Politika e konfliktit të interesit (bashkë me ligjet përkatëse të punësimit dhe/ose dispozitat e kontratës së punësimit) duhet t’i sigurojë mundësinë që posti i tyre zyrtar të ndërpritët në përputhje me procedurat e përcaktuara.

- Transparenca e vendimmarrjes – Regjistrimet dhe deklarimet e

interesave private, si dhe rregullimet për zgjidhjen e konflikteve, duhet të regjistrohen qartë në dokumentet formale, për të mundësuar që organizata e interesuar të demonstrojë, në qoftë se është e nevojshme, që një konflikt specifik është identifikuar dhe menaxhuar siç duhet. Njoftime të mëtejshme për konfliktin e interesit, gjithashtu, mund të jenë me vend në mbështetjen e një politike të përgjthshme objektive, për shembull duke demonstruar se njoftimi i një konflikti specifik interesi është regjistruar dhe është konsideruar në procesverbalin e mbledhjes përkatëse.

IMPLEMENTIMI I KUADRIT TË POLITIKËS

Ndërsa është kryesisht përgjegjësia e zyrtarëve të veçantë publikë që të ndërjegjësohen për konfliktet e mundshme të interesit, organet publike dhe organizatat qeveritare kanë përgjegjësinë për të siguruar që politika e konfliktit të interesit të implementohet efektivisht. Vëmendje e veçantë duhet t'u kushtohet zonave dhe funksioneve, veçanërisht atje ku konfliktet e rëndësishme të interesit kanë më shumë gjasë të lindin ose provohen që janë më të dëmshme për integritetin e organizatës dhe besimin e publikut. Duke bërë kështu, duhet njohur mundësia për procedura më komplekse se ç' duhet për dekurajimin e përputhjes me rregullat.

2.1. Demonstroni angazhim udhëheqjeje

2.1.1. Udhëheqja – Të gjithë zyrtarët publikë, veçanërisht zyrtarët dhe drejtuesit më të vjetër, duhet të rregullojnë interesat e tyre të kapacitetit privat, në një mënyrë që ruan besim publik në integritetin e tyre dhe të organizatës dhe krijon një shembull për të tjerët. Thjesht përmbajtja e zyrtarëve publikë ndaj qëllimit të politikës së konfliktit të interesit ose ligjit, të interpretuara ngushtësisht, nuk mjafton për nxitjen e besimit publik në integritetin e një organizate.

2.1.2. Angazhimi - Organizatat duhet të marrin përgjegjësi për zbatimin efektiv të politikës së tyre të interesit, duke:

▪ *Vendosja në raste të veçanta* – Drejtuesit duhet të përgatiten për të ushtruar gjykimin në zbulimin e interesave private. Në veçanti, ata duhet të marrin në konsideratë me kujdes çështjen më të madhe, nëse një njeri i arsyeshëm që posedon faktet përkatëse do të mund të mendojë që integriteti i organizatës ka qenë në rrezik nga moszgjidhja e konflikteve të interesit. Kur vendoset zgjidhja më e përshtatshme për zgjidhjen ose menaxhimin e situatës aktuale të konfliktit, drejtuesit duhet të peshojnë interesat e organizatës, interesin e publikut dhe interesat legjitime të punonjësve, si dhe faktorë të tjerë, duke përfshirë, në raste të veçanta, nivelin e tipin e postit që mbahet nga zyrtari publik në fjalë dhe natyrën e konfliktit.

▪ *Monitorimi dhe vlerësimi i efektivitetit të politikës* – Me kalimin e kohës, organizatat duhet të sigurojnë që politika të mbetet efektive dhe me vend në trajtimin e konflikteve korrente dhe ato të parashikuara në një mjedis që evoluon gjithnjë dhe të ndryshojë ose të rizhvillojë politikën siç është e domosdoshme.

2.2. Krijoni partneritetet me punonjësit: ndërgjegjësim, parashikim dhe parandalim

2.2.1. Siguroni publikim të gjerë dhe kuptimin e politikës së konfliktit të interesit.

▪ *Publikojeni politikën e konfliktit të interesit* – Jepuni gjithë zyrtarëve të rinj, sapo të emërohen në fillim dhe të marrin një pozicion ose funksion të ri, një deklaratë të qartë dhe konçize për politikën e konfliktit të interesit.

▪ *Kujtojini rregullisht* – Kujtojini në mënyrë të rregullt zyrtarët publikë për zbatimin e politikës në rrethanat ndryshuese dhe, në veçanti, siguroni që zyrtarët publikë të dinë se zbatohen rregulla në organizatë dhe cilat janë përgjegjësitë e tyre. Për shembull, mund të përgatitet një kod i sjelljes si një instrument praktik për vendosjen dhe komunikimin e politikës së interesit si të zyrtarët publikë, edhe te publiku i gjerë.

▪ *Sigurohuni që të ketë rregulla dhe procedura* – Siguroni informacion

të përditësuar për politikën e organizatës, për rregullat dhe procedurat përkatëse të konfliktit të interesit dhe krijoni kërkesa shtesë specifike për organizatën.

- *Sigurori udhëzime* – Mbështetni zyrtarët publikë me informacion dhe këshillime, përfshi shembuj nga bota reale dhe diskutime rreth asaj se si janë trajtuar situatat e konfliktit në të kaluarën dhe si pritet të trajtohen në të ardhmen. Në veçanti, këshillohuni me stafin tuaj për zbatimin e politikës dhe sigurohuni që të kuptohet dhe të zbatohet baza ku mbështetet politika.

- *Garantoni asistencë* – Identifikoni burimet e asistencës së përshtatshme për zyrtarët publikë që ngurrojnë për zbatimin e politikës dhe publikojnë gjerësisht se si duhet marrë një këshillim i tillë. I bëni këto këshilla të disponueshme për klientët e organizatës dhe të tjerët, përfshi kontraktuesit, agjentët dhe organet partnere, për të asistuar financuesit, që të jenë të mirinformuar. Këshilla të tilla mund të jenë veçanërisht të vlefshme për palët që mund të ndjejnë se politika e organizatës publike për konfliktin e interesit nuk është plotësisht efektive, por ngurrojnë të ankohen formalisht tek organizata në fjalë.

2.2.2. Rishikoni zonat “në rrezik” për konflikte të mundshme interesi.

- *Punësime shtesë* – Përkufizoni rrethanat, përfshi procedurat e autorizimit, të cilave mund t’u nënshtrohen zyrtarët publikë në punësime ndihmëse (“jashte”), ndërkohë që e ruajnë postin e tyre zyrtar.

- *“Informacioni i brendshëm”* – Sigurohuni që informacioni i mbledhur ose që mbahet nga organizatat që nuk është për publikun ose informacioni i marrë në konfidencë gjatë funksioneve zyrtare, të kuptohet që është një privilegj dhe të mbrohet në mënyrë efektive nga përdorimi i papërshtatshëm ose publikimi.

- *Kontratat* – Merrini në konsideratë rrethanat në të cilat përgatitja, negociatat, menaxhimi ose zbatimi i një kontrate që përfshin organizatën publike mund të komprometohet nga një konflikt interesi nga ana e një zyrtari publik brenda organizatës.

▪ *Dhuratat dhe format e tjera të përfitimit* – Merreni në konsideratë nëse politika korrente e organizatës është e përshtatshme për njohjen e konflikteve që lindin nga format tradicionale të dhuratave ose të përfitimeve.

▪ *Kërkesat e familjes dhe të bashkësisë* – Merreni në konsideratë nëse politika korrente e organizatës është e përshtatshme për njohjen e konflikteve që lindin nga kërkesat e familjes dhe të bashkësisë për zyrtarët publikë, veçanërisht në një kontekst shumëkulturor.

▪ *Emërimet e “jashtme”* – Përcaktoni rrethanat, përfshi dhe procedurat e autorizimit, sipas së cilave zyrtarët publikë mund të ndërmarrin një emërim në këshill ose në organin kontrollues, për shembull, të një NGO-je, një organizate profesionale a politike, një entiteti tjetër qeveritar, një korporate të njohur pronë e qeverisë ose një organizate komerciale që është e përfshirë në një partneritet ose në një rregullim sponsorizimi me organizatën punësuese.

▪ *Veprimtaria pas largimit nga posti zyrtar* – Përcaktoni rrethanat, përfshi procedurat, sipas së cilave një zyrtar publik, që është gati të largohet nga posti publik, mund të negociojë për një punësim ose emërim, ose veprimtari, ku ka mundësi për një konflikt të interesit që përfshin organizatën.

2.2.3 Identifikoni masat parandaluese që trajtojnë situatat e lindura nga konflikti.

▪ *Procedurat e mbledhjes* – U mundësoni pjesëmarrësve në vendimmarrjen zyrtare që të parashikojnë konflikte të mundshme, atje ku ka: për shembull, duke dhënë axhendat e mbledhjeve paraprakisht; regjistroni në mbledhje çdo konflikt që lind dhe masat që merren për zgjidhjen e tyre.

▪ *Mosnjohja* – Krijoni rregulla të qartë dhe procedura eficiente (për shembull, një regjistër për interesat e anëtarëve të bordit, këshilltarët dhe drejtuesit madhor), që të siguroni që konfliktet e interesit ad hoc të bëhen transparente në një mënyrë të tillë që të mos komprometohet vendimmarrja.

▪ *Proceset e kontrollit* – Si pjesë e proceseve të seleksionimit, kërkonit paraprakisht identifikim për interesat përkatëse dhe diskutoni strategjitë e

mundshme për zgjidhjen e konflikteve të identifikuara; merrni vërtetimet e duhura të kontrollit (si për shembull, merrni vërtetim nga tatimet) dhe deklarata për sipërmarrjet, në mënyrë që të identifikohen dhe të trajtohen konfliktet e mundshme të interesit në një etapë të hershme.

- *Vlerësimi periodik i sistemit* – Rishikoni implementimin e politikës dhe të procedurave mbi një bazë të rregullt dhe përditësoni mekanizmat dhe procedurat, për të siguruar përshtatshmërinë e tyre në një situatë që evoluon vazhdimisht. Merrni në konsideratë përshtatshmërinë e supozimeve korrente – për shembull në lidhje me impaktin e një teknologjie të re që bën të mundur “tregtinë e përditshme” të aksioneve nëpërmjet Internetit, që mund të bëjë të domosdoshme njoftimet e përditshme të ndryshimit të interesave monetare të individit. Bëni vëzhgime të përvojave të rrezikut të organeve të klientit dhe të partnerit, ku është e përshtatshme, pjesërisht për të përfshirë një përvojë më të gjerë dhe pjesërisht për të treguar angazhimin e vazhdueshëm në procesin e menaxhimit të riskut dhe për të ruajtur integritetin e organizatës.

2.2.4. Zhvilloni një kulturë organizative, ku të ngrihen e të diskutohen lirshëm çështjet me koflikt interesi kur trajtohen ato

- *Përfshini punonjësit, përfaqësuesit e tyre dhe palë të tjera të interesuara* në rishikimin e politikës aktuale të konfliktit të interesit. Opinioni i tyre, si përdorues, në problemet ditore që ndeshen në implementimin e politikës së konfliktit të interesit mund të kontribuojnë qenësisht në përmirësimin e masave ekzistuese.

- *Këshillohuni* për masat parandaluese të së ardhmes, për të sjellë një aspekt praktik në procesin e bërjes së politikës dhe të ndërtohet një mirëkuptim i përbashkët që është jetik për implementimin e politikës për të cilën është rënë dakord.

- *Asistoni kuptimin* duke bërë trajnime për zyrtarët publikë, që të kuptojnë parimet e përgjithshme përkatëse dhe rregullat specifike dhe t’i ndihmoni ata që të përmirësojnë shprehitë e vendimmarrjes për zbatimin praktik.

- *Sgurooni mekanizma mbështetës* për të asistuar drejtuesit në rishikimin

dhe përmirësimin e shprehive të tyre në identifikimin dhe zgjidhjen ose menaxhimin e konfliktit në punën e tyre të përditshme.

2.3. Zbatoni politikën e konfliktit të interesit

2.3.1. Siguroni procedura për krijimin e një shkeljeje të konfliktit të interesit, dhe pasojat proporcionale për mospërmbajtjen ndaj politikës së konfliktit të interesit, duke përfshirë sanksionet ndërdisiplinore.

- *Pasojat vetjake* - Mospërmbajtja ndaj politikës së konfliktit të interesit të organizatës duhet të shihet në përgjithësi të paktën si një çështje disiplinore, ndërsa shkelje të tjera më serioze që përfshijnë një konflikt aktual, mund të çojnë në sanksione për abuzim me detyrën ose ndjekje penale për krimin e korrupsionit. Sanksione të tjera mund të zbatohen për zyrtarët publikë në varësi të seriozitetit të shkeljes – për shembull nëse nuk është mundur të regjistrohet një interes përkatës siç kërkohet ose një mospranim më serioz, për të zgjidhur një konflikt aktual të interesit për të cilin zyrtari publik është i ndërgjegjshëm. Sanksionet duhet të jenë të zbatueshme deri në masën që përfundimisht të ndikojë në punësimin ose karrierën e zyrtarit publik të përfshirë, kur është e përshtatshme.

- *Masat e drejtuesve* - Menaxhimi pozitiv mund të sigurojë forma plotësuese efektive për riparimin e shkeljeve të politikës së konfliktit të interesit dhe mund të jenë efektive, që të heqin dorë ata që kërkojnë përfitim, drejtpërdrejt ose tërthorazi, nga këto shkelje. Këto masa mund të përfshinin anulim me prapaveprim të vendimeve të ndikuara dhe kontratave të njollësura, dhe përjashtimin e përfituesve – qofshin korporata, individë ose shoqata etj. - nga proceset e ardhme. Këto masa përjashtimore mund të veprojnë për një periudhë të caktuar kohe, brenda kufijve monetarë të kontratës ose për tipe të caktuara të veprimtarive.

2.3.2. Krijoni mekanizma monitorues për të zbuluar shkeljet e politikës dhe për të marrë parasysh çdo përfitim që rezultoi nga konflikti.

- *Kontrollet* – Sigurohuni që kontrollet e drejtuesve dhe ato të brendshme

si dhe të institucioneve të jashtme mbikëqyrëse – si revizorët e pavarur ose një ombudsman – të funksionojnë sëbashku për të zbuluar ata që nuk iu përmbahen standardeve të kërkuara. Raportimi i përshtatshëm për institucionet mbikëqyrëse të pavarura dhe publikimi i raporteve të rregullta për implementimin e rregullimeve të menaxhimit të integritetit dhe progresi i çdo hetimi, mund të luajnë një rol të rëndësishëm për nxitjen e përmbajtjes ndaj politikës dhe dekurajimin e abuzimit me procesin e menaxhimit të integritetit.

- *Trajtimi i ankesave* – Krijoni mekanizma ankimi për të trajtuar akuzat e mospërmbajtjes dhe krijoni masa efektive për t'i nxitur ato. Siguroni rregulla të qartë dhe procedura për denoncimin dhe të merren hapa për të siguruar që ata, të cilët raportojnë shkelje në përputhje me rregullat e deklaruar, të jenë të mbrojtur kundër rapresaljeve dhe që të mos abuzohet me vetë mekanizmat e ankimit.

2.3.3. Bashkërendoni parandalimin dhe zbatimin e masave dhe i integroni ato në një kuadër koherent institucional.

- *Përgjegjësia e politikës* – Identifiko një funksion qendror, jo domosdoshmërisht një organizatë të pavarur ose agjenci qeveritare që ka përgjegjësinë për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e politikës dhe të procedurave të konfliktit të interesit; ky funksion mund të vlerësonte dhe të udhëzonte për menaxhimin nga ana e organizatës të politikës dhe procedurave të konfliktit të interesit, si dhe për zgjedhjen e organizatave përkras dhe përhapjen e përvojës së tyre më të mirë.

- *Sinergjitë* – Merrni në konsideratë përdorimin e kombinuar të instrumenteve plotësuese, për të mbështetur objektivat përkatës të politikës; për shembull, sistemet e njoftimit, që kërkojnë deklarime të rregullta të interesave financiarë dhe të interesave të tjerë, mund të parandalojnë konfliktet e mundshme të interesit, mund të ndihmojnë zbulimin e pasurimit të paligjshëm të zyrtarëve publikë dhe, gjithashtu, të ndihmojnë për të penguar praktikat korruptuese.

▪ *Konsekuenca e ligjeve* – Harmonizoni ligjet ekzistuese me politikën e konfliktit të interesit, për të zhdukur konfliktet dhe për të mundësuar zbatimin efektiv të politikës, përfshi kërkesat dhe sanksionet e denoncimit.

2.4. Inicioni një partneritet të ri me sektorët e biznesit dhe ata jofitimprurës

Mekanizmat për zgjidhjen e situatave të konfliktit duhet të përditësohen në kontekstin e rritjes së niveleve të bashkëveprimit midis organizatave publike dhe sektorëve të biznesit dhe ata jofitimprurës. Kjo është veçanërisht kritike kur caktohen përfaqësues në organet publike nga sektorë të tjerë për përfitim nga përvoja e veçantë, dijet dhe përfshirja.

2.4.1. Krijoni partneritete për integrimin me sektorët e biznesit dhe ata jofitimprurës, duke i përfshirë ata në përpunimin dhe implementimin e politikës së konfliktit të interesit për zyrtarët publikë.

▪ *Përfshirja e financuesve* - Përfshini përfaqësuesit e sektorëve të biznesit dhe ata jofitimprurës në rishikimin e politikës, në mënyrë që të merren pikëpamjet e tyre për problemet e implementimit dhe zbatimet e mundshme të politikës.

▪ *Këshillimet* – Sigurohuni që standardet e propozuara të paqyrojnë kërkesat aktuale të publikut, duke i përfshirë sektorët e biznesit dhe ata jofitimprurës në projektimin e masave të reja për integritetin. Këshillimet mund të përdoren për të identifikuar ose për të negociuar në mënyrë të ndërsjellë zgjidhje të pranueshme dhe duke nxitur bashkëveprimin në procesin e implementimit.

2.4.2. Parashikoni situatat e mundshme të konfliktit të interesit, kur organizatat publike ftojnë të marrin pjesë persona që përfaqësojnë sektorin e biznesit dhe atë jofitimprurës.

▪ *Probleme potenciale* – Parashikojini problemet potenciale në mënyrë që të maksimizoni përfitimin e përfshirjes së përfaqësuesve nga sektorët e tjerë në punën e organeve publike – të tilla si bordet dhe bordet këshillimore

– duke identifikuar situatat në të cilat përfshirja e përfaqësuesve mund të rezultonte në një konflikt interesi.

▪ *Masa mbrojtëse* – Ngrini mekanizma që parandalojnë informacionin konfidencial, autoritetin ose ndikimin e përfituar nëpërmjet përfshirjes në veprimtaritë e organeve publike, që të mos përdoren për përfitime vetjake ose avantazhe të gabuara nga afaristë të tjerë ose organizata jofitimprurëse. Shembuj të mekanizmave të parandalimit efektiv përfshijnë kufizimin e aksesit të një individi ndaj informacionit të veçantë konfidencial dhe kërkojnë identifikimin e interesave përkatëse private dhe të biznesit, për të emëruarit nga sektorët e biznesit dhe atyre jofitimprurës.

2.4.3. Ngrijeni ndërgjegjësimin për politikën e konfliktit të interesit, kur trajtoni sektorë të tjerë dhe përfshini masa mbrojtëse kundër situatave të mundshme të konfliktit të interesit, kur bashkëveproni me sektorët e biznesit dhe ata jofitimprurës.

▪ *Jepni informacion* – I bëni organizatat e tjera të ndërgjegjshme për pasojat e mundshme të mospërmbytjes ndaj rregullave (që mund të përfshijnë ndërprerjen ose anulimin me efekt prapashikues të një kontrate, duke e regjistruar dhe duke e publikuar një shkelje të provuar në një regjistër ose ndjekje penale për shkeljet penale si korrupsioni). Asistoni organizatat, për shembull nëpërmjet dhënies së kontraktuesve që kanë trajnim në përmbajtjen ndaj rregullave dhe në zbatimin e kërkesave të cituara.

▪ *Rishikoni së bashku zonat me rrezik* - Konfliktet potenciale të interesit duhet të identifikohen dhe duhet të krijohen mekanizma të përshtatshëm parandalues për të mbrojtur të dy palët në një situatë të mundshme konflikti. Për shembull, sigurohuni që organizatat partnere dhe sektori i biznesit të pranojnë që interesat përkatëse private duhet të zbulohen në mënyrë transparente në procesin e lobingut dhe që shkeljet ose tentativat për shkelje të politikës duhet të dalin në dritë në mënyrë që të trajtohen me vendosmëri dhe në mënyrë konstruktive. Në mënyrë të ngjashme, sigurohuni që organizatat partnere dhe sektori i biznesit të jenë të ndërgjegjshëm për

kërkesat e organizatës në lidhje me trajtimin e informacionit “të brendshëm” që nuk është në dispozicion të publikut, sigurohuni që informacioni “komercial në mirëbesim” të jetë i mbrojtur siç duhet me anë të proceseve verifikuese dhe sigurohuni që procedurat e vendimmarrjes në të gjithë etapat të mund të auditohen për integritetin dhe drejtësinë.

Përgjegjësia e kreut të shtetit

- Vëzhgime të shkurtra krahasuese -¹

Francis DELPÉRIÉE

Përktheu: Diana ESTREFI

Nuk është e lehtë të trajtosh një çështje juridike kur debati politik, jo ai elektoral, është në kulmin e vet. Sapo juristi fillon të shprehet në këtë kontekst, ai menjëherë radhitet në kampin e njërit prej protagonistëve, duke rrezikuar që në planin shkencor të skualifikohet, pa llogaritur këtu edhe atë që një ekspert tjetër do ta ketë shumë të lehtë t'i kundërvihet mendimit të tij. Dhe e kundërta, nëse ai tregohet i matur dhe shpreh mendime të ndryshme, sheh se e qortojnë si të ndrojtur, që nuk e nxjerr dot qimen nga qulli.

I gjori konstitucionalist... E ç'mund të thuash pastaj për një jurist të huaj, i cili gjithë naivitet, me cilësinë e mikut të përhershëm dëshiron të marrë pjesë edhe ai në debat? Ai goditet dyfish: akuzohet për të gjitha të këqijat dhe zyrtarisht përjashtohet. Përse përzihet ai në debat kur nuk është i dëshirueshëm? A nuk ka Belgjika, dhe kjo vlen edhe për shtetet e tjera, mjaft probleme institucionale të tilla? Të drejtën e qytetarisë e ka vetëm ai mendim që jepet në nivel kombëtar!

Unë i vlerësoj shumë studimet krahasuese, prandaj dhe nuk e pranoj këtë lloj arbitrariteti. Si specialist e di mirë se ka tradita konstitucionale të përbashkëta në shkallë europiane. Duan apo s'duan, të gjitha sistemet kombëtare i ruajnë gjurmët e tyre. Përjashtimi francez ndonjëherë nuk është

¹ Artikulli është marrë nga *Revue française de Droit constitutionnel*, 49, 2002, f.31.

gjë tjetër veçse maska e mosnjohjes. Ai, në mënyrë mjaft të mprehtë, shpreh refuzimin e të parit *ultra muros*, duke u bërë një pengesë për krahasime, përballje e shkëmbime të përvojave institucionale.

Kur drejtuesit e kësaj *Reviste* më kërkuan të hartoj disa vëzhgime mbi përgjegjësinë e kreut të shtetit, mendova se nuk i duhej bërë bisht kërkesës. Kjo çështje është në zemër të debatit francez. Por nuk është vetëm specifike e Republikës V Franceze, pasi ajo shtrohet, ndonëse jo me të njëjtat terma, edhe në vende të tjera europiane.

Për më se një shekull e gjysëm kreu i shtetit është konsideruar si një autoritet, madje shpeshherë si një personalitet që meritonte të qëndronte jashtë debatit. Kohët kanë evoluuar. Sot ai gjendet në zemër të debatit. Diku është institucioni që vihet në diskutim - mos vallë në demokraci monarkia ka dalë jashtë mode? Diku tjetër është personi i kreut të shtetit që kundërshtohet - mos vallë trashëgimia sjell rezultate më të mira? A kanë bërë populli apo përfaqësuesit e tij zgjedhjen e duhur? Dhe nëse veprimet e kreut të shtetit kanë shkaktuar hakmarrje publike dhe i janë nënshtruar gjykatësit - përse ai nuk e jep menjëherë vendimin, në formën e dënimit penal ose civil? Madje debati ndonjëherë bëhet në fushën e moralit politik, por, si gjithkund edhe këtu, a nuk e kërkon deontologjia që Mbreti të abdikojë ose presidenti të tërhiqet?

Këto pyetje janë sot të shpeshta. Ato mund të ushqejnë lojën e modës së fundit, e cila praktikohet nëpër sallone, në ofiçinat e partive ose në skenat televizive. Rregulli është fare i thjeshtë. Bëhet fjalë për të diskutuar, me çfarëdolloj mënyre kreun e shtetit. Duhet prononcuar *illico* (menjëherë) mbi përgjegjësitë e tij, për çfarë ka bërë ose duhej të bënte. Dhe do të ishte më mirë që të bëhen përpjekje për të marrë nga një gjyqtar, veçanërisht nga një gjyqtar penal, atë rezultat, i cili nuk ka mundur të realizohet në rrugë politike.

Shkurt, qëllimi është të zhduket ai që nga një moment në tjetrin mund të duket si “hallka e dobët”. Madje “hallka e fortë”, ajo e miqve të tij - po a ka miq në politikë? - urojnë ta largojnë, sepse ai u bën hije.

A duhet futur në këtë logjikë eliminuese? Apo më mirë është të analizohen realitetet institucionale në shkallë europiane dhe të rikujtohen disa nga rregullat që drejtojnë tradicionalisht statusin e kreut të shtetit? E pranoj, rëndësia është e kufizuar. Ajo që ndodh diku ose ndodh prej shumë kohësh, nuk është gjithmonë më e mira. Edhe në këtë fushë, si në gjithë të tjerat, ka vend për informacion të vazhdueshëm institucional. Por të paktën duhet të dihet mirë se në cilin kontekst meriton të hapet debati dhe çfarë zgjidhjesh japin ose këshillojnë shtetet e tjera të Europës.

Mite institucionale ka në qarkullim. Mbretërit, përfshirë edhe ata të Europës, gëzojnë, si të thuash, një imunitet absolut për veprimet a sjelljet e tyre. Presidentët do të duhej të trajtoheshin si qytetarë të thjeshtë të një shoqërie të barabartë. Atëherë, pse i duhet treguar një kujdes kaq i veçantë për Presidentin e Republikës Franceze? Pse t'i jepet një status i privilegjuar që të kujton atë të monarkëve të regjimeve të vjetra dhe të reja?

Këto pak rreshta kanë si objekt të tregojnë se pikënisja e arsytimit është e gabuar dhe se realitetet institucionale janë të ndryshme dhe me nuanca shumë më tepër nga sa thuhet (I). Por është edhe po aq e vërtetë se në shumicën e vendeve të Europës si mbreti dhe presidenti gëzojnë një status të ngjashëm lidhur me veprat penale dhe civile (II).

Duhet pranuar se ngjashmëritë janë shumë më të mëdha se sa ndryshimet dhe në këtë pikë Franca nuk është e vetme. Pa u vënë re po ndërtohet Europa e kryetarëve të shteteve.

I - DALLIMET MES STATUSIT TË MBRETIT DHE ATIJ TË PRESIDENTIT

Monarkitë dhe republikat jetojnë në sisteme të ndryshme administrimi, për të mos thënë edhe me ritme të ndryshme drejtimi. Një kryetar shteti ardhur si trashëgimtar nuk mund të gëzojë të njëjtat attribute si një president i zgjedhur, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të ndërmjetme, prej një trupe zgjedhore. Sigurisht që, sipas rastit, ka vend për republika të kurorëzuara ose monarki republikane. Ndonjëherë faktet politike mund t'i fshijnë disa

nga ndryshimet e përshkruara nëpër kushtetuta. Kjo do të thotë që statusi vetjak që përfiton kryetari i shtetit është i krahasueshëm në të dy sistemet.

A - MARRJA E FUNKSIONIT

Si përkufizim monarkia është vazhdimësi². Mbreti është njëri nga fisi.

Me vazhdimësi kuptohet mënyra funksionale; mbretëria ka funksion të përhershëm. Për më tepër rregullat e trashëgimit të fronit kanë saktësisht këtë qëllim: të shmangin mbetjen e zbrazët të pushtetit. Përjashtuar periudhën e kohës për kalimin nga njëri mbret te tjetri, që është e nevojshme për vendosjen e mbretit të ri dhe për të dëgjuar betimin e tij - *...beto hem se do të respektoj Kushtetutën ...*- thënia “Mbreti vdiq, rroftë mbreti” mbetet në fuqi.

Vazhdimësia nënkupton, gjithashtu, edhe diçka vetjake - synojmë të themi: fizike. Gjatë mbretërimit të tij, personi i mbretit është i mbrojtur nga ngjarje që, në njërën mënyrë a tjetrën, mund ta kompromentonin ushtrimin e përhershëm të veprimtarisë së tij. Funksioni mbretëror nuk njuh asnjëherë përkulje ose thyerje. Ai kurrë nuk duhet të pengohet të përmbushë detyrat që ia njuh Kushtetuta. Vetë ai nuk duhet të ndodhet në situata që ta bëjnë të pamundur mbretërimin. Në perspektivën e vazhdimësisë dinastike, përgjegjësia e kreut të shtetit nuk diskutohet. Mbreti nuk duhet të sillet keq asnjëherë. Personi i tij është i paprekshëm, madje i shenjtë, po të përdorim një fjalor pak të vjetruar, ashtu siç përcaktohet në disa kushtetuta. Imuniteti kushtetues që përfiton ai është absolut. Hetimet, marrjet në pyetje, ndalimet, gjykimet, burgimet - çdo masë që do të mund të kompromentonte vazhdimin e ushtrimit të funksionit të tij - janë të ndaluara.³

² Monarkia është shprehje e dukshme e vazhdimësisë së shtetit (F.Délpérée, “Gjashtë monarkë në Maastricht”, Le Monde des débats, shkurt 1993.

³ Ky vëzhgim nuk dëmton mundësinë e dyshimit për mbretin “lidhur me detyrimet e së drejtës private që kanë të bëjnë me pasurinë e tij”. Ai nuk përjashton as mundësinë që kreu i shtetit të ndërmarë vetë një aksion në drejtësi, për të mbrojtur interesat e tij private.

Republika, nga ana e saj, siguron ekzistencën pa ndërprerje të institucioneve publike, përfshirë edhe atë të kreut të shtetit. Por ajo lejon, madje organizon, largimin e titullarëve të pushtetit të lartë. Rregullat kushtetuese që lejojnë arritjen e këtij objekti janë të njohura: kohëzgjatja e mandatit presidencial, rastet e votimit, mospërsëritja e mandatit, kufizimet e moshës etj.

Mjetet kanë pak rëndësi; ajo që është më e rëndësishme janë pasojat. Për presidentin ekziston domosdoshmërisht një *para*, një *gjatë* dhe një *pas*. Ky njeri politik nuk ka qenë gjithmonë kryetar shteti dhe nuk do të jetë pambarimisht. Ai gëzon një mandat që është detyrimisht i përkohshëm. Presidenti mund të përndiqet për çështje që kanë të bëjnë me kohën kur nuk ka qenë i ngarkuar me republikën. Ose ai mund të akuzohet, gjatë mandatit të tij për një shkelje a tjetër që ka lidhje ose jo me funksionin e tij presidencial. Dhe më tej, si rast i tretë, në fund të mandatit, ai mund të vihet në akuzë për veprime të paligjshme të kryera gjatë kohës që nuk ka qenë president ose gjatë periudhës që përkon me atë të funksioneve të tij.

Në republikë situatat e fakteve dhe të së drejtës janë më komplekse. Prandaj ndoshta del nevoja e hartimit sa më të mirë të atyre regjimeve që vënë në akuzë përgjegjësinë e kreut të shtetit.

B - USHTRIMI I FUNKSIONIT

Por edhe konteksti institucional nuk duhet lënë mënjanë. Ai mund të çojë në shfaqjen e ndryshimeve të mëdha.

Mbreti nuk është vetëm i paprekshëm. Ai nuk përgjigjet kurrë personalisht për veprimet e tij. Janë ministrat, të cilët ai vetë i ka zgjedhur, që mbajnë gjithë përgjegjësinë politike.

Në qoftë se me rastin e një debati parlamentar veprimi vetjak i mbretit vihet në diskutim, i takon kryetarit të asamblesë të thërrasë për të dëgjuar ministrin që ka përgjegjësi të drejtpërdrejtë për kritikën e ngritura ndaj veprimeve për të cilat ai parimisht mban përgjegjësi.

Si mund të pranohet që një asamble politike duhet të deklarojë të padrejtë një veprim për të cilin është mbreti përgjegjës, në një kohë që është gjykata e cila vendos pa asnjë lloj pengese për shkeljet ose gabimet që kreu i shtetit mund të ketë bërë gjatë periudhës së ushtrimit të funksionit të tij.

Logjika institucionale drejtohet nga mungesa absolute e përgjegjësisë së mbretit, si politike, ashtu edhe penale ose civile. Por ky arsytim nuk vlen për presidentin.

Në vendet ku është zgjedhur drejtpërdrejt nga populli, kreu i shtetit ka bërë më parë një fushatë mbi një program politik. Ai ka përfituar votat e një pjese të mirë të zgjedhësve dhe, nëse është e nevojshme, është në gjendje të tregojë, gjatë mandatit të vet, që meriton besimin e opinionit publik. Zgjedhjet legjislativë ose referendumet mund të shërbejnë si instrumente matëse të popullaritetit, madje edhe të legjitimitetit të tij.

Presidenti zotohet, gjendet para kritikave të trupit zgjedhor dhe të mjediseve politike. Dogma e papërgjegjësisë nuk imponohet me të njëjtën mënyrë. Kontrollat e gjykatave ose të juridiksioneve *ad hoc* janë si gjithë kontrollat e tjera.

C - PUSHIMI I FUNKSIONIT

Mbreti është i mbrojtur nga rregulli i paprekshmërisë për të gjitha aktet që kryen gjatë periudhës së mbretërimit të tij. Ky imunitet është i përhershëm. Ai përfiton prej tij edhe kur heq dorë nga fronin. Ndërsa kur mbreti rrëzohet, ai mund të mos japë shpjegime për ngjarjet që kanë ndodhur gjatë mbretërimit të tij dhe veçanërisht për ato ngjarje që e kanë bërë të largohet.⁴

⁴ Publikimi në vitin 2001, pas vdekjes, i një libri të Leopoldit III me titull “*Për historinë, disa episode të mbretërimit tim*”, më bëri të vërej se “Nuk është mirë që një mbret të shkruajë kujtime..., aq më keq, është një bombë me plasje të vonuar e vënë nën fronin e pasardhësit të tij. Në rastin më të mirë s’është tjetër veçse një mbrojtje *pro domo*” (*La Libre Belgique*, 9-10 qershor 2001).

Po a mund ta mendoni se të njëjtin status gëzon një ish president? Pikërisht në këtë pikë shfaqen edhe ndryshimet më të thella.

Gjatë mandatit të tij presidenti në një farë mënyre është i paprekshëm. Ose të paktën përsa i përket drejtësisë. Çdo gjë ndryshon ditën që ai largohet nga detyra dhe ia lë vendin pasardhësit, i cili, nga ana e tij përpiqet të bëjë, si të thuash, inventarin e asaj që trashëgon. Mundohet të zbulojë parregullsitë ose pakujdesitë që mund të jenë bërë gjatë trajtimit të shumë problemeve, duke i evidentuar ato dhe duke i denoncuar, me qëllim që të heqë nga vetja përgjegjësinë për aktet e kryera prej paraardhësit.

Përveç këtyre manovrave paraqitet edhe një realitet tjetër. Ish-presidenti e ka humbur tashmë cilësinë e kreut të shtetit. Ai nuk është më i veshur me pushtetin e magjistraturës së lartë. Skrupujt konstitucionalë që ushqenin gjyqtarët zhduken. Ish-shefi i shtetit jo vetëm që ka lënë detyrën, por ka humbur edhe mburojën kushtetuese që e mbronte.⁵ Tashmë ai ndodhet para ditëve shumë të vështira.⁶ Dhe, duke përdorur një shprehje popullore, mund ta përmbledhim situatën në një fjali të vetme: ai i ka ngrënë të ëmblat në fillim, të hidhurat pritet t'i hajë më pas.

II - NGJASHMËRITË MES STATUSIT TË MBRETIT DHE TË PRESIDENTIT

Doktrina kushtetuese ka një veçori. Disa tema ajo i lë qëllimisht pa i lëvruar; një prej tyre është edhe ajo e kreut të shtetit. Sigurisht që autorët

⁵ Duhet të themi se nëse vërehen shkelje të kryera gjatë ushtrimit të funksionit presidencial, ato i drejtohen një gjykimi të veçantë, i cili i njeh si tradhti e lartë ose shkelje të Kushtetutës (*infra*).

⁶ Një komentues nuk mund të mos evokojë “figurën e një presidenti të lavdishëm gjatë kohës që kryen funksionin, (por) të kërcënuar nga mbarimi i imunitetit të tij, që në momentin që ai përcillet nga pasardhësi i vet”, në O.Jouanjan dhe P.Wachsman. “Gjykata e Kasacionit, Këshilli Konstitucional dhe Statusi Penal i Kreut të Shtetit”, *RFD Adm.*, 2001, f.1169.

pyesin mbi mënyrat e caktimit të tij në shtet, duke siguruar dhe detyrën e lartë të përfaqësimit të kombit. Kjo temë shtjellon se cilat janë atributet që i takojnë një mbreti ose presidenti në një sistem kushtetues të caktuar. Dhe e kundërta, ajo kurrë nuk preokupohet që të përcaktojë tiparet e përgjithshme të funksionit që kreu i shtetit ka për të përmbushur.

Është formuluar një hipotezë. Nëse në disa pika thelbësore funksioni i mbretit dhe ai i presidentit ngjajnë, atëherë përse statusi i tyre të mos ketë prirje për t'u përafuar? Historia, e tashmja dhe e ardhmja na lejon ta verifikojmë drejtësinë e këtij supozimi.

A - VAZHDIMËSIA E FUNKSIONIT

Historia na mëson se asnjë institucion nuk është i përjetshëm. Diku, dhe kjo ka ndodhur jo rrallë, është hequr monarkia dhe një president ka qënë pasardhës i një mbreti. Diku tjetër, dhe kjo në raste të jashtëzakonshme, është rivendosur monarkia. Pra, mbreti ka qënë pasardhësi i një presidenti. Por kjo nuk do të thotë se shoqëria politike është pak ose shumë demokratike. Ka ndryshuar vetëm mënyra e caktimit të kreut të shtetit. Mund të themi se njëra nga dy alternativat qëndron:

- Paprekshmëria dhe papërgjegjshmëria kanë të bëjnë me personin e mbretit. Heqja e monarkisë dhe largimi i monarkut të fundit, normalisht që e privojnë presidentin nga shumë gjëra të parardhësit të vet. Ai është pa mbrojtje, si ndaj aktit penal, ashtu edhe ndaj atij civil. Mungesa e privilegjeve dhe e imuniteteve e bëjnë personin e presidentit një qytetar si gjithë të tjerët. Rivendosja e monarkisë i rijep mbretit të drejtat e tij të dikurshme. Dhe ja ku është përsëri i mbrojtur nga ndërhyrjet e gjyqtarëve.

- Imunitetet nuk mund të shihen në një perspektivë të personalizuar. Në një shoqëri demokratike, një regjim i veçantë përgjegjësie - si e kreut të shtetit, e një anëtari qeverie, parlamentarë ose magjistrati - mund të urdhërohet vetëm në interes të funksionit që ai kryen. Si natyrë, imunitetet kanë lidhje me funksionin, pra janë funksionale.

Po të shohim mendimin e perspektivës së dytë, konsiderojmë se kreu i shtetit, cilado qoftë mënyra e zgjedhjes së tij, duhet të vendoset në situata të tilla që të kryejë si duhet detyrën. Ai nuk duhet të shqetësohet në ushtrimin e funksionit dhe të përgjegjësive, por të jetë në gjendje ta ushtrojë funksionin e mbretit ose mandatin e presidentit pa asnjë pengesë. Ndërhyrjet e drejtësisë nuk duhet ta prekin, si dhe nuk duhet t'ia largojnë vëmendjen nga ushtrimi i përgjegjësive të tij të larta.

Ç'do të thotë ushtrimi i funksionit mbretëror ose presidencial - në kuadrin e politikës së brendshme, politikës europiane dhe politikës ndërkombëtare - për dikë që duhet të merret në të njëjtën kohë edhe me një mijë e një detaje të daljes në gjyq ose të mbrojtjes para drejtësisë?

Për funksione të njëjta, mbrojtje të njëjta. Në këtë pikëpamje statusi i mbretit dhe ai i presidentit synojnë të afrohen. Nga ku rezulton kjo pasojë, e cila është e shprehur në nenin 130, paragrafi 4 i Kushtetutës Portugeze: "Presidenti i Republikës përgjigjet për krimet që do të kryente, përveç atyre që lidhen me ushtrimin e funksioneve, para gjykatave të zakonshme". Megjithatë, ai e bën këtë "kur ka mbaruar mandatin e tij". Edhe në nenin 49, paragrafi i parë i Kushtetutës së Greqisë, thuhet shprehimisht: "Për sa i përket akteve që nuk kanë lidhje me ushtrimin e funksioneve të tij (ato të Presidentit të Republikës), përndjekja penale mund të zhvillohet". Megjithatë, "ajo pezullohet deri sa të përfundojë mandati presidencial."

Pra, kemi të bëjmë me një sistem mjaft të zgjuar, i cili arrin të bashkojë detyrimin për të vazhduar kryerjen e funksioneve, ndarjen e pushteteve dhe përgjegjësinë penale të personave që janë të veshur me një mandat publik.

B - MBROJTJA E FUNKSIONIT

Ç'do të thotë që në një Republikë, përgjegjësia penale ose civile e presidentit nuk do të zbatohet gjatë mandatit të tij? Përgjigjja që sjell e drejta publike e krahasuar është e paqartë.

Në fakt dallimet janë të qarta. Ne i jemi drejtuar Presidentit B. Genevois,

i cili është përpjekur në shumë punime⁷ të tij të vendosë pak rregull në një të drejtë kushtetuese të paplotësuar, jo perfekte dhe ndonjëherë jokohërente, si dhe në një të drejtë publike që ka vështirësi të radhisë hipotezat dhe të japë zgjidhje sa më të përshtatshme. Kjo e drejtë është në rrugën e zhvillimit të saj.

Po të hartojmë një tabelë leximi, kemi tri situata që meritojnë domosdoshmërisht të veçohen.

Kështu, *së pari* kemi situatat e jashtëzakonshme. Të tilla janë ato që lindin nga “tradhtia e lartë” (Francë, Greqi), nga shkelja me dashje e kushtetutës (Austri, Greqi), e Ligjit Themeltar ose e një tjetër ligji federal (Republika Federale e Gjermanisë) dhe akoma më tej, sipas një formulimi më të ngushtë, rasti i “atentatit ndaj Kushtetutës” (Itali).

Presidenti bën një “shkelje të normave”. Në disa shtete, pikërisht aty ku ai ka bërë betimin për t’i qëndruar besnik republikës dhe të respektojë kushtetutën e vendit, kjo ka të bëjë me shkeljen e betimit. Presidenti që ka shkuar deri në tradhti ndaj besimit që republika dhe qytetarët e saj i kanë dhënë, duket se përndiqet parreshtur deri në çuarje në një gjyq special, krijuar për këtë rast. Por ende vërejmë se shumë shtete parashkruajnë këtu filtrat parlamentarë. Dhe kjo është më logjike. Në disa nga këto vende presidenti e ka bërë betimin kushtetues pikërisht para asamblesë. Shumicat parlamentare variojnë: dy të tretat e anëtarëve në Greqi dhe Portugali, gjysma e secilës nga dy asambltetë në Francë, gjysma e anëtarëve të parlamentit mbledhur në seancë të përbashkët në Itali, gjysma e anëtarëve të Asamblesë Federale, caktuar nga Këshilli Kombëtar në Austri.

⁷ B. Genevois, “Këshilli kushtetues dhe e drejta penale ndërkombëtare”, *RFD Adm.*, 1999, f. 285; “Këshilli kushtetues dhe e drejta penale ndërkombëtare. Disa vëzhgime plotësuese”, *RFD Adm.*, 2000, f.717; “Imunitetet e parashikuara në Kushtetutë dhe kontrolli juridiksional”, *Po aty*, f.511; “Imunitetet kushtetuese dhe privilegjet e juridiksionit. Francë”, *AJIC*, 2001.

Së dyti, kemi situatat e zakonshme, për të mos thënë banale. Ato krijohen, për shembull, nga shkeljet e kryera gjatë mandatit, por që s'kanë të bëjnë me funksionin presidencial, duke filluar nga shkeljet fiskale, deri tek aksidentet rrugore.

Së fundi, kemi situatat e ndërmjetme. Ato nuk janë as të jashtëzakonshme, as të zakonshme, por krijohen nga shkelje që mund të bëjë presidenti gjatë ushtrimit të funksionit. Disa prej tyre figurojnë në ligjet penale, disa janë specifike, pasi kanë të bëjnë me përmbushjen e detyrave presidenciale dhe që nuk do të mund të kryeshin nga persona ose autoritete të tjera.

Na lejohet të pyesim nëse këto dy kategori shkeljesh do të mund të trajtoheshin më vonë, me kalimin e kohës. Këtu nuk bëhet fjalë, si në rastin e mbretit, të ratifikosh rregullin e paprekshmërisë absolute. Por bëhet fjalë vetëm të krijosh kuadrin kronologjik të ndërhyrjes së autoriteteve të drejtësisë. Ushtrimi i ndjekjeve dhe proceset sipas rasteve janë të shtyrë në kohë.

C - VËNIA NE DISKUTIM E FUNKSIONIT

Tekstet kushtetuese mund të jenë të vjetëruara. Vendimet e drejtësisë janë të rralla, analizat doktrinale të shpërndara. A duhet të jemi të kënaqur me këto elemente pa lidhje, ku nuk ka vend për të proceduar për një përkufizim më të rreptë të statusit të kreut të shtetit, qoftë ai monark apo president? Shkrimi i ri i Kushtetutës imponohet pa dyshim nga arsye të brendshme. Ai justifikohet, gjithashtu, edhe me arsyen e evoluimit të së drejtës ndërkombëtare, e cila nuk bën aspak dallim mes një mbreti dhe një presidenti të republikës.

E drejta penale ndërkombëtare, nga kjo pikëpamje, i drejtohet së drejtës kushtetuese. Mbreti i Belgjikës është i paprekshëm dhe nuk mund të dalë para trupit gjykues belg. Presidenti i Republikës Franceze nuk është i paprekshëm, por gjatë mandatit ai nuk mund të dërgohet para Gjykatës së Lartë të Drejtësisë, përveç rastit të tradhtisë së lartë. Por, në qoftë se po ky Mbret i Belgjikës ose President i Republikës do të duhet të dalin para Gjykatës

Penale Ndërkombëtare, a mund të fitojnë? A vazhdojnë edhe këtu të jenë të mbrojtur personi dhe funksioni i tyre?

Statuti i Romës është një vepër përgjithësuese. Ai nuk bën dallime, nëse personi i kërkuar është privat ose person publik. Përkundrazi, ai i tregon me gisht autoritetet publike, duke përdorur pak a shumë këtë gjuhë: “Më shumë se të tjerët, ju jeni nga të parët për t’u gjykuar nga Gjykata Penale Ndërkombëtare.”

Kryetari i shtetit ndodhet këtu në rreshtin e parë. “Statuti zbatohet te të gjithë në mënyrë të barabartë, pavarësisht nga cilësitë e tyre zyrtare”, dhe kjo është e saktësuar aty pa asnjë ekuivok. Thënë ndryshe: “Kreu i shtetit nuk është më i paprekshëm, as përkohësisht, as *a fortiori* për gjithë jetën. Ai mund të dënohet si gjithë të tjerët.”

Për të gjithë ata që mund të dyshonin për autorët e këtij statuti, ai i vë mirë pikat mbi i: “veçanërisht (pa marrë këtu në konsideratë) në cilësinë zyrtare të kreut të shtetit” të çdo personi. Kjo cilësi në fakt nuk bën përjashtim “në asnjë rast, nga përgjegjësia penale e këtij statuti”. Gjithashtu, ajo nuk është më motiv për të pakësuar dënimin.

Për të gjithë ata që nuk duan t’i dëgjojnë këto tipe konsideratash, Statuti saktëson në nenin 27, paragrafi 2, se imunitetet ose privilegjet që ekzistojnë si në të drejtën kombëtare, ashtu edhe në atë ndërkombëtare “nuk përbëjnë asnjë pengesë për Gjykatën Penale të ushtrijë kompetencat e veta ndaj këtij personi.”

Si mund ta shprehim më mirë idenë se e drejta penale ndërkombëtare po përpiqet që të gjitha zgjidhjet që jep ajo të fitojnë mbi ato të së drejtës kushtetuese ose të së drejtës penale kombëtare, të cilat do t’i kundërviheshin atyre? Nuk do të shërbente aspak dëshira për të zhvilluar rreth kësaj teme interpretime zbutëse, si dhe përpjekjet për të harmonizuar zgjidhjet e së drejtës kombëtare dhe të së drejtës ndërkombëtare. Ato janë kontradiktore. Përplasja është frontale.

Disa Shtete e kanë modifikuar Kushtetutën e tyre me qëllim që të ratifikojnë

Statutin e Romës.⁸ Po a nuk duhej shkuar më tej? Për çfarë shërben të shkruash në Kushtetutë dy zgjidhje kontradiktore? Në këtë fushë, si monarkitë, ashtu edhe republikat janë në të njëjtin hall.

Në miqësi, çiltërsia është një detyrim.

Jashtë vendit tonë, qarqet konstitucionaliste nuk kanë mundur ta kuptojnë rrëmujën, e madje edhe çoroditjen, që kanë shkaktuar vendimi i Këshillit Kushtetues i 22 janarit 1999 dhe ai i Asamblesë Plenare të Gjykatës së Kasacionit i 10 tetorit 2001.⁹

Zgjidhjet që këto juridiksione të larta kanë gjetur, dhe që në shumicën e rasteve përshtaten, janë ato që vlejnë më shumë, si dje edhe sot, për vende të tjera europiane, si për monarkitë, ashtu edhe për republikat.

E drejta publike e krahasuar na mëson se nuk duhet të kopjohen në mënyrë servile zgjidhjet që janë në fuqi në vende të ndryshme. Por ajo na mëson kuptimin e relatives. Ajo na fton të mos e konsiderojmë si të jashtëzakonshme

⁸ Pa proceduar në një rishikim paraprak të nenit 88 - as edhe atyre 58 dhe 103 - të Kushtetutës, Shteti Belg ka prokuruar miratimin e Statutit të Romës mbi Gjykatën Penale Ndërkombëtare, duke ekspozuar kështu mbretin, ministrat dhe parlamentarët ndaj masave të ndjekjes, madje dhe të gjykimit, përveç kushteve të parashkruara nga Kushtetuta. Këshilli i Shtetit nuk ka munguar të vërë në dukje se kjo mënyrë të vepruari ishte e papërshtatshme (L.28.936/2, 21 prill 1999). Për të harmonizuar angazhimet kushtetuese dhe ndërkombëtare të Belgjikës (F. Delpérée, “*Lidhjet mes së drejtës kushtetuese dhe asaj ndërkombëtare. Zhvillimet e fundit*”, në këtë *Revistë*, f.730), do të ishte mirë të futej një klauzolë e veçantë në tekstin kushtetues, për shembull një nen 168/bis, i ri, që mund të ishte konceptuar kështu: “Shteti aderon në Statutin e Gjykatës Penale Ndërkombëtare, të krijuar në Romë më 17 korrik 1998”. Një dispozitë e tillë do të përmbushte të gjitha adaptimet që do rezultonin nga rendi juridik kushtetues.

⁹ Pikërisht në studimet e O. Jouanjan dhe P.Wachsmann (*cit. më sipër*), si dhe të O.Beaud (“Për një interpretim tjetër të nenit 68 të Kushtetutës”, *RFD Adm.*, 2001, f.1187), përmbledhje të studimeve që janë publikuar mbi këtë temë.

atë që diku është diçka e zakonshme. Dhe të mos harrojmë arsyen e përbashkët. A nuk është e drejta kushtetuese, dhe besoj se kjo nuk vihet në dyshim, një çështje që lidhet me atë çka është e përbashkët?

Sigurisht që kjo e përbashkët arrin të shkruhet në tekstet kushtetuese të përditësuara - dhe jo vetëm në ato dokumente që shfaqen si relike të regjimeve të vjetra. Ajo meriton të shprehet në mënyrë të detajuar në hipotezat që ngrihen, në procedurat që duhen zbatuar, në sanksionet që parashikohen.

Heshtja dhe lakonizmi i shumë kushtetutave aktuale është në kontrast me proliksitetin e Statutit të Gjykatës Penale Ndërkombëtare. Nëse kushtetutat europiane duan të ruajnë një kuptim, ato duhet të pozicionohen mbi secilën nga temat. A do ishte e tepruar kërkesa që ato ta bëjnë këtë me sa më shumë qartësi, saktësi dhe arsytim?

Do të jetë në interes të tyre të pyesin për mënyrën se si kushtetutat e tjera europiane e parashikojnë të njëjtën problematikë.

Nga punimet e Kuvendit për periudhën nëntor - dhjetor 2003

Përgatiti: Alma Kondakçi

Objekti kryesor i punës së Kuvendit gjatë muajve nëntor-dhjetor 2003 ka qenë shqyrtimi i projektligjit “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2004” dhe i paketës fiskale që shoqëron këtë projektligj. Për shqyrtimin e këtyre projektligjeve, Komisioni i Përhershëm i Ekonomisë, Financave dhe Privatizimit ka bashkërenduar punën me komisionet e tjera të përhershme të Kuvendit mbi bazën e një programi pune të veçantë. Në një mbledhje të përbashkët të kryetarëve të komisioneve dhe të kryetarëve të grupeve parlamentare u bë paraqitja e projektbuxhetit dhe i paketës fiskale nga Ministri i Financave. Gjithashtu, në Komisionin e Përhershëm të Ekonomisë, Financave dhe Privatizimit Governatori i Bankës së Shqipërisë paraqiti programin monetar të Bankës së Shqipërisë për vitin 2004.

Gjatë shqyrtimit të këtyre projektligjeve, komisionet e përhershme të Kuvendit kanë mbajtur kontakte të vazhdueshme me drejtuesit dhe specialistët e Ministrisë së Financave dhe të institucioneve të tjera, me drejtuesit e institucioneve të pavarura, me shoqata joqeveritare që mbështesin zhvillimin e arsimit, me përfaqësues të Dhomës së Tregtisë e Industrisë dhe të Shoqatës së Agrobiznesit.

Krahas projektligjeve të paraqitura nga Këshilli i Ministrave, Kuvendi ka shqyrtuar edhe amendamentet e paraqitura nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike. Ndryshimet më të rëndësishme që propozohen në këto amendamente, në të cilat kanë gjetur pasqyrim edhe vërejtjet e shoqatave të biznesit, po i përmend shkurtimisht sipas projektligjeve përkatëse.

1. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8560,

datë 12.12.2002 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”

Projektligji synon shmangien e disa zbrazëtimeve ose keqinterpretimeve dhe lehtësimin e procedurave administrative për tatimpaguesit dhe administratën tatimore. Ndryshimet më të rëndësishme konsistojnë në përmirësimin e funksionimit të administratës tatimore, duke përcaktuar rregulla më të qartë për organikat, pagat dhe rekrutimin e personelit të saj, në transparencën e administratës tatimore ndaj publikut, në regjistrimin e ortakërive dhe të organizatave jofitimprurëse, në rishikimin e metodave alternative të përcaktimit të detyrimit tatimor dhe vendosjen e një afati për vlerësimin tatimor në rastin e një kontrolli tatimor, në rregullimin e bërë për nxjerrjen me forcë të detyrimit tatimor, në rishikimin e procedurave të jashtëzakonshme të mbledhjes me forcë të detyrimeve, në uljen e limitit të lejimit të kryerjes së pagesave me para në dorë të transaksioneve të shitblerjes.

Gjatë shqyrtimit të projektligjit në komisionet e përhershme të Kuvendit dhe në seancë plenare çështjet më të diskutueshme ishin:

- Në projektligj parashikohet ngritja e Këshillit të Tatimeve dhe e Komisionit të Disiplinës së Tatimeve, si organe në varësi të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve. Sipas specialistëve, të dy këto organe kanë funksione këshillimore, i pari në drejtim të ndarjes së fondeve midis rretheve, ndërsa i dyti për zbatimin e masave disiplinore si rezultat i shkeljeve ligjore. Gjatë diskutimit deputetët e konsideruan të tepërt dhe të panevojshëm krijimin e të dyja këtyre strukturave, të cilat, sipas tyre, kanë të njejtin funksion, janë organe këshillimore pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve. Duke mbështetur këtë argument, Kuvendi vendosi që neni që bën fjalë për krijimin e Këshillit të Tatimeve të hiqet dhe të qëndrojë neni që bën fjalë për krijimin e Komisionit të Disiplinës së Tatimeve.

- Sipas projektligjit, Kryeministri, me propozim të Ministrit të Financave, përcakton organikën dhe strukturën e administratës tatimore. Disa deputetë u shprehën kundër këtij koncepti që ata e konsiderojnë një centralizim të tepëruar të kompetencave, duke kërkuar që organikën dhe strukturën e

administratës tatimore ta miratojë Ministri i Financave, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve. Në përfundim të diskutimit, deputetët, me shumicë votash, miratuan formulimin e projektligjit për këtë çështje, i cili, sipas tyre, është në përputhje me ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”.

- Një nga nenet mjaft të diskutueshme ka qenë ai që bën fjalë për metodat alternative të përcaktimit të detyrimit tatimor. Deputetët, me shumicë votash, miratuan disa ndryshime në procedurat e rikarakterizimit të transaksioneve, për të reflektuar gjendjen reale të të ardhurave nga shitja të tatimpaguesve.

Deputetët opozitarë në amendamentet e tyre propozuan ndryshimin e formulimit të dhënë në këtë nen për “manipulimin e çmimeve”, i cili, sipas tyre, krijon premisa për veprime arbitrare dhe abuzive nga administrata tatimore në përcaktimin e nivelit të çmimeve. Në përfundim të diskutimit, Kuvendi e miratoi propozimin e tyre, duke dhënë një përcaktim më të saktë për “deformimin e çmimeve të shitjes”, i cili e ve administratën tatimore para detyrimit për të vepruar mbi bazën e fakteve, kur është e mundur, ose mbi bazën e çmimeve krahasuese të tregut.

Kuvendi miratoi edhe një propozim tjetër të opozitës për këtë nen, sipas të cilit rikarakterizimi i transaksioneve bëhet në mbështetje të ligjeve në fuqi, si dhe duke marrë në konsideratë burime të besueshme për përcaktimin e nivelit të çmimeve. Ky ndryshim, sipas propozuesve të amendamentit, do të ulë abuzivitetin e administratës tatimore në përcaktimin e nivelit të çmimeve, si dhe evazionin fiskal në pagimin e detyrimit tatimor nga tatimpaguesit.

- Kuvendi miratoi amendamentin e paraqitur nga deputetët opozitarë për ndryshimin e nenit që bën fjalë për vënien në dijeni të publikut për ligjet e reja tatimore, duke vendosur në këtë nen afatin 15-ditor për kryerjen e këtij informimi.

- Deputetët e opozitës në amendamentet e tyre propozuan ndryshimin e nenit, sipas të cilit tatimpaguesit duhet të paguajnë të gjitha detyrimet tatimore përpara se të paraqiten për apelim, përfshirë këtu edhe dënimet administrative dhe interesat. Ata propozuan një riformulim të këtij neni, i cili, sipas tyre,

shmang parapagimin e interesave, të gjobave dhe pjesës së kundërshtuar nga tatimpaguesi të detyrimit tatimor para procesit të apelimit, duke e shtyrë kryerjen e këtyre pagesave pas dhënies së vendimit përfundimtar nga gjykata. Sipas tyre, shtesa e këtij neni synon të zhdukë parapagimin e detyrimeve tatimore në rastin kur ato vendosen abuzivisht nga organi tatimor dhe vendos tatimpaguesin para sanksioneve e penalteteve në rast se ai ngre pretendime të pavërteta ose mundohet të fshehtë detyrimet tatimore. Pas diskutimit, ky propozim nuk u miratua nga shumica e deputetëve.

- Deputetët diskutuan e miratuan amendamentin e opozitës për ndryshimin e nenit që bën fjalë për kohëzgjatjen e kontrolleve nga organi tatimor, e cila u vendos të mos jetë më shumë se një muaj dhe vendosën një afat 15-ditor për përgatitjen e vlerësimit tatimor nga organi tatimor dhe njoftimin e tij tatimpaguesit, me argumentin që ky ndryshim rrit efikasitetin e kontrolleve dhe pakëson abuzivitetin e administratës tatimore. Ky amendament mbështet kërkesën e shoqatave të biznesit, të cilat kërkojnë normimin ligjor të kontrolleve.

2. Projektligj “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8977, datë 12.12.2002 “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë”

Ndryshimet që u propozuan për këtë projektligj kanë të bëjnë me heqjen e taksës së rrugës Durrës-Kukës, me vendosjen e taksës së qarkullimit rrugor, me uljen e përqindjes që i lihet agentit tatimor (Drejtorisë së Përgjithshme të Transportit Rrugor) nga vjelja e taksës për aks dhe me ndryshimin e masës së taksës për disa shërbime të radiotelekomunikacionit.

Gjatë shqyrtimit të projektligjit në komisionet e përhershme të Kuvendit dhe në seancë plenare deputetët, si të pozitës, ashtu edhe të opozitës, u shprehën për me heqjen e taksës për rrugën Durrës-Kukës, e cila, sipas tyre, do të sjellë përmirësimin e sistemit fiskal, në përputhje me standardet e BE-së. Deputetët opozitarë theksuan se kjo taksë është vendosur në kundërshtim me parimet e financave publike dhe është përdorur për mbulimin e deficitit buxhetor. Përfaqësuesit e Qeverisë informuan deputetët se të

ardhurat e mbledhura nga kjo taksë nuk janë përdorur për mbulimin e deficitit buxhetor dhe se destinacioni i tyre do të jetë për ndërtimin e kësaj rruge.

Deputetët e opozitës kundërshtuan vendosjen e taksave të reja kombëtare, taksës së qarkullimit rrugor për automjetet, si dhe taksës për regjistrimin e lojërave të fatit, kazinotë dhe garat sportive, të cilat, sipas tyre, rëndojnë taksapaguesit dhe dekurajojnë investitorët. Në amendamentet e paraqitura nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike propozohet heqja e këtyre taksave.

Në përfundim të diskutimit Kuvendi miratoi pa ndryshime, me shumicë votash, projektligjin e paraqitur nga Këshilli i Ministrave.

3. Projektligj “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat”

Ndryshimet që u propozuan t’i bëhen këtij ligji kanë të bëjnë kryesisht me diferencimin e akcizës për benzinën me plumb, krahasuar me benzinën pa plumb, për të rritur përdorimin e benzinës pa plumb, e cila ndot më pak mjedisin, me rritjen e akcizës së naftës nga 50 për qind në 65 për qind me synim kompensimin e uljes së të ardhurave nga heqja e taksës së rrugës Durrës-Kukës, me heqjen nga lista e akcizës të gazit të lëngët që përdoret për automjetet dhe të maltos që përdoret për prodhimin e birrës, vetëm për tatimpaguesit e regjistruar si prodhues birre, me lejimin e lëvizjes së alkoolit që prodhohet brenda vendit, nga një magazinë tatimore e miratuar, në një magazinë tjetër tatimore të miratuar, për të punuar nën regjimin e pezullimit tatimor, me përjashtimin nga akciza të karburantit që përdoret për zbulimin dhe vënien në shfrytëzim të zonave naftëmbajtëse nga subjektet që kanë nënshkruar marrëveshje me Qeverinë Shqiptare, me njehsimin e nivelit të procedurave për llogaritjen e interesave për detyrimet e papaguara në afat.

Gjatë shqyrtimit të projektligjit në komisionet e përhershme të Kuvendit dhe në seancë plenare çështja më e debatueshme ishte parashikimi në projektligj i rritjes së nivelit të akcizës për benzinën dhe naftën. Deputetët opozitarë, të nxitur nga kërkesat e shoqatave të biznesit, u shprehën kundër rritjes së nivelit të akcizës së benzinës dhe naftës, e cila, sipas tyre, dëmton

prodhimin vendas. Sipas tyre, në kushtet e mungesës së energjisë elektrike, përdorimi i karburanteve me akcizë më të lartë nga biznesi vendas rrit koston e prodhimit vendas, duke e bërë atë më pak konkurrues në treg. Përfaqësuesit e Qeverisë theksuan se rritja e nivelit të akcizave të karburanteve ka si qëllim kryesor kompensimin e uljes së të ardhurave nga heqja e taksës së rrugës Durrës-Kukës. Në përfundim të diskutimit Kuvendi miratoi me shumicë votash propozimin e projektligjit për këtë çështje.

Gjithashtu, deputetët opozitarë në amendamentet e tyre për projektligjin propozuan diferencimin e akcizës për duhanin, duke kërkuar uljen e nivelit të akcizës për cigaret që përmbajnë duhane orientale (prodhim vendi), për të mbështetur industrinë vendase të duhanit dhe prodhuesit bujqësorë. Sipas tyre, kjo kërkesë mbështetet në kërkesat e shoqatave të fermerëve dhe industrialistëve të duhaneve. Në përfundim të diskutimit ky amendament nuk u miratua nga Kuvendi me shumicë votash.

Deputetët në diskutimet e tyre kërkuar heqjen e akcizës për ujin, e cila rrit mjaft çmimin e tij. Duke qenë se akciza është një mbitaksë që vendoset mbi mallrat e luksit dhe mallrat e shtrenjta, theksuan ata, nuk është e drejtë që të vendoset akcizë për ujin. Në përfundim të diskutimit Kuvendi miratoi propozimin për heqjen e akcizës për ujërat minerale ose natyrore dhe ujërat e gazuara.

4. Projektligj “ Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”

Ndryshimet që u propozuan t’i bëhen ligjit nuk krijojnë detyrime tatimore shtesë dhe nuk rrisin ngarkesën tatimore për tatimpaguesit. Nëpërmjet këtyre ndryshimeve synohet të rriten të ardhurat nga TVSH-ja nëpërmjet administrimit më të mirë të këtij tatimi dhe përfshirjes në këtë sistem tatimi të të gjithë tatimpaguesve, të cilët ushtrojnë veprimtari në fushën e tregtisë me shumicë. Në këtë projektligj janë propozuar edhe një sërë përjashtimesh nga TVSH-ja, siç janë qiradhënia e ndërtesave pronë publike, shërbimet arsimore, shpenzimet e transportit që bëhen brenda vitit për mallrat e

importuara. Gjithashtu, projektligji parashikon njohjen e firove ligjore që pësojnë mallrat gjatë tranzitimit, magazinimit dhe prodhimit, detyrimin e organeve tatimore për t'iu përgjigjur tatimpaguesit brenda një afati 30-ditor dhe njehsimin me ligj të rregullave të rimbursimit të TVSH-së.

Gjatë shqyrtimit të projektligjit në komisionet e përhershme të Kuvendit dhe në seancë plenare çështjet më të debatueshme ishin:

- Projektligji propozon përjashtimin nga pagimi i TVSH-së të ndërtesave pronë publike. Një pjesë e deputetëve, veçanërisht ata opozitarë, u shprehën kundër këtij përjashtimi, i cili, sipas tyre, sjell disa pasoja negative: *së pari*, ai çon në prishjen e tregut të qirasë së banesave e trojeve, duke diskriminuar tregun privat; *së dyti*, favorizon në konkurrencë bizneset që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në ndërtesa e troje të marra me qira nga shteti dhe *së treti*, krijon mundësi që përfitues të këtyre mjediseve të jenë personat që janë të lidhur me ushtruesit e këtyre pushteteve. Nisur nga këto argumente, deputetët e opozitës në amendamentet e tyre kërkuan heqjen e nenit që bën fjalë për këtë përjashtim nga TVSH-ja. Në përfundim të diskutimit Kuvendi nuk miratoi me shumicë votash propozimin e opozitës për këtë çështje, duke lënë në fuqi projektligjin e paraqitur nga Këshilli i Ministrave.

- Një amendament tjetër i paraqitur nga deputetët opozitarë i referohet rastit të parapagimit të TVSH-së në doganë, kur vlerësimi doganor nuk bëhet në bazë të faturës, por në metodat alternative të çmimeve referuese. Sipas propozuesve të amendamentit, kur pagesa për një furnizim, e llogaritur nga organi tatimor në një moment të mëparshëm, reduktohet në ulje në momentin e furnizimit, atëhere duhet të reduktohet edhe vlera e tatueshme e furnizimit. Në përfundim të diskutimit Kuvendi nuk e miratoi me shumicë votash këtë amendament.

- Në amendamentet e paraqitura nga deputetët opozitarë kërkohet t'i jepet me ligj Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve e drejta të autorizojë personat e tatueshëm, që ushtrojnë veprimtari ekonomike dhe që furnizohen me lëndë të para bujqësore e blegtorale nga persona të paregjistruar për tatimin mbi vlerën e shtuar, të lëshojnë fatura tatimore për veten. Ata theksuan

se në kushtet kur fermerët nuk janë të regjistruar si subjekte dhe nuk janë të pajisur me fatura të TVSH-së, përpunuesit e lëndëve të para bujqësore rëndohen padrejtësisht me një pagesë më të lartë të TVSH-së kur furnizohen me lëndë të para të prodhimit vendas, se sa kur i importojnë me çmime krahasuese në tregun e brendshëm. Sipas tyre, duke qenë se projektligji i njeh të drejtën e vetëlëshimit të faturave tatimore vetëm prodhuesve të qumështit, kjo e drejtë nuk duhet t'u mohohet industrive të tjera. Në përfundim të diskutimit Kuvendi e miratoi këtë amendament të paraqitur nga opozita.

5. Projektligj “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”

Ndryshimet që u propozuan t'i bëhen këtij projektligji kanë të bëjnë kryesisht me përfshirjen e tatimit të çdo lloj të ardhure me burim në Republikën e Shqipërisë dhe me mbajtjen e tatimit në burim vetëm ndaj personave, të cilët nuk janë subjekt i tatimit mbi fitimin ose i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, me ndryshimin e pasqyrës së tatimit mbi pagat, me ndryshimin e disa tarifave tatimore nga 15 në 10 për qind, me disa ndryshime për të njehsuar këtë ligj me ligjin “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, me njohjen e shpenzimeve të përfaqësimit dhe të pritje-përcjelljeve jo mbi fitimin, por kundrejt shifrës vjetore të afarizmit, me kufizimin e fushës së veprimit të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, për të kufizuar shmangien nga tatimi të të vetëpunësuarve ambulantë në fushën e shërbimeve, me përmirësimin e neneve për mirëmbajtjen e regjistrimeve, me ndryshimin e shkallës tatimore të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin dhe diferencimin e saj.

Gjatë shqyrtimit të projektligjit në komisionet e përhershme të Kuvendit dhe në seancë plenare shumica e deputetëve, përfaqësues të maxhorancës, u shprehën dakord me projektligjin në parim, duke propozuar disa ndryshime e riformulime në disa nene të tij. Ndryshimet kryesore të propozuara prej tyre ishin:

- Neni që bën fjalë për deklarimin tatimor dhe llogaritjen përfundimtare

të detyrimit. Ky ndryshim synon që, kur shumata e parave të parapaguara në llogarinë e organeve tatimore nga tatimpaguesit janë më të larta se tatimi i llogaritur nga organi tatimor, në bazë të deklaratës vjetore të të ardhurave të tatueshme, diferenca të njihet nga organet tatimore në favor të tatimpaguesit për shlyerjen e detyrimeve tatimore të prapambetura ose për pagesën e detyrimeve të ardhshme ose t'i rikthehet tatimpaguesit.

- Heqja e nenit që parashikon rritje të tatimit mbi të ardhurat për disa kategori pagash të larta, për të mos rritur ngarkesën e këtij tatimi.

- Disa deputetë propozuan përjashtimin nga tatimi mbi të ardhurat të shpërblimeve që jepen për administratën publike në rast festash, por ky propozim nuk u miratua nga shumica e deputetëve me argumentin që ky përjashtim mund të krijojë premisa për evazion fiskal.

Deputetët opozitarë e kundërshtuan projektligjin, i cili, sipas tyre, synon zgjerimin e fushës së veprimit të këtij ligji, pra, shtimin e llojshmërisë së të ardhurave që i nënshtrohet tatimit, si dhe rritjen e përqindjes së tatimit për disa kategori biznesi si shërbime e profesione të lira. Sipas tyre, rritja e ngarkesës tatimore çon në rritjen e informalitetit, duke pakësuar në masë absolute të ardhurat nga ky tatim. Mbështetur në argumentet e mësipërme, deputetët opozitarë propozuan disa amendamente, të cilat, sipas tyre, çojnë në minimizimin e evazionit fiskal në mbledhjen e këtij tatimi. Amendamentet kryesore që propozuan ata ishin:

- Amendamenti që ka të bëjë me përjashtimin nga pagimi i tatimit mbi të ardhurat i kategorisë së biznesit të vogël, kur xhiroja vjetore është më pak se 3 milionë lekë. Kjo kërkesë, theksuan ata, lehtëson biznesin e vogël nga ngarkesa fiskale. Efekti i këtij përjashtimi në buxhet, sipas tyre, është i papërfillshëm, për shkak të evazionit të lartë në mbledhjen e tij. Në përfundim të diskutimit Kuvendi e miratoi amendamentin e mësipërm.

- Shfuqizimi i nenit që i jep të drejtë organit tatimor të përcaktojë një detyrim tatimor shtesë për tatimpaguesin, në rastin kur ai nuk ka dorëzuar deklaratën tatimore ose nuk ka deklaruar shumën e plotë të qarkullimit. Dhënia e së drejtës inspektorit tatimor që të caktojë masën e tatimit mbi të ardhurat

për biznesin që nuk është objekt i TVSH-së, sipas tyre, përbën një mundësi për abuzivitet, korrupsion dhe evazion fiskal. Ata theksuan se heqja e këtij neni nuk sjell pasoja, pasi për rastet e shkeljeve dhe fshehjeve të tatimeve, në ligj përcaktohen penalitete. Kuvendi nuk e miratoi këtë amendament me shumicë votash.

- Amendamenti që vë organin tatimor para detyrimit që të vërtetojë deklaratën vjetore të të ardhurave, bilancin kontabël dhe llogarinë “fitime dhe humbje” brenda dy muajve të dorëzimit të tyre nga tatimpaguesi në organin tatimor. Sipas tyre, ky amendament synon të minimizojë rastet e përcaktimit arbitrar të masës së tatimit nga administrata tatimore. Pas diskutimit Kuvendi e miratoi këtë amendament.

- Në amendamente propozohet vendosja e një tarife unike të tatimit mbi të ardhurat për të gjithë biznesin, duke mos e shkallëzuar atë sipas projektligjit, i cili vendos tarifë më të lartë për kategoritë e profesioneve të lira dhe shërbimeve. Gjithashtu, propozohet që edhe shitësit e mallrave me shumicë t’i nënshtrohen tatimit mbi të ardhurat dhe jo tatimit mbi vlerën e shtuar. Ky amendament, sipas tyre, synon të mos rritet ngarkesa fiskale për biznesin. Në përfundim të diskutimit Kuvendi nuk e miratoi këtë amendament.

6. Projektligj “Për një ndryshim në ligjin nr.8981, datë 12.12.2002 “Për miratimin e niveleve të tarifës doganore”

Projektligji synon uljen e tarifave doganore për 1250 kode tarifore në nivele të ndryshme në kuadrin e zbatimit të detyrimeve që rrjedhin nga anëtarësimi i Shqipërisë në Organizatën Botërore të Tregtisë. Në projektligj propozohet heqja e tarifave doganore për një grup mallrash, si dhe ulja e nivelit të tarifave doganore nga 15 për qind në 10 për qind dhe nga 10 për qind në 6 për qind për disa grupmallrash të tjera.

Sektorët që preken më tepër nga ulja e tarifave doganore janë industria e agropërpunimit, industria e birrës, industria e vajit, industria e prodhimit të preparateve pastruese dhe industria e peshkimit.

Për të lehtësuar degët e industrisë, të cilat preken nga ndryshimi i tarifave

doganore, Komisioni i Përhershëm i Ekonomisë, Financave dhe Privatizimit u kërkoi përfaqësuesve të ministrive, të pranishëm në mbledhje, të merrnin takim me përfaqësuesit e biznesit dhe të paraqisnin pranë këtij Komisioni propozimin e tyre lidhur me kërkesat e biznesit për uljen ose heqjen e disa tarifave doganore, kryesisht për ambalazhet, të cilat përdoren në degë të ndryshme të industrisë përpunuese.

Deputetët e opozitës e kundërshtuan projektligjin e paraqitur nga Qeveria, i cili, sipas tyre, ruan nivele të larta të tarifave doganore për lëndët e para të importit, si dhe për ambalazhet që përdoren nga shumë biznese në sektorin agro-ushqimor, ndërkohë që tarifatat doganore për produktet e gatshme bëhen zero. Sipas tyre, kjo do të sjellë dekurajimin e investitorëve vendas dhe falimentimin e një sërë biznesesh që kanë investuar në këta sektorë. Për këtë arsye, në amendamentet e tyre deputetët opozitarë kërkuan heqjen e tarifave doganore për të gjitha makineritë dhe linjat e prodhimit, lëndët e para dhe ambalazhet që nuk prodhohen në tregun e brendshëm. Sipas tyre, kjo do të sjellë rritjen e vëllimit të investimeve, ekonomisë dhe punësimit. Ata theksuan se efektet e këtyre ndryshimeve në Buxhetin e Shtetit do të jenë pozitive që vitin e parë.

Në përfundim të diskutimit Kuvendi miratoi propozimin e përfaqësuesve të ministrive, të rënë dakord me përfaqësuesit e biznesit, për të bërë ndryshime në projektligjin e paraqitur nga Këshilli i Ministrave për uljen e taksave doganore në disa artikuj. Efektet financiare në uljen e të ardhurave doganore për shkak të uljes së tarifave doganore për vitin 2004 llogariten në rreth një miliardë lekë, nga të cilat 960 milionë lekë janë pasojë e zbatimit të detyrimeve që rrjedhin nga angazhimet ndaj OBT-së dhe rreth 40 milionë lekë janë efektet nga ndryshimet në projektligj, të miratuara nga Kuvendi. Kuvendi miratoi tarifatat doganore për peshqit e llojit krap, kocë, troftë dhe për molusqet, si dhe për birrën dhe vajin, në përputhje me nivelin e përcaktuar në projektligj, duke i kërkuar Këshillit të Ministrave të rinegociojë me OBT-në brenda tremujorit të parë të vitit 2004, për të ruajtur nivelin ekzistues të tarifave doganore të këtyre artikujve.

7. Projektligj “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2004”.

Gjatë shqyrtimit të projektbuxhetit në komisionet e përhershme të Kuvendit dhe në seancë plenare nga deputetët u mbajtën dy qëndrime:

Së pari, qëndrimi i pozitës, i cili përbën shumicën e deputetëve dhe vlerëson pozitivisht projektbuxhetin e paraqitur nga Këshilli i Ministrave në këto drejtime kryesore:

- Projektbuxheti mbështetet në Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik e Social të Vendit dhe në marrëveshjen trevjeçare me FMN-në. Në përgjithësi, treguesit kryesorë të parashikuar në projekt janë në përputhje me projektionet e programit afatmesëm buxhetor për vitet 2004-2006.

- Projektbuxheti siguron qëndrueshmërinë e treguesve makroekonomikë dhe të rritjes ekonomike. Ai parashikon rritjen e prodhimit të brendshëm bruto, rritjen e të ardhurave dhe shpenzimeve kundrejt realizimit të pritshëm të vitit 2003. Deficiti buxhetor dhe huamarrja e brendshme janë brenda parametrave të parashikuar në programin afatmesëm buxhetor 2004-2006.

- Projektbuxheti parashikon rritjen e të ardhurave tatimore dhe doganore në përputhje me mundësitë reale të ekonomisë dhe të administratës shtetërore për mbledhjen dhe administrimin e të ardhurave dhe, mbi këtë bazë, mundësitë e financimit të shpenzimeve të Buxhetit të Shtetit për arsimin, shëndetësinë, infrastrukturën, mbrojtjen sociale etj.

- Projektbuxheti parashikon vazhdimin e programit të decentralizimit dhe të pavarësisë financiare të pushtetit vendor, mbi bazën e reformës së filluar vitin e kaluar për decentralizimin e sistemit fiskal, duke shtuar kompetencat e bashkive dhe të komunave për mbledhjen e të ardhurave me karakter vendor.

- Shpërndarja e investimeve është parashikuar përgjithësisht në përputhje me strategjinë e zhvillimit.

Së dyti, qëndrimi i opozitës, i cili përbën pakicën e deputetëve dhe e kundërshton projektbuxhetin e paraqitur nga Qeveria për disa arsye, ndër të cilat më kryesoret janë:

- Projektbuxheti parashikon zgjerimin e shpenzimeve dhe të ekonomisë

publike në raport me ekonominë reale e atë private. Ritmet e rritjes së ekonomisë reale (prodhimit të brendshëm bruto) kundrejt realizimit të pritshëm të vitit 2003, parashikohen shumë më të ulëta se ritmet e rritjes së ekonomisë qeveritare (Buxheti të Shtetit).

- Rritja e të ardhurave në projektbuxhet mbështetet në rritjen e mëtejshme të barrës fiskale mbi biznesin, si vendosja e taksës së re për qarkullimin e automjeteve, rritja e akcizës së karburanteve, rritja e barrës së taksave etj., ndërkohë që vërehet rritje e evazionit fiskal dhe e ekonomisë informale.

- Projektbuxheti shformon më tej natyrën e shpenzimeve publike, duke rritur peshën specifike dhe prirjen e shpenzimeve joefektive e të pakthyeshme. Investimet kapitale publike kanë pësuar rënie, ndërkohë që shpenzimet operative janë rritur.

- Projektbuxheti nuk mban parasysh përparësitë e zhvillimit të vendit dhe nuk respekton strategjitë e deklaruara, veçanërisht në zërin e investimeve.

- Projektbuxheti thëllon problemet shoqërore që vijnë si pasojë e rritjes së çmimeve dhe e rritjes së koston të buxheteve të familjeve shqiptare, si dhe nuk parashikon strategji të mbështetjes sociale në këmbim të atyre asistencialiste.

- Projektbuxheti nuk parashikon mbështetje të projektligjeve që po diskutohen në Kuvend për ish-të përndjekurit politikë dhe ish-pronarët.

Në mënyrë të veçantë Komisioni i Ekonomisë, Financave dhe Privatizimit u ndal në analizën e shpenzimeve të parashikuara në projekt.

Gjatë diskutimit të projektbuxhetit Komisioni i Përhershëm i Ekonomisë, Financave dhe Privatizimit u ndal në mënyrë të veçantë në analizën e shpenzimeve të parashikuara në projektbuxhet. Lidhur me këtë, ky Komision dëgjoi, në një mbledhje të veçantë të tij, kërkesën e përfaqësuesve të shoqatave joqeveritare për rritjen e shpenzimeve për arsimin. Deputetët theksuan se akumulimi i problemeve të shumta në këtë sektor kërkon rritjen e financimeve për të, çka kërkon edhe rishikimin e programit buxhetor afatmesëm. Për të mbështetur sektorin e arsimit, Kuvendi vendosi që shpenzimet dhe investimet administrative në tërësi dhe për çdo dikaster e

institucion të ulen dhe fondi që do të krijohet si rrjedhojë e kësaj uljeje, së bashku me burime të tjera, të përdoren për rritjen e financimeve për arsimin. Si burim tjetër për financimin e këtij sektori u parashikua edhe rritja e të ardhurave.

Gjatë diskutimit deputetët kërkuan rritje të shpenzimeve kapitale, veçanërisht të investimeve në infrastrukturë dhe vendosën t'i rrisin ato në përputhje me përparësitë e përcaktuara në Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik e Social.

Komisioni i Përhershëm i Ekonomisë, Financave dhe Privatizimit mori në shqyrtim të gjitha kërkesat e paraqitura nga komisionet e tjera të Kuvendit, të cilat në parim i vlerësoi si shqetësime të drejta. Duke qenë se marrja në konsideratë e të gjitha kërkesave të paraqitura del jashtë mundësive të këtij projektbuxheti, Komisioni miratoi një pjesë të tyre, të cilat më pas u miratuan edhe në senacë plenare. Plotësimi i kërkesave të tyre për rritje shpenzimesh në disa sektorë u parashikua të realizohet nëpërmjet shkurtimit të shpenzimeve administrative operative, shkurtimit të shpenzimeve administrative për investime, shkurtimit të shpenzimeve për subvencione, si dhe shkurtimit të Fondit Rezervë të Këshillit të Ministrave. Si burim tjetër u parashikua rritja e të ardhurave jotatimore dhe e të ardhurave nga privatizimi.

Duke pasur parasysh rezultatin shumë pozitiv në privatizimin e Bankës së Kursimeve dhe mbështetjen buxhetore që do të jepet nga Bashkimi European, Kuvendi i propozoi Këshillit të Ministrave që brenda tremujorit të parë të paraqesë një projektligj të veçantë për rritjen e të ardhurave buxhetore për vitin 2004, shumë e cila do të rialokohet për mbulimin e deficitit buxhetor, të shpenzimeve operative dhe shpenzimeve kapitale në përputhje me përparësitë qeverisëse.

Në përfundim Kuvendi miratoi me shumicë votash projektbuxhetin e paraqitur nga Qeveria, me disa ndryshime në të ardhurat dhe shpenzimet e tij, sipas propozimit të Komisionit të Përhershëm të Ekonomisë, Financave dhe Privatizimit.

Informacion mbi legjislacionin e miratuar në Kuvend

Filip Lako

Jurist

Qendra e Studimeve Parlamentare

Ligj nr.8930, datë 25.7.2002 “Për miratimin e Strategjisë Ushtarake të Republikës së Shqipërisë”. Sipas këtij ligji, strategjia ushtarake e Republikës së Shqipërisë synon zhvillimin dhe shndërrimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në një forcë të vërtetë e të mirëstërvitur profesionalisht, për të përballuar sfidat e sigurimit, të së tashmes e të së ardhmes, në interes të misionit të tyre kushtetues dhe të integritetit të vendit në strukturat euroatlantike. Objektivi parësor i kësaj strategjie është ruajtja e sovranitetit, e pavarësisë dhe e tërësisë territoriale të Shqipërisë, mbrojtja e popullsisë në kohë paqeje, krize dhe lufte, si dhe mbrojtja e interesave kombëtarë. Strategjia e sigurimit kombëtar përcakton se kërcënimet më imediate janë ato që lidhen me ringjalljen e konflikteve historike rajonale, ato të terrorizmit të jashtëm, krimi i organizuar ndërkombëtar, trafiket e paligjshme, fatkeqësitë natyrore dhe ato të krijuara nga njeriu. Këto janë elemente potenciale për të destabilizuar sigurinë e Ballkanit. Gjithashtu, si kërcënim serioz ndaj shtetit ligjor dhe sigurisë së brendshme paraqitet edhe terrorizmi. Strategjia ushtarake përcakton ndërmjet të tjerash se interesa jetësorë për ruajtjen e stabilitetit të brendshëm janë edhe çarmatimi i popullsisë, grumbullimi i armëve dhe integrimi i Shqipërisë në Organizatën e Atlantikut të Veriut (NATO) e në Bashkimin Europian (BE). Ndër objektivat

ushtarakë të vendit janë: ruajtja e pavarësisë, e sovranitetit dhe e tërësisë territoriale të vendit, mbrojtja e popullit shqiptar në kohë paqeje, krize dhe lufte, ndihmesa për paqen dhe sigurinë rajonale dhe mbrojtja e proceseve të bashkëpunimit dhe integritimit. Ligji ka 6 nene dhe ka hyrë në fuqi më 30.8.2002. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.50 të vitit 2002, në faqen 1459. Ligjit i bashkëlidhet Strategjia Ushtarake e Republikës së Shqipërisë, Struktura aktuale e Forcave të Armatosura, Struktura e ardhshme e vitit 2010, përparësitë për riorganizimin dhe modernizimin, si dhe nisma mbështetëse të ristrukturimit.

Ligj nr.8931, datë 25.7.2002 “Për miratimin e aktit normativ nr.6, datë 4.7.2002 të Këshillit të Ministrave, me fuqinë e ligjit “Për miratimin e fondit për partitë politike, pjesëmarrëse në zonën zgjedhore nr.19, për zgjedhjen e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë”. Për zgjedhjen e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë në zonën zgjedhore nr.19, Këshilli i Ministrave i ka dhënë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve një fond prej 1 000 000 (një milion) lekësh për financimin e partive pjesëmarrëse në këto zgjedhje në këtë zonë. Akti normativ nr.6, datë 4.7.2002 ka përcaktuar që ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave dhe ka hyrë në fuqi menjëherë. Me ligjin nr.8931, datë 25.7.2002 është bërë miratimi i këtij akti normativ nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë. Ligji ka një nen. Akti normativ dhe ligji janë botuar në Fletoren Zyrtare nr.48 të vitit 2002, në faqen 1440. Fletorja Zyrtare ka dalë nga shtypi më 13.8.2002.

Ligj nr.8932, datë 25.7.2002 “Për dërgimin e një force ushtarake shqiptare në Afganistan në kuadër të koalicionit ndërkombëtar kundër terrorizmit”. Sipas këtij ligji, në kuadër të koalicionit ndërkombëtar kundër terrorizmit, dërgohet në Afganistan, si ndihmesë e Republikës së Shqipërisë, një togë e Batalionit Special Komando të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Ligji përcakton se me vendim të Këshillit të

Ministrave, ushtarakëve në përbërje të togës u përcaktohet gjatë ditëve të misionit, përveç pagës mujore dhe vështirësisë së shërbimit, një shpërblim ditor, trajtim dhe përballim të shpenzimeve për kompensimin e pasojave që vijnë për shkak të detyrës. Ligji ka 3 nene, është shpallur me dekretin nr.3426, datë 7.8.2002 të Presidentit të Republikës dhe ka hyrë në fuqi menjëherë. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.47 të vitit 2002, në faqen 1416.

Ligj nr.8933, datë 25.7.2002 “Për një shtesë në ligjin nr.8553, datë 25.11.1999 “Për Policinë e Shtetit””. Në pikën 5 të nenit 18 thuhet se në Akademinë e Policisë, përveç punonjësve të Policisë të rolit bazë, pranohen studentë jashtë Policisë për rolin e mesëm, sipas një kuote që vendoset nga Ministri i Rendit Publik, por gjithnjë duke plotësuar kërkesat e pikës 1 të nenit 16. Sipas këtij ligji, në fund të pikës 5, pra, pas fjalëve “kërkesat e pikës 1 të nenit 16”, shtohen fjalët me përjashtim të shkronjave “c” dhe “dh” të kësaj pike (pikës 1 të nenit 16). Në pikën 1 të nenit 16 renditen kushtet për të konkurruar për punonjës policie dhe këto kushte janë 6. Kushti i shkronjës “c” thotë: “kanë kryer shërbimin ushtarak (për meshkujt)” dhe kushti i shkronjës “dh” thotë: “kanë mbushur moshën 19 vjeç dhe janë nën 30 vjeç”. Pra, si përfundim, pika 5 e nenit 18 i përjashton këto kërkesa. Ligji ka dy nene dhe ka hyrë në fuqi më 25.8.2002. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.47 të vitit 2002, në faqen 1417.

Ligj nr.8934, datë 5.9.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”. Ky ligj rregullon marrëdhëniet ndërmjet njeriut dhe mjedisit, mbron përbërësit e mjedisit dhe proceset mjedisore, siguron kushtet materiale për zhvillimin e qëndrueshëm, duke plotësuar kuadrin e nevojshëm për zbatimin e kërkesës kushtetuese për një mjedis ekologjikisht të pastër. Në ligj trajtohen parimet bazë dhe elementet e mbrojtjes së mjedisit, politikat shtetërore për mjedisin, strategjitë dhe programet mjedisore etj. Rëndësi e veçantë i kushtohet përdorimit dhe mbrojtjes së përbërësve të mjedisit, siç janë mbrojtja e tokës,

e shtresës së humusit, e ujit, e ajrit, kriteret mjedisore për përdorimin e burimeve ujore, mbrojtja e biodiversitetit, e mjedisit të ndërtuar nga njeriu etj. Vlerësimi i ndikimit në mjedis, i cili trajtohet në një kre të veçantë, i nënshtrohet në çdo rast analizave, kur subjekte të ndryshme kërkojnë të ushtrojnë veprimtari në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe që mund të ndikojnë në mjedis. Ligji rregullon e përcakton edhe procedurat që duhen respektuar, si dhe dokumentacionin që duhet paraqitur për marrjen e lejes për veprimtari që ndikojnë në mjedis. Me interes paraqiten edhe ato pjesë të ligjit lidhur me parandalimin dhe kufizimin e ndotjes së mjedisit, me monitorimin e të dhënave, me kontrollin mjedisor, me përcaktimin e detyrave të organeve shtetërore për mjedisin, për rolin e publikimit etj. Në fund gjenden sanksionet për shkeljet që mund të bëhen. Me miratimin e këtij ligji shfuqizohet ligji nr.7664, datë 21.1.1993 “Për mbrojtjen e mjedisit” me gjithë shtesat e ndryshimet që i janë bërë, si dhe çdo akt normativ që ka dalë për zbatimin e tyre.

Ligji nr.8934, datë 5.9.2002 ka 90 nene dhe ka hyrë në fuqi më 31.10.2002. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.60 të vitit 2002 në faqen 1673.

Ligj nr.8935, datë 12.9.2002 “Për disa ndryshime në ligjin nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës””. Me këtë ligj bëhen ndryshime shumë të rëndësishme në ligjin në fuqi lidhur me kompetencat për caktimin e pagave të punës. Kështu, në nenin 4 përcaktohej kompetenca e Këshillit të Ministrave për caktimin e pagës minimale në shkallë vendi. Me ndryshimin e bërë në nenin 4 thuhet se Kuvendi, me propozimin e Këshillit të Ministrave, miraton pagën e Presidentit, raportet e pagave të funksionarëve të lartë shtetërorë, të institucioneve kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura të krijuara me ligj, si dhe shpërblimin e anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të institucioneve qendrore

të pavarura. Përmbajtja e nenit 4 të ligjit në fuqi ka kaluar në nenin 5. Ligji i lartpërmendur, shton në nenin 5 disa kompetenca të Këshillit të Ministrave, siç janë miratimi i akteve nënligjore për funksionimin e strukturës së pagave dhe të shpërblimit për nëpunësit civilë, kriteret dhe masën e shpërblimeve shtesë për punën jashtë orarit, për nëpunësit civilë, për klasifikimin dhe vlerësimin e vendeve të punës për shërbimin civil, për strukturën e pagave për punonjësit e administratës publike qendrore etj. Në nenin 6 parashikohen kompetencat e këshillit të qarkut, të këshillit bashkiak dhe këshillit komunal që, sipas përkatësisë, të miratojnë pagën për çdo funksion të zgjedhur e të emëruar, të bëjnë njehsim në pagë, të miratojnë shpërblimin mujor të këshilltarëve dhe të kryetarëve të fshatrave, të japin shpërblime etj. Të gjitha këto kompetenca nuk ishin në ligjin në fuqi. Ligji ka 4 nene dhe ka hyrë në fuqi më 31.10.2002. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.60 të vitit 2002, në faqen 1699.

Ligj nr.8936, datë 12.9.2002 “Për një shtesë në ligjin nr.8770, datë 19.4.2001 “Për shërbimin e ruajtjes dhe sigurisë fizike””. Neni 14 i ligjit nr.8770, datë 19.4.2001 tregon kushtet që duhet të plotësojë personi për t’u pajisur me leje për ushtrimin e profesionit të drejtuesit teknik. Këtu bëhet fjalë për ushtrimin e profesionit të drejtuesit teknik në shoqëritë e ruajtjes dhe të sigurisë fizike që ka për mision sigurimin e objekteve publike e private në pronësi ose në përdorim të personave fizikë e juridikë që ushtrojnë veprimtari në Republikën e Shqipërisë, si dhe sigurimin dhe mbrojtjen e jetës dhe të shëndetit të personave fizikë, shtetas shqiptarë ose të huaj. Gjithashtu, ato kanë për mision edhe shoqërimin e vlerave monetare e materiale ose të sendeve të çmuara gjatë transportimit të tyre. Në nenin 14, pika 1, shkronja “c” thuhet ndërmjet të tjerash, se për të ushtruar profesionin e drejtuesit teknik në këto shoqëri duhet të kesh kryer arsimin e lartë policor. Me ligjin nr.8936, datë 12.9.2002 pranohet që këtë profesion mund të ushtrojë edhe ai person që ka kryer arsimin e lartë ushtarak. Ligji ka dy nene dhe ka hyrë në

fuqi më 1.11.2002. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.61 të vitit 2002, në faqen 1705.

Ligj nr.8937, datë 12.9.2002 “Për ruajtjen e nxehtësisë në ndërtesa”. Ky ligj ka për qëllim të krijojë bazën ligjore të nevojshme për vendosjen e rregullave dhe bërjen të detyrueshme të marrjes së masave për ruajtjen e nxehtësisë në ndërtesa. Ligji detyron që projektimi dhe ndërtimi i ndërtesave të realizojë parametrat teknikë të nevojshëm për ruajtjen, kursimin dhe përdorimin me efikasitet të energjisë. Në të gjitha ndërtesat, që do të ndërtohen pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, duhet të respektohet koeficienti vëllimor e normativ për humbjet teknike (GV), si dhe të parashikohet vendosja e instalimit termik të ngrohjes qendrore ose vendore. Gjithashtu, sipas ligjit, mbetet detyrim fakti që mjetet që do të përdoren për ngrohjen ose freskimin e ndërtesave të projektohen për arritjen e temperaturës së ajrit të brendshëm, sipas normave të komfortit të temperaturës, duke pasur parasysh kushtet klimatike zonale dhe anën funksionale të ndërtesës. Ligji ka 6 nene dhe ka hyrë në fuqi më 1.11.2002. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.61 të vitit 2002, në faqen 1705.

Ligj nr.8938, datë 12.9.2002 “Për ratifikimin e “Konventës nr.176 “Sigurimi dhe shëndeti në miniera, 1995” të Organizatës Ndërkombëtare të Punës”. Konferenca e Përgjithshme e Organizatës Ndërkombëtare të Punës ka miratuar më 6 qershor 1995 në Gjenevë Konventën nr.176 lidhur me sigurinë dhe shëndetin në miniera. Kjo Konventë është e zbatueshme për të gjitha minierat dhe masat që synojnë të sigurojnë zbatimin e saj, duhet të jenë të parashikuara nga legjislacioni kombëtar. Legjislacioni kombëtar duhet të caktojë organin që do të mbikëqyrë dhe do të rregullojë aspektet e ndryshme të sigurisë dhe shëndetit në miniera. Sipas Konventës, ky legjislacion duhet të parashikojë mbikëqyrjen e sigurisë dhe të shëndetit në miniera, inspektimin e tyre, përpilimin dhe publikimin e

statistikave për rastet e aksidenteve, si dhe të parashtrijë masat që duhen ndjekur në fushën e shpëtimit në miniera. Në pjesën që i kushtohet masave të parandalimit dhe të mbrojtjes në miniera parashikohen përgjegjësitë e punëdhënësve në mënyrë të detajuar dhe me një renditje parësore, duke filluar me zhdukjen e këtyre rreziqeve, me kontrollin e tyre qysh në burim e deri në parashikimin e përdorimit të pajisjeve të mbrojtjes individuale. Gjithashtu, në Konventë janë parashikuar edhe të drejtat dhe detyrimet e punonjësve dhe të deleguarve të tyre, duke theksuar faktin që legjislacioni kombëtar duhet të arrijë që të drejtat e parashikuara në këtë Konventë të mund të ushtrohen pa diskriminim dhe pa raprezalje. Rëndësi i kushtohet edhe problemit të bashkëpunimit, duke urdhëruar që të merren masa në përputhje me legjislacionin kombëtar, për të nxitur bashkëpunimin ndërmjet punëdhënësve dhe punonjësve dhe përfaqësuesve të tyre, me qëllim promovimin e sigurisë dhe të shëndetit në miniera. Ligji ka dy nene dhe ka hyrë në fuqi më 1.11.2002. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.61 të vitit 2002, në faqen 1706. Ligjit i bashkëlidhet Konventa nr.176 lidhur me sigurinë dhe shëndetin në miniera.

Ligj nr.8939, datë 12.9.2002 “Për ratifikimin e “Konventës nr.175 “Puna me kohë të pjesshme, 1994” të Organizatës Ndërkombëtare të Punës””. Konventa nr.175 lidhur me punën me kohë të pjesshme është miratuar më 24 qershor 1994, nga Konferenca e Përgjithshme e Organizatës Ndërkombëtare e Punës, e mbledhur në Gjenevë. Kjo Konventë zbatohet mbi të gjithë punonjësit me kohë të pjesshme dhe nuk prek dispozitat më të favorshme të konventave të tjera ndërkombëtare të zbatueshme ndaj punonjësve me kohë të pjesshme. Sipas Konventës, duhen marrë masa me qëllim që punonjësit me kohë të pjesshme të përfitojnë të njëjtën mbrojtje si ajo që përfitojnë punonjësit me kohë të plotë, përsa i përket të drejtës së organizimit, të drejtës së negociimit kolektiv dhe të drejtës së veprimit në cilësinë e përfaqësuesve të punëmarrësve, të sigurisë dhe shëndetit në punë

dhe diskriminimit në punësim dhe në profesion. Gjithashtu, Konventa vendos si detyrim marrjen e masave, me qëllim që punonjësit me kohë të pjesshme të përfitojnë nga kushtet e barasvlefshme me ato të punonjësve me kohë të plotë, ndodhur në një situatë të krahasueshme në fusha si mbrojtja e mëmësisë, ndërprerja e marrëdhënieve të punës, leja vjetore e paguar dhe ditë pushimi të paguara dhe pushime për sëmundje. Gjithashtu, transferata nga një punë me kohë të plotë në një punë me kohë të pjesshme ose anasjelltas duhet të jetë vullnetare, në përputhje me legjislacionin dhe praktikën kombëtare. Dispozitat e kësaj Konvente duhet të vihen në jetë nëpërmjet legjislacionit, përveçse kur atyre u jepet fuqi me anë të marrëveshjeve kolektive ose me çdo lloj mjeti tjetër në përputhje me praktikën kombëtare. Me këtë Konventë punonjësit me kohë të pjesshme gjejnë mbrojtje edhe përsa i përket pagës, duke e trajtuar këtë problem në mënyrë të hollësishme. Ligji ka dy nene dhe ka hyrë në fuqi më 1.11.2002. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.61 të vitit 2002, faqe 1714. Ligjit i bashkëlidhet Konventa nr.175 lidhur me punën me kohë të pjesshme.

Ligj nr.8940, datë 12.9.2002 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Bullgarisë për shërbimet ajrore ndërmjet dhe përtej territoreve të tyre respektive””. Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Bullgarisë kanë aderuar në Konventën mbi aviacionin civil ndërkombëtar, të hapur për nënshkrim në Çikago më 7 dhjetor 1944. Nisur nga vullneti dhe dëshira e mirë e palëve, ato kanë rënë dakord të lidhin këtë Marrëveshje për të kontribuar në përparimin e aviacionit civil ndërkombëtar dhe për krijimin e shërbimeve ajrore ndërmjet dhe përtej territoreve të tyre respektive. Nisur nga kjo, çdo palë kontraktuese, i garanton palës tjetër kontraktuese, të drejtat e specifikuar në këtë Marrëveshje për qëllim të krijimit dhe operimit të shërbimeve ajrore ndërkombëtare, të planifikuara ndërmjet territorit të tij dhe territorit të palës tjetër kontraktuese

për rrugët e specifikuara në aneks. Në Marrëveshje parashikohet e drejta e çdo pale që të përcaktojë një ose disa shoqëri ajrore, me qëllim operimin e shërbimeve të miratuara për rrugët e specifikuara, si dhe të tërheqë, të ndryshojë ose të shmangë përcaktime të tilla. Gjithashtu, parashikohen anulimi ose pezullimi i autorizimit të operimit, tarifave, veprimtaritë tregtare, transferimet e fondeve dhe përfaqësimi etj. Gjithashtu, çdo palë detyrohet të respektojë konkurrencën e ndershme, përjashtimet nga doganat dhe detyrimet e tjera mbi baza reciprociteti, aplikueshmërinë e fluturimeve të parregullta, kontrollin e emigracionit, njohjen e certifikatave dhe të licencave. Ligji ka dy nene dhe ka hyrë në fuqi më 1.11.2002. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.61, të vitit 2002 në faqen 1719. Ligjit i bashkëlidhet Marrëveshja.

Ligj nr.8941, datë 19.9.2002 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes së kredisë të zhvillimit ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA) për projektin e rristrukturimit dhe të rehabilitimit të Sektorit të Energjisë Elektrike””. Sipas Marrëveshjes të lidhur më 26 qershor 2002 ndërmjet Shqipërisë (Huamarrësi) dhe Shoqërisë për Zhvillim (Shoqërisë), kjo e fundit ka rënë dakord që t’i japë Huamarrësit një kredi prej 24 000 000 (SDR), sipas termave dhe kushteve të vendosura ose që i referohen Marrëveshjes për Kredi Zhvillimi. Projekti, i cili përshkohet qartë në listën 2, do të zbatohet nga KESH-i, me asistencën e Huamarrësit, i cili do t’i japë nënhua KESH-it, sipas një marrëveshje që do të miratohet edhe nga shoqëria. Për të gjitha shpenzimet, huamarrësi do të ruajë dokumentacion dhe llogari të veçanta, ku reflektohen këto shpenzime, për t’i dhënë shoqërisë informacionin e duhur kurdoherë që ajo do ta kërkojë. Po ashtu, Huamarrësi do të detyrojë KESH-in për të përgatitur dhe dhënë shoqërisë raportin për vëzhgimin (monitorimin) financiar. Marrëveshja ka edhe 3 lista. Lista 1 është për rregullimin e problemeve që kanë të bëjnë me tërheqjen e kredisë dhe shpërndarjen e shumave të saj. Lista 2 bën përshkrimin e projektit, i cili ka 3 pjesë. Pjesa e

parë parashikon ndërtimin dhe rehabilitimin e linjave të transmetimit dhe nënstacioneve dhe zhvillimin e një rrjeti shpërndarjeje në zonat e Durrësit, Elbasanit e Kuçovës nëpërmjet furnizimit me mallrat dhe shërbimet e mëtejshme. Pjesa e dytë parashikon instalimin e kutive matëse individuale dhe kolektive, furnizimin me mallrat dhe shërbimet e mëtejshme, kurse pjesa e tretë ka të bëjë me reformën në sektorin elektronik, nëpërmjet asistencës, rivlerësimit të aseteve të KESH-it dhe përmbushja e kërkesave të konsumatorit. Lista e tretë trajton probleme që kanë të bëjnë me llogaritë speciale. Ligji ka dy nene dhe ka hyrë në fuqi më 15.11.2002. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.67 të vitit 2002, në faqen 1863. Ligjit i bashkëlidhet Marrëveshja, si dhe 3 listat.

Ligj nr.8942, datë 19.9.2002 “Për ratifikimin e “Konventës Europiane “Për shtetësinë””. Kjo Konventë përcakton parimet dhe rregullat që lidhen me shtetësinë e personave fizikë, si dhe rregulla lidhur me detyrimet ushtarake në rastet e shtetësisë së shumëfishtë, të cilëve duhet t’u përmbahet e drejta e brendshme e shteteve palë. Ajo është miratuar në Strasburg më 6.11.1997. Në kreun për parimet e përgjithshme lidhur me shtetësinë, vihet detyrimi për çdo shtet që të përcaktojë në të drejtën e tij se cilët janë shtetas të tij. Gjithashtu, në këtë kre përcaktohet se çdo shtet palë do të udhëhiqet nga parimi i mosdiskriminimit ndërmjet shtetasve të tij, pavarësisht nëse ata janë shtetas nga lindja ose e kanë fituar shtetësinë më pas. Rregullat lidhur me shtetësinë trajtohen në kreun III. Kështu trajtohet fitimi i shtetësisë, humbja e shtetësisë *ex lege* ose me nismën e një shteti palë, humbja e shtetësisë me nismën e individit dhe rikthimi i shtetësisë. Procedurat për problemet e përmendura më lart janë pjesë e kreut IV. Konventa parashikon edhe shtetësinë e shumëfishtë dhe për këtë përcakton rastet e shtetësisë së shumëfishtë *ex-lege*, raste të tjera të mundshme të shtetësisë së shumëfishtë, ruajtjen e shtetësisë së mëparshme, si dhe të drejtat dhe detyrat që lidhen me shtetësinë e shumëfishtë. Në mënyrë të

hollësishtme trajtohen detyrimet ushtarake në rastet e shtetësisë së shumëfishhtë, duke përcaktuar qartë se personat që kanë shtetësinë e dy ose më shumë shteteve palë do të kërkohen të përmbushin detyrimet e tyre ushtarake në lidhje me vetëm njërin prej këtyre shteteve palë. Gjithashtu, Konventa trajton bashkëpunimin midis palëve, shkëmbimin e informacionit, efektet e kësaj Konvente, nënshkrimin dhe hyrjen në fuqi, rezervat, denoncimin etj. Ligji ka 2 nene dhe ka hyrë në fuqi më 15.11.2002. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.67, të vitit 2002, në faqen 1872. Ligjit i bashkëlidhet edhe Konventa Europiane për shtetësinë.”

Ligj nr.8943, datë 19.9.2002 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Popullore të Kinës për shndërrimin në kredi qeveritare të saldës së kleringut, në favor të Kinës, rezultuar nga zbatimi i marrëveshjes qeveritare të shkëmbimit të mallrave e pagesave dhe të kredisë në mallra, të vitit 1991””. Me kërkesën e Qeverisë së Republikës të Shqipërisë, Qeveria e Republikës Popullore të Kinës bie dakord të shndërrojë në kredi qeveritare shumat për të cilat Shqipëria i detyrohet Kinës dhe që përbëhet nga saldo në dollarë-klering prej 31 345 955 USD në favor të palës kineze, rezultuar nga zbatimi i marrëveshjeve qeveritare të shkëmbimit të mallrave e pagesave midis dy vendeve qysh nga viti 1978. Përveç këtyre përfshihet edhe principali, interesat e vonuara dhe efektet e vlerësimit të monedhës për kredinë në mallra të vitit 1991 prej 7 576 832 USD. Shuma e përgjithshme e detyrimeve që shndërrohen në kredi qeveritare me anë të kësaj marrëveshjeje është 38 922 787 USD. Interesi i kredisë sipas kësaj Marrëveshjeje do të jetë 3.5 për qind në vit, kurse afati i shlyerjes së kredisë do të jetë 14 vjet. Pala shqiptare ka marrë përsipër që ta shlyejë principalin e kredisë me këste të barabarta, të njëpasnjëshme gjashtëmujore, duke filluar nga 30 maj 2004 deri më 30 nëntor 2015. Modalitetet teknike bankare, për të zgjidhur problemet konkrete të pagesave, që rrjedhin nga kjo

Marrëveshje, do të vendosen nga Banka e Kinës dhe Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë. Të gjitha marrëveshjet e mëparshme përkatëse, prej të cilave rrjedhin detyrimet që u përmendën më lart, shfuqizohen, duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, e cila është nënshkruar në Pekin më datë 18.12.2001. Ligji ka dy nene dhe ka hyrë në fuqi më 15.11.2002. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.67 të vitit 2002, në faqen 1882. Ligjit i bashkëlidhet Marrëveshja.

